GAZETA 'LAJMËTARI I LIRISË', BEFASI E KËNDSHME PËR MËRGATËN SHQIPTARE

Prof.dr.Sabile Keçmezi-Basha

Gazetat si “Bashkimi”, “Lajmëtari i Lirisë” dhe “Liria”, nuk i shin gazetat e para që botoheshin në perëndim, porse ishin gazetat e vetme që sollën një frymë të re në trajtimin e çështjes kombëtare shqiptare në përgjithësi e në veçanti të shqiptarëve dhe të tokave shqiptare që kishin ngelur nën Jugosllavi.

Për herë të parë në këto gazeta filluan të botoheshin shkrime analitike të argumentuara me të dhëna shkencore, botoheshin polemika të ndryshme me shkencëtar të ndryshëm sllav të cilët u mundoheshin për ta shtrembëruar të vërtetën për shqiptarët dhe Kosovën. Në to mund të lexoheshin shumë tema të cilat gjerë më atëherë opinioni i gjerë nuk i kishte ditur dhe nuk kishte pasur rast ti lexonte. Në mënyrë të argumentuar u prezantonin politika, ekonomia, arsimi, kultura, si dhe tema të ndryshme nga shkencat e ndryshme po ashtu edhe me fakte e statistika shkruhej për dhunën, terrorin, të burgosurit, të arrestuarit, shkruhej edhe për ushtarët e vrarë që ktheheshin në arkivole nga ushtria serbe.

Në të gjitha gazetat që botoheshin nga mërgata shqiptare, lexuesi i rëndomtë mund të haste gati-gati tematika të ngjashme të cilat trajtonin luftën e pa kompromis për çlirim dhe bashkim kombëtar. Për gazetën "Lajmëtari i Lirisë", nuk kishte gjë më të rëndësishme se sa për atdheun e robëruar të luftohej me pushkë dhe me pendë për liri dhe bashkim me vendin amë, Shqipërinë.[1]

1. 1. Kush ishte Jusuf Gërvalla

Më 1 tetor 1945, u lind heroi i kombit Jusuf Gervalla, në fshatin Dubovik të Deçanit. Ai fillimisht ishte poet, romancier, këngëtar dhe atdhetar i përkushtuar gjer në çastet e fundit të jetës, e cila u pre në mes nga kriminelët serb. Gjyshi i Jusuf Gervallës ka qenë kaçak i njohur i cili luftoi kundër forcave pushtuese serbe.

Vitet të cilat i jetoi ai në Kosovë ishin me plotë luftë dhe me plotë sakrificë. Por, pas daljes nga Kosova në jetën e tij fillon një etapë e re, e mbarsur me kobë dhe fatkeqësi. Ai si i ri, mbi supet e veta e kishte ndjerë rëndë peshën e skllavërisë, andaj edhe ishte krejt e pritur që ai të angazhohej në lëvizjen atdhetare ilegale. U angazhua dhe punoi deri në çastet e fundit të jetës për lirinë e Kosovës dhe trojeve shqiptare nën ish-Jugosllavi. Udbashët sllavë e kishin hetuar veprimtarin dhe angazhimin e madh të tij për zgjidhjen e çështjes kombëtare shqiptare, dhe në një mënyrë ciklike po iu prishte llogarit të bëra gabimisht për Kosovën. Ata , pas këtij zbulimi nuk rrinë duarkryq. Vendosin që në një mënyrë ose tjetër, ta arrestonin ose ta likuidonin në një afat sa më të shkurtër. Dihej se në vitet e shtatëdhjeta e tetëdhjeta ilegalja shqiptare ishte shumë e organizuar, andaj edhe qëllimet e hetuesve kishin arritur ti zbulonin, dhe Jusuf Gërvalla informohet me kohë, me ndihmën e shokëve, arratiset dhe ilegalisht kalon kufirin për tu vendosur tek i vëllai-Bardhoshi që ndodhej në Gjermani, ku më herët kishte shkuar. Rezistenca shqiptare që vepronte në perëndim pati fat që në radhët e veta pati edhe atdhetarin e devotshëm, organizatorin e mirëfilltë të veprimtarisë ilegale atdhetare.

Me angazhimin e Jusufit në veprimtarin atdhetare në diasporë, ai angazhohej kryesisht në organizimin e tyre që në rrugën e nisur të rezistencës, që të jenë sa më unik dhe më të bashkuar. UDB-eja

[1] Po aty.

jugosllave ishte tej mase e shqetësuar. Andaj rrjeti i krimit dhe i kriminelëve me të madhe u sensibilizua. U dërguan me urgjencë edhe jashtë shtetit gjithandej ku vepronte Jusuf Gërvalla, Kadri Zeka, Bardhosh Gërvalla dhe shokët e tyre. Dhe, nuk shkoi gjatë, një ditë të ftohët janari (17 Janar 1982), nënë Ajshja mori lajmin e zi, se në vendin e quajtur Untergrupenbach afër Shtutgardit ishin likuiduar atdhetarët Jusuf e Bardhosh Gervalla dhe Kadri Zeka, të cilët në historinë e re të popullit shqiptar mbeten si figurat më madhore të Kombit tone.

Në librin "Fati i luleve...", të Kadri Rexhës thuhet edhe kjo se "Nënë Ajshja këtu në Dubovik, lajmin do ta marrë nga lajmet e Radio Prishtinës, që kohëve të fundit i kishte kaluar në një shprehi për të dëgjuar lajmet. Besa, siç thotë më vonë, kisha edhe një parandjenjë të keqe se do të ndodhë diçka e papritur dhe e zezë" për të vazhduar më tej, dhe vazhdimisht duke vu në spikamë krenarin dhe pa përulësin e nënës para armikut. Në momentin kur merë lajmin tragjik për djemtë e saj, ajo të nesërmen shkon në burgun e Pejës për ta ngushëlluar të birin Hysenin. Gardianët dhe roja e burgut ishin të informuar mirë dhe dinin çdo gjë për ngjarjen që kishte ndodhur një ditë më parë. Me një vetëkënaqësi të pa përmbajtur, e ironizonin nënën e kombit, siç do të shkruante Kadri Rexha, në librin e lartpërmendur, në momentin kur do i shprehin ngushëllime udbashët e fëlliqur, duke iu drejtuar me fjalët se "a mërzitesh për djemtë që tu vranë". E nëna me mençurin që kishte do t'iu përgjigjet "Jo, nuk mu ka mbyllur dera me ferrë...Në shtëpi i kam edhe dhjetë burra të tjerë. Pastaj tërë shokët e djemve të mi, i kam në vendin e tyre. Tash po e marr vesh se paskam pasur djem, ndryshe nuk do të ngrihej një shtet në këmbë për të mi vrarë..."[2], përfundon nëna.

Veprimtaria liridashëse dhe atdhetare e heronjve, në mënyrë të drejtpërdrejtë do të pengonte shërbimet jugosllave brenda dhe jashtë vendit. Ata, që të tre në mes veti kompletoheshin e harmonizonin veprimet, sa që një lëvizjes atdhetare do ti nevojiteshin vite për të pasur këso kuadrosh në radhët e tyre. Jusufi ishte një penë e fortë e me emër në Kosovë, Kadriu ishte jo vetëm gazetar i mirë, por sidomos organizator efikas me përvojë shumëvjeçare në organizimin ilegal.

[2] Kadri Rexha, Fati i Luleve, Rruga jetësore e shkrimtarit dhe atdhetarit Jusuf Gërvalla, Prishtinë, 1993, f. 221-223.

Bardhoshi fliste shumë mirë gjermanishten e anglishten dhe kishte krijuar raporte të shkëlqyeshme edhe me organizata të tjera të shteteve të huaja që luftonin për liri dhe pavarësi të popujve të tyre. Që të tre ishin të rinj dhe të mbrujtur me një idealizëm e gatishmëri për çdo flijim.

Mirëpo, përballë tyre ata kishin një shtet të fortë e me shumë mundësi. Jugosllavia prej themelimit të saj, pra që më 1918 e tutje, ka zhvilluar një luftë të pamëshirshme kundër rezistencës shqiptare, që me një përkushtim të madh u organizua dhe ia doli që ta kurorëzoi me sukses. Dhe vërtet Nënë Ajshja ngeli pa dy djemtë e saj, por një shqiptari ishte e saja dhe i qëndroi pranë deri në ditët e fundit. Nënëmadhja - Ajshe Gërvalla, vërtet shkoi në amshim, por gratë trimëresha, dhe nënat që lindin trima ato nuk vdesin kurrë, në kujtimet, në dashurin dhe në historinë e kombeve.

ZËRI I KOSOVËS

Organ i Lëvizjes Nacionalçlirimtare të Kosovës dhe viseve të tjera shqiptare në Jugosllavi

Në ballë të këtij populli dhe këmbët e këtij populli, flijimi dhe vdekja për realizimin e aspiratave të tij, do të na vijnë si përjetimi më i bukur e më fisnik në gjithë jetën. Dhe s'do të ketë forcë që të na ndalë në rrugën tonë të ndritshme. Jusuf Gërvalla

Nr. 3 Mars 1982

Bardhosh Gërvalla

Jusuf Gërvalla

Kadri Zeka

TRE RANË, ME MIJËRA U NGRITËN

1. 2. Biografi e shkurtër e Kadri Zekës

Kadri Zeka u lind më 25 prill të vitit 1953 në fshatin Poliçkë, Malësia e Hogoshtit. Shkollën fillore e mbaroi në Desivojcë. Më 1968 familja e tij u shpërngul në Gjilan dhe këtu mbaron shkollën e mesme. Më 1972 regjistrohet në Fakultetin Juridik në Prishtinë, dega e

gazetarisë. Më 1973 Kadri Zeka u takon radhëve të organizuara të "Grupit revolucionar". Ishte në një celulë me dëshmorin Rexhep Mala, Hilmi Ramadanin e Hydajet Hysenin. Fillimisht Kadriu ka qenë anëtar i celulës, kurse pas arrestimeve të vitit 1974 dhe 1975 të anëtarëve të Grupit Revolucionar, Kadriu kalon në Komitetin Drejtues (që ishte organi më i lartë i Organizatës), në këtë cilësi ka qenë deri në fund të jetës së tij. Ndërkohë punon si gazetar në radio Prishtinë. Kadri Zeka ka qenë shumë i zellshëm në zgjerimin e radhëve dhe për këtë qëllim ka shkuar të punojë e të jetojë një kohë në malësi të Gollakut,(mësues në Gmicë të Dardanës). Ka mbajtur lidhje të fshehta me Rexhep Malën e shokë të tjerë, edhe gjatë qëndrimit të tyre në burg."

Ndërkohë punon si gazetar në radio Prishtinë. Kadri Zeka ka qenë shumë i zellshëm në zgjerimin e radhëve dhe për këtë qëllim ka shkuar të punojë e të jetojë një kohë në malësi të Gollakut,(mësues në Gmicë të Dardanës). Ka mbajtur lidhje të fshehta me Rexhep Malën e shokë të tjerë, edhe gjatë qëndrimit të tyre në burg."

Pas gjurmimeve sistematike të UDB-së aty kah marsi i vitit 1978 hetohet veprimtaria e tij. Fillimisht Kadriu shkon për disa javë në Turqi, por meqë nuk kishte ndonjë risi kthehet prapë në Kosovë. Më pastaj Kadri Zeka shkon në Zvicër, në qytetin S. Gallen, ku ndihmohet nga anëtarët e Organizatës si Hasan Mala, Kadri Abdullahu etj. Në Zvicër Kadriu tregohet shumë aktiv: vë kontakt me organizatat shqiptare në mërgim, krijon lidhje me simpatizantë të çështjes shqiptare në Zvicër e Gjermani dhe mban lidhje të rregullta me përfaqësitë e Shqipërisë jashtë shtetit.

Krahas kësaj veprimtarie përgatiti botimin dhe shkroi vetë shumë artikuj për gazetën "Liria". Veç organit të Organizatës që i takonte ai përgatiti e botoi dhe publikime të tjera siç ishin "Këngët e lirisë", një përmbledhje me poezi që u bënë kushtrim kolektiv i djalërisë kosovare. Pastaj përgatiti dhe botoi përmbledhjen me artikuj të shtypit të huaj "Rreth ngjarjeve në Kosovë" si dhe studimin e njohur të Vasa Çubriloviqit "Shpërngulja e shqiptarëve". Kontribuoi në hartimin dhe shpërndarjen e "Tezave rreth Frontit Popullor për Republikën e Kosovës". Me përkujdesjen e drejtpërdrejtë të tij, mijëra ekzemplarë të këtyre publikimeve u futën dhe u shpërndanë në Kosovë.

Kadri Zeka ka gjetur tek vëllezërit Gërvalla shokët e idealit, të luftës e të përpjekjeve. Ata rreth një vit do të veprojnë bashkë. Përkundër intrigave të UDB-së ata nuk do të përçahen, por do të punojnë për fuqizimin e Lëvizjes për Pavarësi dhe për krijimin, përmes veprimeve të përditshme, të një organizate të vetme në shkallë kombëtare; të strukturuar dhe të përgatitur për t'u përballë me kërkesat dhe sfidat e kohës. Prandaj nuk është e rastit pse ata nuk i ndau as vdekja.

Vritet tinëzisht nga UDB-ja jugosllave më 17 janar 1982 në Untergrupenbach afër qytetit Heilbronn landi i Stuttgart-it (Gjermani).

Pas luftës së fundit në Kosovë në fshatin e lindjes në Poliçkë në vitin 2007-të u përurua Muzeu Kadri Zeka[3]

1.3.Përmbajtja e numrit të parë të gazetës "Lajmëtari i Lirisë"

Revistës i paraprin punimi "Perditio tua, Israel, ex te", që në bazë të hulumtimeve që kam bërë në shumë vende thuhej se këtë punim e ka shkruar Jusuf Gërvalla, por para se të bëja analizën e këtij punimi, do të ndalesha, në fjalën përfundimtare të Jusuf Gërvallës që e jep për vetë numrin e parë të revistës, "Dy fjalë për numrin e parë të "Lajmëtarit të Lirisë", përfshin arsyet, shkaqet, platformën dhe qëllimet pse kanë vendosur që të botonin këtë gazetë. Në shkrim thuhej se "Kemi nderin që në kushte jashtëzakonisht të vështira të ilegalitetit, të dalim para lexuesit shqiptar me një revistë të përdymuajshme revolucionare, që e kemi emëruar "Lajmëtari i Lirisë". Shpresojmë se nëpërmjet këtij organi do t'ia dalim me sukses të bëhemi zëdhënës të aspiratave revolucionare të djalërisë shqiptare të Kosovës, e cila nuk e ndal dot luftën për çlirim nga robëruesi i egër jugosllav dhe për bashkim me vendin amë, Shqipërinë[4], thoshte redaksia e gazetës.

Ata shpresonin se në këtë mënyrë do të plotësonin edhe një detyrë. Informimin e drejt e llogariteshin si një dimension të luftës së përgjithshme ndaj okupuesit. Se me anën e informimit do të godasin dhe do të demaskojnë botërisht armikun shekullor, qeverinë shoviniste e antishqiptare të Beogradit dhe në një mënyrë do të sensibilizojnë luftën e

[3] Marrë nga "http://sq.wikipedia.org/wiki/Kadri_Zeka, 15.04. 2009

[4] Dy fjalë për numrin e pare të "Lajmëtarit të Lirisë", "Lajmëtari i Lirisë"", Viti I, nr. 1, gusht 1980.

drejtë të ilegales shqiptare që për qëllim kishte çlirimin e pjesës së robëruar të atdheut nga okupimi jugosllav.

Në Gazetën "Lajmëtari i lirisë" shkruanin se gazeta është e hapur për të gjithë ata të cilët kanë ide dhe veprojnë për të mirën e kombit dhe për çlirimin e tij. Për redaksinë e gazetës nuk ishte e rëndësishme se nga cila anë vijnë idetë nga ilegalet, gjysmë ilegalet apo edhe nga vet legalet, tani për tani e rëndësishme ishte lirimi i tokave shqiptare të okupuara nën Jugosllavi[5].

Për platformën e gazetës shkruanin se ata, përfaqësonin vijën politike kombëtare-marksiste, por lidhur me ideologjinë marksiste, këto gazeta ishin marksiste vetëm aq sa mos të binin në kundërshtim me Tiranën zyrtare. Duke u nisur nga kjo, të gjitha organizatat dhe grupimet politike (mbi pesëdhjetë sosh), e ndiqnin këtë rrugë.

Gazeta "Lajmëtari i Lirisë", vinte në të dhënat shumë interesante se armiku i ynë shekullor, qeveria e Beogradit, për të dëmtuar luftën tonë të drejtë, e cila mund të arrihet vetëm duke përfillur idenë e një revolucioni të përgjithshëm[6], shpik dhe propagandon gjithçka vetëm e vetëm për ta zbehur luftën dhe angazhimin e shqiptarëve për liri e pavarësi. Duke u nisur nga këto të dhëna, redaksia e gazetës, mendon se për ta kryer këtë luftë dezinformative për shqiptarët, thonë se do ia lënë këtë punë që ta kryej vet gazeta me një informim të drejt dhe të sinqertë.

1. 4. Historiku i robërisë

Në shkrimin "Perditio tua, Osrael, ex te", në të cilin nuk figuron as emër e mbiemër të autorit, porse as pseudonim (në gazetë të gjitha shkrimet janë të shkruara pa emrin e autorit, por nuk kanë as pseudonime, përveç shkrimeve që i marrin nga autorët shqiptar, nga Shqipëria). Në bazë të disa shkrimeve të mëhershme thuhej se këtë shkrim e ka shkruar Jusuf Gërvalla si dhe shumë shkrime të tjera e aty-këtu ka botuar edhe Bardhosh Gërvalla.

Autori Jusuf Gërvalla fillon me "Kosova, (por termi Kosovë është me fusnotë, dhe shpjegohet në këtë mënyrë "Që nga pushtimi jugosllav, ne shqiptaret kemi quajtur me fjalën Kosovë të gjitha tokat shqiptare, që kanë hyrë nën okupimin jugosllav") pas daljes nga robëria

[5] Po aty.
[6] Po aty.

pesëshekullore turke, e cila u zëvendësua me një robëri edhe më të rëndë- atë sllave, në kohën kur Shqipëria e sotme fitoi pavarësinë, më 1912, u nda në katër të ashtuquajtura banovina. Kjo ndarje kishte qëllime kryekëput politike dhe shërbente për t'i mbajtur sa më lehtë në zotërim shqiptarët e papërkulshëm, kurse katër banovinat u përgjigjën katër regjioneve, brenda të cilave është mbërthyer edhe sot populli shqiptarë në viset e robëruara nga Jugosllavia e Titosë: Kosovë, Maqedoni, Mal i Zi dhe Serbi.[7] Në vazhdim, elaborohen të gjitha masat shtetërore që kishin ndërmarr që sa më shumë shqiptar të ikin nga trojet e veta të natyrshme. Dhuna, terrori, shpërnguljet në masë, djegia e fshatrave dhe e qyteteve shqiptare të gjitha këto kishin vetëm një qëllim realizimin e planit shtetëror jugosllav për shfarosjen apo edhe asimilimin e plotë të shqiptarëve, të cilët atëbotë qenë bërë prag i pakapërcyeshëm për daljen e Serbisë në Detin Adriatik dhe përgjithësisht për apetitet pansllave të monarkive të Serbisë dhe të Malit të Zi, më vonë Mbretëria e Serbëve, Kroatëve dhe Sllovenëve.

Në shkrim jepen e shpjegohen gjerë e gjatë periudhat historike, duke mos lënë anash asnjë kohë e cila ishte e rëndësishme për shqiptarët. Për lexuesin e rëndomtë janë sinjifikative të dhënat e tilla ngase nuk ishin mësuar që të lexonin diçka të tillë dhe duke i quajtur të gjitha gjerat me emrin e vërtet.

Jusuf Gërvalla analizonte dendur periudhën pas vitit 1912 duke kaluar në kohën kur formohet Mbretëria e SKS-së e deri tek formimi i shtetit Jugosllav (1945). Por, thekson autori, se edhe pse evoluuan sistemet, ndryshuan kufijtë, u ndërruan udhëheqësit, u sollën shumë vendime, u mbajtën shumë konferenca lidhur me zgjidhjen e problemeve të popujve e shteteve, megjithatë, asnjë sistem e pushtetar jugosllav nuk hoqën dorë nga aspiratat shoviniste ndaj popullit shqiptar. Të gjitha udhëheqësit merrnin mbi vete kultivimin dhe barazinë e kombeve dhe të kombësive që jetonin në Jugosllavi, se kështu edhe kërkohej nga rregullat në shkallë ndërkombëtare. Porse Jugosllavia në çdo periudhë dhe në çdo kohë në mënyrën më dinake i shkelte të gjitha normat the i thyente të gjitha rregullat, duke i paraqitur para botës se populli shqiptar

[7] Perditio tua, Israel, ex te, Lajmëtari i Lirisë, viti I. nr. 1. gusht 1980, f, 1.

që jeton në Jugosllavi i gëzon të gjitha të drejtat si ato njerëzore po ashtu edhe ato shtetërore.

Me penë dhe pushkë...

lajmëtari i lirisë

...për liri dhe bashkim me vendin amë, Shqipërinë socialiste!

Në kundërshtim të hapët me parimin e kombësisë dhe të vullnetit të popullsive vendëse, nga trungu i Shqipërisë u shkëputën krahina të tëra si Rrafshi i Dukagjinit, Kosova dhe tokat shqiptare në Maqedoni. Më tepër se gjysma e popullsisë së vendit dënohej të ndërronte zgjedhën e vjetër turke me një zgjedhë të re, atë të Serbisë dhe të Malit të Zi. ARBEN PUTO

viti I nr. 1 gusht 1980

Perditio tua, Israel, ex te

Kosova [1], pas daljes nga robëria peseshekullore turke, e cila u zëvendësua me një robëri edhe më të rëndë – atë sllave, në kohën që Shqipëria e sotme fitoi pavarësinë, më 1912, u nda në katër të ashtuquajtura banovina. Kjo ndarje kishte qëllime kryekëput politike dhe shërbente për t'i mbajtur sa më leht në zotërim shqiptarët e papërkulshëm, kurse katër banovinat u përgjigjen katër regjioneve, brenda të cilave ësthë mbërthyer edhe sot populli shqiptar në viset e robëruara nga Jugosllavia e Titos: Kosovë, Maqedoni, Mal i Zi dhe Serbi.

Dhuna, terrori, shpërnguljet në masë, djegia e fshatrave dhe e qyteteve shqiptare kishin për qëllim realizimin e planit shtetëror jugosllav për shfarosjen apo asimilimin e plotë të shqiptarëve, të cilët atëbotë qenë bërë prag i pakapërcyeshëm për daljen e Serbisë në Detin Adriatik dhe përgjithësisht për apetitet pansllave të monarkive të Serbisë dhe të Malit të Zi, më vonë Mbretëria e Serbëve, Kroatëve dhe Slovenëve.

Megjithatë, që nga viti 1912 e këtej, megjithë zhdukjen e madhe fizike të shqiptarëve, nëpërmjet masakrave, vrasjeve dhe shpërnguljeve, në viset e robëruara shqiptare kurrë nuk ndërroi dukshëm fizionomia e tyre etnike: numri i shqiptarëve në këto vise mbeti gjithmonë numër dominant i popullsisë së përgjithshme në të gjitha regjistrimet e popullsisë që janë bërë deri më tash në Jugosllavi. (Në punimet historiografike dhe demografike, që po dalin kohëve të fundit ndër ne, vërehet vazhdimisht mekanizmi jugosllav për fshehjen e numrit të vërtetë të shqiptarëve që jetojnë në trojet e veta, me qëllim që fizionomia etnike e tokave tona të ndërrojë rrënjësisht me kalimin e kohës). Edhe sot, shqiptarët paraqesin shumicën dërmuese të popullsisë, deri në 80 e 98 për qind, në pjesën më të madhe të tokave shqiptare në Jugosllavi.

As Mbretëria e SKS dhe as Jugosllavia e Titos nuk hoqën dorë asnjëherë prej aspiratave shoviniste ndaj popullit shqiptar. Si njëra si tjetra merrnin përsipër kultivimin e kombeve dhe të kombësive që jetojnë brenda kufijve të tyre politikë. Se kjo gjë lypsej, së paku formalisht, me raportet e rregulluara në shkallë ndërkombëtare. Në këtë drejtim, Jugosllavia, që 68 vjet, u shtrëngua që, në trajtë kompenzimi për shkeljen brutale të të drejtave legjitime të shqiptarëve, të zhvillojë në mënyrë permanente dhe me mundim të konsiderueshëm një mekanizëm të gjallë të propagandës së konsumit të brendshëm, jugosllav, dhe të konsumit ndërkombëtar. Sic është fare e natyrshme, Jugosllavia e sotme, duke rrajtur dhe duke çuar një hap më tej aspiratat shoviniste ndaj shqiptarëve të Kosovës, dhe duke qenë në anën tjetër e shtrënguar t'i thellojë e t'i ansyetojë më shumë se e djeshmja këto aspirata, mjetet për shfarosjen dhe për asimilimin e shqiptarëve i ka përsosur dukshëm, në përputhmëri me situatën në vend dhe në botë.

Aktualisht, për opinionin mesatar jugosllav dhe botëror, që manipulon me informatat elementare dhe fare të cekta lidhur me Jugosllavinë, në këtë pjesë të Ballkanit, përkatësisht në këtë shtet, ose nuk ka fare shqiptarë, ose ata përbëjnë një pakicë të parëndësishme, që nuk meriton kushedi se çfarë kujdesi. Në rastet më fatlume, një pjesë e opinionit të tillë e di përafërsisht numrin e shqiptarëve që jetojnë brenda kufijve politikë jugosllavë, por nuk e di se këta shqiptarë jetojnë në tokat e veta të pushtuara nga Jugosllavia dhe mendon se Jugosllavia ka bërë shumë për realizimin e të drejtave të tyre nacionale, sociale dhe ekonomike.

Deri në këtë shkallë, mund të thuhet, uji ka shkuar në mullirin e madh të demagogjisë jugosllave, në krye me klikën titiste. Qëllimi i saj ka qenë dhe mbetet maskimi i numrit të shqiptarëve, i begative të jashtëzakonshme natyrore të tokave shqiptare, maskimi i kompaktësisë etnike të shqiptarëve në të gjitha viset e tyre, me qëllim që, duke mëjellë pos kësaj edhe lugetërit pansllavë për t'u zgjuar e për ta kujtuar "Kosovën serbe", ta bëjnë sa më të largët e më të pakapshme të drejtën historike e kombëtare të shqiptarëve të Kosovës për vetëvendosje dhe për jetesë në kuadër të shtetit unik shqiptar.

Po ka një pjesë të opinionit (të brendshëm e të jashtëm), që e di me themel cështjen e shqiptarëve dhe të tokave të tyre të përfshira brenda kufijve politikë jugosllavë. Këtë opinion e përbëjnë në një anë qarqet politike shqiptare, jugosllave dhe ndërkombëtare, në anën tjetër inteligjenca dhe forcat revolucionare të ne dhe në botë. Kjo pjesë e opinionit e di se "Në kundërshtim të hapët me parimin e kombësisë dhe të vullnetit të popullsive vendëse, nga trungu i Shqipërisë u shkëputën (më 1912 – shën. i red.) krahina të tëra si Rrafshi i Dukagjinit, Kosova dhe tokat shqiptare në Maqedoni. Më tepër se gjysma e popullsisë së vendit dënohej të ndërronte zgjedhën e vjetër turke me një zgjedhë të re, atë të Serbisë dhe të Malit të Zi." [2] Një problem të tillë, çdo palë e akceptón në mënyrën e vet. Opinioni i ngritur shqiptar kërkon rrugë dhe mënyrë për të dalë nga kjo gjendje, që do të thotë për të dalë nga zgjedha serbo-malazezo-maqedonase dhe për t'u bashkuar me vendin amë, Shqipërinë socialiste, për t'i ndarë me të të mirën dhe të ligën që atyre ua ka caktuar rruga e përbashkët historike e një kombi të njëjtë me fate të njëjta; pala tjetër, opinioni i qeverisë jugosllave, që viset shqiptare i shfrytëzon në mënyrën klasike dhe me mjetet klasike me të cilat shfrytëzohet një koloni, e di edhe ai hesapin e vet: deri

1

Rëndësi të veçantë dhe permanente pushteti jugosllav i kushtonte kultivimit të propagandës antishqiptare, që ishte armë e fuqishme në duart e pushtetarëve. Dihej se shqiptarët gjatë të gjitha periudhave në Jugosllavin socialiste nuk kishte mjete të pavarura që në mënyrë të drejtë të informonte opinionin kombëtar si dhe atë ndërkombëtar, andaj edhe ishte krejt e natyrshme që dezinformata arrinte edhe qëllimin e vet optimal. Opinionit të gjerë i mungonin informatat e vërteta për historikun e okupimit të shqiptarëve në Jugosllavi, aktualisht, thoshte autori për opinionin mesatar jugosllav dhe botëror, që manipulon me

informatat elementare dhe fare të cekëta lidhur me Jugosllavinë, në këtë pjesë të Ballkanit, përkatësisht në këtë shtet, ose nuk ka fare shqiptarë, ose ata përbëjnë një pakicë të parëndësishme, që nuk meriton kushedi se çfarë kujdesi. Në rastet më fatlume, një pjesë e opinionit të tillë e di përafërsisht numrin e shqiptarëve që jetojnë brenda kufijve politikë jugosllavë, por nuk e di se këta shqiptar jetojnë në tokat e veta të pushtuara nga Jugosllavia dhe mendon se Jugosllavia ka bërë shumë për realizimin e të drejtave të tyre nacionale, sociale dhe ekonomike.[8] E keqja nuk ka kufi thoshte populli dhe vërtetë, politika sllave kishte shkuar aq larg sa qëllimet e veta ekspansioniste i mbështillte e i kamuflonte sa edhe numrin e popullsisë shqiptare e pat ndarë e copëtuar në disa terme të pakuptimta si mysliman, torbesh, turq e shumë popullsi të tjera që kombi shqiptar as në imagjinatën më fantastike nuk i kishte menduar. Qëllimi i krejt saj dihej, edhe më tej ishte dhe mbeti zvogëlimi i numrit të popullsisë shqiptare, uzurpimi i pasurive të shumta tokësore , maskimi i kompaktësisë etnike shqiptare në të gjitha viset e tyre, me qëllim të përvetësimit të të gjitha të mirave për të bindur opinionin ndërkombëtar se Kosova është tokë serbe, që synimi ishte që ajo të jetë sa më e largët e më të pakapshme të drejtën historike e kombëtare të shqiptarëve të Kosovës për vetëvendosje dhe për jetesë në kuadër të shtetit unik shqiptarë.

Autori duke mos i harruar për asnjë çast vendimet e Konferencës së Bujanit, ai kërkon me këmbëngulje që tokave shqiptare t'iu kthehet e drejta e nëpërkëmbur, duke thënë se "Duke u nisur nga lufta jonë e drejtë, sepse ndryshe s'ka si cilësohet lufta për mbrojtjen e tokave të tua dhe të interesave jetike të popullit tendë; si dhe pjesëmarrja aktive e përhershme e shqiptarëve të Kosovës në vlimet e përgjithshme të historisë së Shqipërisë për ruajtjen e tokave dhe të popullit nga copëtimet e ndryshme barbare; pastaj, me vetëdije të lartë se qeveria titiste e Beogradit, meriton tek e fundit edhe urrejtjen e popujve jugosllav, që lëngon mos më keq nën këmbën e shovinizmit serb, është e natyrshme që ne, revolucionarët kosovar të ndahemi diametralisht me

[8] Po aty. Duhet përmendur ngjarjet e vitit 1918, kur politika Jugosllave me dhunë popullonte zonat kufitare me popullatë serbe vetëm e vetëm për të krijuar bindjen se ato toka janë serbe dhe në to jeton populli serb. Për këtë dukuri kanë shkruar shumë autor si nga shqiptarët po ashtu edhe shumë përshkrues të huaj që kanë hetuar në teren.

mendime nga kjo qeveri dhe nga ky shtet..[9] Duke analizuar veprimtarin atdhetare ilegale të shqiptarëve në tokat shqiptare nën okupimin jugosllav, autori thekson se për këtë të drejtë luftojnë dhe kurrë nuk ndalën bijtë dhe bijat më të mirë të këtij populli në pesëdhjetë organizata e grupime ilegale që veprojnë në Kosovë e më gjerë. Në shkrim thuhej se nga përfundimi i Luftës së Dytë Botërore e gjerë më tani (1980), nëpër burgjet dhe kazamatet serbe gati-gati banorë të përhershëm me shumicë zakonisht janë shqiptarët.

Për anëtarët e organizatave ilegale shqiptare, autori akuzon propagandën që bënë shtypi i vendit si gazetat, radio dhe televizioni. Po ashtu një theks të veçantë e drejton kah gjyqësia jugosllave e cila pa pikën e ndërgjegjes të rinjtë shqiptar të cilët kërkojnë të drejtat e veta legjitime i akuzojnë dhe i dënojnë me vite të shumta burgu. Cekën shumë nene të Ligjit Penal të Jugosllavisë, të cilat veprimtarin e ilegales përparimtare e dënojnë "Për vepër penale të propagandës dhe të bashkimit me qëllim të veprimtarisë armiqësore kundër popullit dhe shtetit", vërtet shtrohet dhe të imponohet pyetja se në emër të cilit popull dhe në emër të cilit shtet dënoheshin shqiptarët. Në emër të kujt u dënuan atdhetarët: Shefqet Jashari[10], Ramadan Pllana[11], Avdi Kelmendi[12], Abdyl Lahu[13], Isa Demaj[14], Sylejman Qyqalla[15], Skënder Jashari[16], Hysen Gërvalla[17], Ibrahim Shala[18], Asllan Loshi, Ruzhdi Saramati e shumë e shumë të tjerë që numërojnë mbi dymijë e më tepër të burgosur politikë shqiptarë. Autori nga këta të burgosur por edha nga rinia shqiptare pret se nuk do të rrijë duarkryq dhe se robërisë shpejt do i

---

[9] Po aty, f, 2.
[10] Shefqet Qerim Jashari, përkthyes, (1944), Strofc, 25.05.1980, neni 136/1 LPJ. (8 vjet burg)
[11] Ramadan Islam Pllana, student, (1947), Shtitaricë, 25.05.1980, neni 136/ 1 LPJ. (7 vjet burg)
[12] Avdi Daut Kelmendi, (1951), Ribar, 25.05.1980, neni 133/ 1 LPJ. (5 vjet burg)
[13] Abdyl Elez Lahu, referent, (1944), Gllamnik, 25.05.1980, neni 133/ 1 LPJ. (4 vjet burg)
[14] Isa Musa Demaj, profesor, (1946), Shkrel, 25.05.1980, neni 133/ 1 LPJ. (4 vjet burg)
[15] Sylejman R. Qyqalla, punëtor, (1954), Bellaqevc, 25.05.1980, neni 133/ 1 LPJ. (4 vjet burg)
[16] Isa Musa Demaj, profesor, (1946), Shkrel, 25.05.1980, neni 133/ 1 LPJ. (4 vjet burg)
[16] Sylejman R. Qyqalla, punëtor, (1954), Bellaqevc, 25.05.1980, neni 133/ 1 LPJ. (4 vjet burg)
[16] Skender M. Jashari, punëtor, (1954), Prishtinë, 25.05.1980, neni 133/ 1 LPJ. (3 vjet burg)
[17] Hysen B. Gërvalla, bujk, (1941), Dubovik, 25.05.1980, neni 133/ 1 LPJ. (3 vjet burg)
[18] Ibrahim I.Shala, nxënës, (1960), Mushtisht, 25.05.1980, neni 136/ 1,114 LPJ. (5 vjet burg)

vij fundi. Andaj me të drejtë ai edhe përdori thënien si titull të shkrimit: "Perditio tua, Israel, ex te"[19]

1. 5. Viktima dhe vartësia e tij nga xhelati

Në një shkrim tjetër të titulluar "Viktima që glorifikon xhelatin e vet", autori e që supozohet se është atdhetari i njohur Jusuf Gërvalla, i cili dialogon me një pushtetar shqiptar për gazetën e përditshme "Rilindja". Punimi fillon me fjalët "Besoj se e lexon "Rilindjen". E ke të vetmen gazetë të përditshme në gjuhën tënde, në pjesën e robëruar të Shqipërisë.[20] Në shkrim elaborohet dhe jepen pjesë të shkrimeve që i prezanton "Rilindja në faqet e saja. Thënë ndryshe, autori klithë në këtë shkrim, kur me fakte na dëshmon se çfarë shkruan gazeta në faqet e saja, megjithëse shpesh na prezanton shkrimet fyese për popullin shqiptar. Autori porosit se edhe pse është e tillë ne duhet ta lexojmë gazetën "Rilindja", ngase nuk kemi tjetër dhe se megjithatë diçka kuptojmë nga ajo. Herë-herë në pikë të dëshirimit, shkruan se "Ti e ke ditur që "Rilindja" është organ i LSPP të Kosovës, LSPP e Kosovës degë e LSPP të Jugosllavisë; LSPP e Jugosllavisë shpikje e pakripë e klikës titiste, klika titiste mashë e shovinizmit dhe e hegjemonisë të lig serb... e kështu me radhë, deri te pansllavizmi i mykur![21]

Autori, është i habitur, me prezantimin e shkrimeve të padenja që i boton gazeta. Është për tu habitur se në faqet e gazetës, për 35 vjet , ajo nxori në faqet e saja, më së paku 12.775 herë në faqen e parë fotografin e Titos, dhe ironia ishte edhe më e madhe, kur kjo gazetë po ashtu edhe më tepër se botimin e fotografisë e ka shkruar se "Tito, e kaluara, e tashmja dhe e ardhmja jonë e vetme", dhe kjo thënie komentohet në mënyrën më të mirë të mundshme duke e analizuar me logjikën e shëndosh të atdhetarit, se xhelati mundet me qenë e kaluar dhe e tashmja por, si guxon të quhet e ardhmja e jonë, deri sa ne krahasohemi me viktimat e një pushteti. Viktima mundet me pas të kaluar dhe të tashme, por si mundemi të gjykojmë pa fijen e turpit se edhe në të ardhmen mundemi ta duam xhelatin.

---

[19] "Humbja jote , Izrael, përmbi ty"; pra vetë e ke fajin për shkatërrimin tënd, Lajmëtari i Lirisë, Viti. I, nr. 1, gusht 1980, f, 2.

[20] Viktima që glorifikon xhelatin e vet, Lajmëtari i Lirisë', viti I, nr. 1. gusht 1980, f, 2.

[21] Po aty.

Shtypi legal që botohej në ato vite në Kosovë, sipas autorit të shkrimit, nuk kishte as guximin qytetar e as kombëtar që të ballafaqohej me problemet të cilat vërtet e mundonin popullin shqiptar, dhe në mënyrë të denjë ti prezantonte ato. Duhet thënë si në çdo fushë të jetës së shqiptarit, e aq më tepër në lëmin e informimit, apo më mirë të themi në fushën e dezinformimit, politika jugosllave kishte vënë një sitë të hekurt dhe nuk lejonte të rridhnin informata që nuk i shkonin për qejfi pushtetarëve. Edhe pse gazeta "Rilindja" u deshtë të ishte gazetë që duhej të informonte për zhvillimet politike, shoqërore, ekonomike, kulturore, sportive e çka jo tjetër, ajo me apo pa dashje opinionin e gjerë e informonte me problemet efemere që e shqetësonin njeriun e nënqiellit tonë. Ta zëmë se më 27 prill 1980, gazeta shkruante këtë artikull me titull "Urdhëroni parmenda", titull, se jo mahi, fundi i shekullit 20, në Kosovë shkruhej për suksesin e madh të shitjes së parmendës. Dhe shtrohej pyetja duhet lexuar gazetën vetëm e vetëm se duhet të lexohet, apo duhet bërë diçka për të ndryshuar këtë situatë të amullt në informimin tonë.

1. 6. Prezantimi i "Pushtetit Popullor" në faqet e gazetës

Në një mënyrë tjetër, ndoshta më të thjeshtuar dhe më të kapshme për popullin , autori i shkrimit "Konjugacionet e një pushteti "popullor", na ofron të dhëna të rëndësishme se si dhe në çfarë mënyre pushteti "popullor" e tregon fytyrën e vet. Në shkrim merren shumë shembuj se si sillen pushtetarët në momente e situata të caktuara. Ta zëmë se, kur fletë për këngën e kënduar në konviktet e studentëve me 4 maj 1980. Kënga ishte rinore, dhe plotë gjallëri, por ç'ndodhi më vonë, merrni me mend vetëm për një këngë të kënduar, rrethohet konvikti me forca të mëdha policore, dhe arrestohen studentët këngëtar, vetëm e vetëm se ajo ditë ishte ditë zie, në Jugosllavi, e ç'faj kishin studentët që kënduan këngën e Azem Bejtës e të Idriz Seferit ta zëmë.

Ose ta zëmë, se shqiptari dënohej edhe për hiq gjë, si rasti i një fshatar nga Deçani kishte pyetur për Jovankën (gruaja e Josip Broz Titos), se ku ishte, dhe kishte kohë që nuk dukej në televizion. Organet e ndjekjes kishin dëgjuar për këtë bisedë, dhe e arrestojnë fshatarin me arsye se kishte veprua kundër shtetit dhe popullit.

Fytyrën e vërtet, pushteti jugosllav e kishte tregua edhe në një rast, kur në Prishtinë ishte luajtur një lojë sportive që ishte luajtur në mes ekipit të basketbollit të Tiranës dhe të një ekipi vendor, pas se masa e të rinjve kishte brohoritur duke përkrahur ekipin nga Tirana, policët që përcillnin ndeshjen ishin çartur dhe kishin arrestuar shumë të rinj shqiptar,arsyeja ishte se ata kishin anuar për ekipin nga Tirana, dhe absurdi nuk kishte skaj, se pushtetarët jugosllavë mendonin se mund të dirigjonin edhe në këtë drejtim se kënd duhesh ta simpatizosh e kënd jo.

Autori na sjell edhe një ngjarje tjetër e cila dëshmon për ndërhyrjen e policisë në konviktet e studentëve. Përsëri bëhej fjalë për guximin e studentëve që këndonin për qejfin e tyre. Edhe pse ditët e zisë për vdekjen e Titos kishin përfunduar, për policin ishte ende e ndalueshme që në konviktet e studentëve të dëgjohej kënga. Okupuesi gjithçka duronte, porse këngën tek rinia kosovare nuk e merrte dot me mend. Andaj mu kjo ishte shkaktare që një ditë të ngrohët vere, policia mori "Mundin" dhe bllokoi të gjitha dalje- ardhjet në konviktet e studentëve. "Kjo s'ishte hera e parë që pushteti i policisë "popullore" po rrekej të manifestohej në tërë "madhështinë" e vet mbi të rinjtë e pafajshëm, që s'duan t'ia dinë se qenka e ndaluar të këndohet shqip. Mirëpo durimi ka kufi. Dhe studentët, që kanë edhe ata "njëfarë" force, me të cilën i brumos ndjenja se do të bëhen bartës të të mirave të jetës, në një të ardhme të afërt, kishin ngulur këmbë që ta manifestonin edhe ata hovin e tyre të pandashëm"[22]. Autori i këtij shkrimi, analizon reagimin e studentëve dhe guximin e tyre, duke profetizuar, se ndoshta mu në këtë mënyrë fillon "një lojë" e re për trojet tona. Duke paralajmëruar popullin shqiptarë se pika e durimit kishte arritur kulmin dhe gjithsesi duhej të shpërthej, por kur se ende nuk dihej, por autori i shkrimit paralajmëronte diçka ... me anën e këtij shkrimi.

1. 7. Denjësisht prezantoheshin heronjtë e kombit

Në faqen 5 (pesë), të gazetës, prezantohej "Shqipja e maleve-Bajram Curri", e shkruar nga Profesor Stefanaq Pollo. Dihej se në Kosovë, në ato vite nuk ishte fortë e dëshirueshme që të shkruhej për figurat e ndritura të historisë kombëtare, andaj shkrimi për këtë hero

[22] Konjugacionet e një pushteti "popullor", Lajmëtari i Lirisë, viti I, nr. 1, gusht 1980, f, 4

dëshmonte qartë se populli shqiptarë asnjëherë gjatë historisë nuk ka qenë i kënaqur me copëtimin e tokave të veta. Andaj, Bajram Curri ishte njëra ndër figurat e shquara të popullit që u takonte dy periudhave të rëndësishme historike-periudhës së fundit të luftës për liri e pavarësi nga zgjedha osmane dhe asaj të luftës për vetëvendosjen e rendit demokratik në Shqipërinë e pavarur. Në të dyja këto periudha emri i këtij heroi të bjeshkëve shqiptare u bë flamur, simbol i patriotizmit të flakët popullor dhe i vendosmërisë së paepur në përleshjet me armiqtë e jashtëm e të brendshëm të atdheut, ndërsa vepra e tij - një gur graniti në themelet e Shqipërisë së pavarur[23]" shkruante profesor Stefanaq Pollo duke e ngritur lart luftën dhe angazhimin e tij për çlirim kombëtar.

Gazeta "Lajmëtari i Lirisë"", siç e cekëm edhe më lartë, karakterizohej me punimet kryesisht që kishin karakter kombëtar. Në faqet e saja mund të gjesh punimet nga më të ndryshmet. Në faqen e gjashtë të gazetës hasim edhe në një punim "Rekuiem për një monark", (që shkruhet me rastin e vdekjes së monstrumit revizionist, J.B. Tito, këtij armiku të përbetuar të popullit shqiptar). Shkrimi nuk ka emër e as mbiemër të autorit, por është interesant se në këtë gazetë nuk praktikohej që të përdoreshin as pseudonimet. Sipas Kadri Rexhës, në librin "Fati i luleve...", ai thotë se edhe këtë shkrim e ka shkruar Jusuf Gërvalla.[24] Punimi ishte i ndarë në pesë nëntituj: 1. Kush ma zuri diellin, ia zënët thera shpirtin, 2. Dy datëlindje-dy ditëvdekje, 3. Dy emra, shumë fytyra, 4. Dy e dy bëjnë- 10 muaj me ajër të pastër! dhe 5. A mbahet shpirti me kulumbria?. Është për tu veçuar se autori i shkrimit është largpamës dhe shumë vizionar, në njëfarë mënyre, na dëften, e që ngjarjet e më vonshme na bindin se atë që kishte shkruar autori i paraprinin ngjarjeve të vitit 1981. Me dhembje pyet autori tani pasi vdiq Titua, çfarë do të ndodhë me shqiptaret, apo do të ndjekim rrugën e Titos, siç trumbetonin disa renegat të tij. Por është i bindur se "kështu nuk na mëson historia dhe tradita luftarake e popullit tonë; a na mësojnë kështu rrugët revolucionare të popullit tonë dhe të popujve të botës, që kanë hequr

[23] Prof. Stefanaq Pollo, Shqipja e maleve-Bajram Curri, Lajmëtari i Lirisë, viti I, nr. 1. gusht 1980, f, 5.
[24] Kadri Rexha, Fati i luleve , Rruga jetësore e shkrimtarit dhe atdhetarit Jusuf Gërvalla, Prishtinë, 1993, f, 165.

qafe përbindësh shumë më të mëdhenj se titizmi, i cili i ka të cektë rrënjët"25 shkruan në pjesën e fundit të shkrimit.

Në vazhdim të gazetës, po ashtu është shkrimi tjetër i radhës, i quajtur "Renegati" (Prolegomenë për historianin, zhvillimin dhe perspektivën e dështakut më të madh të fisit njerëzor). Edhe ky shkrim është i ndarë në dymbëdhjetë pjesë më të vogla që përfshihet kryesisht historiku, zhvillimi, dhe perspektiva e renegatit. Autori në fillim të shkrimit, na tregon se çka do të thotë fjala renegat: se "ndër fjalorë, renegatin e gjejmë te shkronja r me këtë shpjegim përkatës: renegati vjen nga lat. Renëgate (re...+ne-gare-me mohue) dhe shënon njeriun që ka ndërrua mendje, bindjen e përparshme, dhe ka dal në taborin kundërshtar, në taborin e armikut; ai është edhe i arratisur, dezertor, përçarës, tradhtar, pjellë e keqe, kopil...[26]. Për të vazhduar më tej autori se renegatin e gjejmë kryesisht në të gjitha paralelet dhe meridianët e planetit Tokë. Sidomos në gji vendesh dhe popujsh të pushtuar e të kolonizuar,[27] konkludon autori.

Në pjesën "Ekologjia e renegatit", autori përshkruan se në çfarë vendesh e zona kultivohet renegati. Zhvillimin e renegatit, autori e përshkruan si në ekuacionin e filozofisë së ujkut, dhijes dhe lakrës. Për të ekzistuar ujku, duhet të zhduket dhia, dhe për të jetuar dhia duhet të zhduket lakra. Dhe sipas të gjitha gjasave renegati na del dhe luan rolin e pykës , që gjithmonë shërben për të çarë trupin e palës së dobët, të viktimës. Autori me një sens prej krijuesi e përshkruan se çfarë klime duhet të dominojë për të gjalluar renegati. Pasiguria, injoranca, pështjellimi, anarkia, altruizmi i inskenuar, përçarja, analfabetizmi, tradhtia dhe të gjitha ato sherre që mbillen, piqen e korrën për ngut, pa e pritur njëra-tjetrën[28] thotë autori.

Në pjesën "Format e ekzistencës së renegatit" si dhe në pjesën "Përkufizimi i qenies së renegatit", prezantohet renegati se çfarë është në

[25] Rekuiem për një monark (Më rastin e vdekjes së monstrumit revizionist J.B. Tito, këtij armiku të përbetuar të popullit shqiptarë), Lajmëtari i Lirisë, viti I, nr. 1, gusht 1980.
[26] Renegati (Prolegomenë për historiatin, zhvillimin dhe perspektivën e dështakut më të madh të fisit njerëzor). – prejardhja dhe shtrirja e renegatit, Lajmëtari i Lirisë, viti I, nr. 1. gusht 1980, f, 8.
[27] Prejardhja dhe shtrirja e renegatit, Lajmëtari i Lirisë, viti I, nr. 1. Gusht 1980, f, 8.
[28] Ekologjia e renegatit, Lajmëtari i Lirisë, viti I, nr. 1. Gusht 1980, f, 8.

gjendje që të bëjë dhe se nuk është fare e rëndësishme se kënd dëmton dhe shkatërron.

Në pjesën e katërt, nën a), përshkruhet "Plani metafiziko-mistik" i renegatit, të cilin autori e paraqet se të gjitha doktrinat fetare e kanë evidencuar ekzistencën e shpirtit të lig, i cili jeton në shpirtin e njerëzve që për qëllim kanë joshjen e njerëzve nga rruga e drejtë në atë të ligën, dhe thotë se me një fjalë këta quhen edhe "hafije" dhe vet zoti atyre iu ka caktuar vendin më të keq në rrathët e ferrit. Po ndryshe nga fryma e ligë mistike, renegati e ha bukën dhe, si të tillë, edhe renegatin e ha plumbi. (Po të ketë kush ia jep)[29]

Në nën pjesët:

b) Plani antropologjik;

c) Plani zoologjik;

ç) Plani botanik;

d) Plani i sendeve dhe objekteve, përshkruhet në vija të trasha se si duket, vepron dhe asgjëson sojin e vet renegati.

Ndërsa në pjesët: "Shumimi i renegatit" dhe "Përfaqësuesi i renegatit", autori thotë se tereni më i përshtatshëm për ta janë tokat shqiptare të okupuara dhe se renegatet për interesa meskine janë në gjendje që edhe shpirtin t'i shesin djallit vetëm e vetëm për ti gëzua ca të mira, që në një afat më të gjatë kohor janë të pështira dhe të turpshme. Dhe në pjesën e fundit "Perspektiva e renegatit për ekzistencë", autori thotë në mënyrë të prerë se renegati e ka jetën e shkurtër dhe ajo jetë zakonisht zhvillohet nga një hark kohor sa zgjatë nata. Me lajmërimin e parë të rrezeve të diellit, ai zhduket. Autori, njerëzit-Renegat i quan se janë insekte të një kombi dhe jetën e bëjnë prej insekti. Për këto insekte nuk ekzistojnë mëngjeset, mesditat, mbrëmjet, për to nuk ekziston kohë tjetër veç muzgut, ku ata lindin dhe vdesin"[30]

Një shkrim tjetër "Kthimi i birit plëngprishës" (Ëndërr në tri pamje)[31], autori shkruan për një ëndërr të vetën, që e shpjegon se këto mrekulli ndodhin vetëm në ëndërr. Ëndrra ka të bëjë me figurën dhe personalitetin e një politikani shqiptar i cili në kohën kur u shkrua ky

[29] A),Plani metafizioko-mistik, po aty.
[30] Perspektiva e renegatit për ekzistencë, Lajmëtari i Lirisë, Viti I, nr. 1. Gusht 1980, f, 9.
[31] Kthimi i birit plëngprishës (Ëndërr në tri pamje), Lajmëtari i Lirisë, viti I, nr. 1. Gusht 1980, f, 9.

tekst ishte anëtar i KQ të LKJ-së. Në vazhdim shkruan autori anonim se kishte ëndërruar se anëtari i Komitetit..., në vend që të shkonte dhe ta përfaqësonte PKJ në një Kongres të partive Komuniste evropiane, udhëheqësi shqiptar paraqitet në Berlin për të kërkuar azil politik. Duke dëshmuar hapur se shqiptarët në Jugosllavinë "Komunist", janë të robëruar dhe të okupuar. Dëshmon se ata nuk kanë kurrfarë të drejtash dhe për çdo ditë torturohen e masakrohen nga ana e policisë.

Këtë ëndërr, autori e shkruan në gazetën "Lajmëtari i Lirisë", çka është e vërteta, kështu kishte dëshirua dhe kishte pas qejf autori të kishte ndodhur, por realiteti ishte pak më ndryshe në Kosovë. Pushtetarët jugosllav, edhe në Kosovë kishin gjetur veglat e tyre, të cilët pa hezituar se a po vuante populli apo ishte i robëruar ata shikonin interesat e vockla të tyre, duke mos qarë kokën për të drejtat që kishin mundur ti kishin dhe ti gëzonin shqiptaret në tokat e tyre.

Në faqen 9 (nëntë) të gazetës, është e botuar edhe një poezi e shkrimtarit të Rilindjes Kombëtare, Andon Zako Çajupit, e botuar më 1905. Poezia "Malli i Shqipërisë", i kushtohej mërgatës shqiptare dhe grave të cilat fillikat vetëm bëjnë punët e rënda si në shtëpi, por edhe në fushë dhe askush nuk e qanë kokën për to. Herë-herë, poetit nga punët që bëjnë në fushë dhe të leckosura me kokën për poshtë, nga larg as nuk dallohen se çka janë: "Me ca petka vëra-vëra/ u çuditçë kur i pashë/ me kokë poshtë të tëra/- ç'janë këto kafshë?- thashë"[32]. Kështu thotë poeti, por më vonë edhe e shpjegon pse ndodhë kështu, burrat shqiptarë jo se nuk i duan gratë e tyre, por në një mënyrë janë të detyruar për të siguruar kafshatën e bukës që të marrin botën në sy dhe të shkojnë në kurbet.

Në rreshtat e mëvonshëm, arsyeton poeti: "Burrat vetëm ju lanë/ dhe rripën ndë dhe të huaj/ata më keq nga ju janë/ se ju rroni ndë vend tuaj"[33]. Në bazë të rreshtave që na prezantohen poeti e ndjen rëndë

[32] Malli i Shqipërisë, Lajmëtari i Lirisë, viti I, nr. 1, Gusht 1980, f, 10.

[33] Andon Zako Çajupi, Lindi ne Sheper te Zagorisë me 1866. Ne Nivan beri një pjese te shkollës se mesme, te cilat i plotësoi ne një lice francez ne Egjipt, ku jetonte i ati. Me 1887, Çajupi shkoi ne Zvicër. Atje kreu studimet e larta dhe mori titullin e doktorit te drejtësisë. Ne Kajro, ku u vendos për gjithnjë, punoi për një fare kohe si avokat. Nga fundi i shek XIX mori pjese gjallërisht ne lëvizjen patriotike shqiptare. Me 1909 botoi shkrimin e njohur "Klubi i Selanikut", një pamflet dërmues kundër armiqve te brendshëm te lëvizjes kombëtare shqiptare. Patriotizmi i flakte dhe qëndrimi i prere ndaj pushtuesve te huaj e nxorën Çajupin ne krye te patrioteve qe vepronin ne Egjipt. Me 1919 u zgjodh kryetari i shoqërisë "Vëllazëria" me qendër ne Kajro. Qe frymëzuesi dhe njeri nga hartuesit e memorandumit qe shqiptaret e Egjiptit i dërguan Konferencës se Paqes me 1919 ne mbrojtje te tërësisë territoriale te Shqipërisë. Me 1920 themeloi "Shoqërinë e Miqve". Pothuaj ne te njëjtën kohe me veprimtarinë atdhetare Çajupi u

plagën e mërgimit, andaj edhe vije në përfundim se vërtet gratë vuajnë e mundohen duke punuar, por bile jetojnë në tokën e shtëpitë e veta, ndërsa burrat rropatën në kurbet duke pasur mall për çdo gjë që ka aromë vendlindjeje.

1. 8. Ndërhyrja e PKJ-së në punët e brendshme të PKSH-së

Në shkrimin "Ndërhyrja brutale e udhëheqjes së PK Jugosllave në punët e brendshme të PKSH", redaksia e gazetës ka huazuar një pjesë shkrimi nga libri "Historia e Partisë së Punës së Shqipërisë". Në këtë pjesë paraqitet lindja e konfliktit në mes PKJ dhe PKSH-së, dhe aspiratat gllabëruese të Jugosllavisë ndaj tokave shqiptare. Theks të veçantë në këtë tekst i jepet Plenumit II të Komitetit Qendror të PKSH ose ndryshe i njohur si Plenumi i Beratit, i mbajtur me 23 nëntor 1943. Në vija të përgjithshme jepen vizitat e shumta dhe ndërhyrjet në punët e brendshme të PKSH-së, që i bëjnë delegacionet e shumta të PKJ-së. Vlen të përmendet vizita e Svetozar Vukmanoviq- Tempo në verë të vitit 1943, që llogaritej se ishte njëri ndër udhëheqësit kryesor të PKJ-së i cili në Shqipëri kishte ardhur me mision të posaçëm për të krijuar "Shtabin Ballkanik", Në këtë rast në mënyrë të hapur kishte paditur në mënyrë të palejueshme dhe të padrejtë Komitetin Qendror të Partisë Komuniste të Shqipërisë për qëndrim oportunist ndaj "Ballit Kombëtar". Kjo shpifje trashanike bëhej me qëllim të caktuar që të krijohej mendimi se gjoja KQ e PKSH nuk ishte në gjendje të drejtonte në mënyrë të pavarur, se ai nuk mund të mos gabonte rëndë pa marrë direktiva nga "udhëheqja me përvojë" e Partisë Komuniste të Jugosllavisë[34]. Ardhja e Tempos në Shqipëri dhe ndërhyrja e tij në punët e brendshme të PKSH nuk ishte e vetmja.

Për të arritur qëllimet e veta KQ i PKJ-së, kishte dërguar me mision special Velimir Stojniqin, në cilësi të shefit të misionit ushtarak

---

mor dhe me letërsinë. Me 1902 botoi librin "Baba Tomori" nja nga veprat me te shquara te letërsisë se Rilindjes, komedinë e njohur "Katërmbëdhjetë vjeç dhëndër". . Disa nga krijimet e tij me te shquara patriotike janë: "Mëmëdheu", "Shqiptar", "Ç'jemi?..., Ku kemi lere?", "Vaj", "Besa-besën", "Atdheu dhe Dashuria", etj te tjera vjersha me teme shoqërore janë: "Fshati im", "Kurbeti", "Fyelli i bariut", Misiri", "Varfëria dhe Liria" etj. Ne historinë e letërsisë shqiptare, Çajupi është dalluar dhe si dramaturg. Çajupi u mor edhe me përkthime. Përveç një varg vjershash dhe fabulash qe botoi ne "Baba Tomori", me 1921 botoi "Përralla te zgjedhura te vjershëtarit te madh La Fontenit". Me 1922 u botua "Lulet e Hindit" përmbledhje me vjersha te poeteve indiane. Çajupi vdiq me 1930.

[34] Ndërhyrja brutale e udhëheqjes së PK Jugosllave në punët e brendshme të PKSH, Lajmëtari i Lirisë, viti I, nr. 1. Gusht 1980, f, 12.

jugosllav dhe të ndërlidhësit midis PKJ dhe PKSH-së. Velimir Stojniqi, me akuzat dhe sulmet që i bëri PKSH-së nuk ngeli mbrapa nga paraardhësi i tij. Përfaqësuesi jugosllav e errësoi krejt veprimtarinë e këshillave nacional-çlirimtare, të ushtrisë Nacional-Çlirimtare, të komisarëve politikë dhe kërkoi që ushtria të pajisej me një "kokë të fortë politike" e me një "komandë të fortë ushtarake". Në mënyrë të posaçme ai u përqendrua në marrëdhëniet jugosllave-shqiptare mbi bazën e "vëllazërimit ballkanik". "Shqipëria ,- deklaroi Velimir Stojniqi,- nuk mund të ndërtoi ekonominë dhe të zhvillohet në mënyrë të pavarur, ajo është një kafshatë e vogël për imperializmin", prandaj nuk ka tjetër rrugë veçse që të lidhet me Jugosllavinë në një konfederatë, bile edhe më tutje[35]. Megjithatë, komploti që ishte përgatitur me aq kujdes në PKJ, konstaton autori se nuk pati sukses për arsye se populli dhe uniteti i treguar tek shumica e anëtarëve të KQ të PKSH-së, u tregua e pjekur dhe e vendosur në rrugën e mëvetësisë.

1. 9. Prezantimi i tipareve të gruas shqiptare tek të huajt

Shtypi i ilegales që botohej në Kosovë por edhe jashtë saj, i kushtonte rëndësi të madhe prezantimit të denjë të gruas në përgjithësi e në veçanti asaj shqiptare. Gazeta "Lajmëtari i Lirisë", në çdo numër të saj gati-gati çdo herë i kushtonte nga një faqe për luftën, angazhimin e gruas shqiptare në luftërat për liri e pavarësi.

Veç autorëve shqiptar që i kënduan gruas shqiptare, për të shkruan edhe shumë autor të huaj, të cilët kishin arritur në përfundime të përbashkëta se populli shqiptar është një nga kombet më të bukur nga pikëpamja fizike, madje ndonjë prej këtyre udhëtarëve shkencëtarë i quante shqiptarët si "kombësinë ndoshta më të bukur të "Turqisë Perëndimore"[36]. Në punimin "Krah për krah me burrin në luftën për liri", autori Ligor Mile, shkruante se një shkencëtar i huaj kishte thënë për gruan shqiptare se gratë që nxjerrin në dritë burra të pamposhtur dhe trupmëdhenj dallohen gjithashtu për forcën e organizimit të tyre edhe për thjeshtësinë e zakoneve të tyre... Ato ndajnë me burrat punët, udhëtimet dhe rreziqet e tyre". Ndërsa një udhëtar francezë i mesit të viteve 30 të shekullit të 19-të, pasi u njohë me popullsinë e trevës së

[35] Po aty, f, 13.
[36] Krah për krah me burrin në luftën për liri, Lajmëtari i Lirisë, viti I, nr. 1. Gusht 1980. f, 14.

Tomorit, erdhi në përfundim se "Midis luftëtarëve të Tomorit dhe midis grave të tyre gjendën më shumë se një model për një Apollon dhe për një Venus"[37]

Duke u marr me vlerat shpirtërore të popullit shqiptarë, autorë bashkëkohorë qenë të një mendimi se "krenaria kombëtare shfaqet edhe në fjalët më të vogla të shqiptarëve, në gjestet e tyre, në ecjen e tyre të lehtë. Guximin e kanë që nga lindja e qysh në vogëli, ata janë qitës të shkëlqyer. Një nga gjeografët më të njohur evropianë të viteve 70 të shekullit të 19-të i përshkruante shqiptarët si "të dalluar për finesën e shpirtit, për qartësinë e mendimit dhe për forcën e karakterit"[38] shkruan gjeografi i huaj.

Gjatë lëvizjes kryengritëse, që shpërtheu në vitet 1844-1845 në verilindje të Shqipërisë, në Kosovë dhe në Dibër, dokumentacioni arkivor na dëshmon se në malësitë e lira "gra dhe fëmijë bënin pjesë në radhët e luftëtarëve", "se "gratë qenë të ngjeshura me armë, të veshura ushtarakisht" duhet dalluar sidomos gratë në Shqipërinë e Sipërme.

Duhet cekur se gruaja shqiptare në asnjë periudhë kur ishte vendi në rrezik nuk qëndroi duarkryq. Shembujt e pjesëmarrjes së gruas në luftërat për liri janë të shumta, sidomos duhet përmendur luftërat që nga Lidhja Shqiptare e Prizrenit e këndej. Ky patriotizëm i njohur i gruas shqiptare, këto cilësi të rralla morale të saj, morën një përmbajtje të re dhe u shfaqën me forcë në ato gra e vajza të popullit që veshën rrobat partizane dhe luftuan krah për krah me burrat gjatë LANÇ[39].

Edhe pse kishte përfunduar Lufta e Dytë Botërore, burrat e gratë e Kosovës nuk u kënaqen me gjendjen ekzistuese. Ata gjetën forma e mënyra që ti kundërvihen okupuesit të "ri". Gratë shqiptare në Kosovë dhe viset tjera shqiptare në ish-Jugosllavi, krah për krah me burrat u ndodhën në krye të detyrës duke organizuar fillimisht grupe e organizata ilegale e më vonë me formimin e UÇK-së, dolën edhe në male duke u bërë pjesë e denjë e luftërave për liri.

1. 10. Prezantimi i poezive në faqet e gazetës

[37] Po aty
[38] Po aty.
[39] Po aty. Dr. Sabile Keçmezi-Basha, Gratë shqiptare për çështjen kombëtare, Rilindja (fejton)…

Në faqen 15, të gazetës zënë vend edhe disa poezi të Ndoc Gjetës. Ndoc Gjeta u lind më 1944 në fshatin Bërdicë të Shkodrës, por në Lezhë u vendos me familjen që kur ishte 7 vjeç. Ai është ndarë nga jeta më 7 qershor 2010, në moshën 66-vjeçare. Konsiderohet si një nga poetët më origjinalë shqiptarë. Kishte botuar vëllimin e parë poetik "Rrezatim", pastaj "Shqiponja rreh krahët" (1975), "Qëndresa" (1977), "E përditshme" (1982), "Çaste" (1984), "Poezi" (1987), "Kthimet" (1991) dhe "Dhjata ime" (1998). Autori në "Lajmëtari i Lirisë" prezantohet me tri poezi që kryesisht kanë karakter atdhetar siç janë: "Më kishin ardhur njerëzit", "Gjyshit" dhe poezia "Unë shtëpinë e kam te fjala "shok". Në poezinë "Gjyshit" autori na paraqet fatin e kombit shqiptar që nëpër vite u përndjek, u zhduk, porse megjithatë nuk ia arritën qëllimit. Poeti këndon se poçese ka nevojë, ai është në gjendje që: Gjakun tim te udha e jetës/pika-pika e piftë dheu/gjithsaherë ti thahet buza, gjithsaherë ta marrë etja/e iu bëftë shëndet e gëzim/u bëftë lule, gjeth e bar/u bëftë rrita e Shqipërisë,/zë fëmije ndër pelena"[40], përfundon autori duke e mbyll poezinë me vargje dëshirore.

2. VAZHDON RRUGËN E INFORMIMIT TË DREJT, NUMRI 2 (DY) I GAZETËS "LAJMËTARI I LIRISË"

Numri 2 (dy), i gazetës "Lajmëtari i Lirisë", botohet pas dy muajve, po ashtu duke e ruajtur fizionominë si në aspektin teknik, po ashtu edhe në atë përmbajtjesor. Botohet në letër A-4, me një teknik duke u shtypur fillimisht në makinë shkrimi, e më vonë duke u shumëzuar në shaptilograf. Materia e përfshirë në të është nga më të ndryshmet si nga fusha politike, ekonomike, arsimore e lëmi të tjera që ishin me interes për mërgatën shqiptare që jetonte e vepronte në mërgim.

Sikurse edhe numri i parë, për moto kishte thënien e njëjtë "Me penë dhe pushkë...", veç kësaj, gazeta ka në ballinë edhe një pjesë shkrimi të marr nga Arben Puto ku thuhej se "Në kundërshtim të hapët me parimin e kombësisë dhe të vullnetit të popullsive vendëse, nga trungu i Shqipërisë u shkëputën krahina të tëra si Rrafshi i Dukagjinit, Kosova dhe tokat shqiptare në Maqedoni. Më tepër se gjysma e

[40] Ndoc Gjetja, Gjyshit, Lajmëtari i Lirisë, viti I, nr. 1. Gusht 1980, f, 15.

popullsisë së vendit dënohej të ndërronte zgjedhën e vjetër turke me një zgjedhë të re, atë të Serbisë dhe të Malit të Zi"[41].

Numri i kushtohet festave të nëntorit, duke iu uruar të gjithë lexuesve "Gëzuar festat e Nëntorit". Në ballinë është edhe një vizatim që portretizohen tre luftëtar.

Gazeta si zakonisht fillon me shkrimet të cilat trajtojnë jetën e rëndë e të robëruar të shqiptarëve në Kosovë dhe në viset tjera shqiptare nën ish-Jugosllavi.

2. 1. Arrestimet e burgosjet e shqiptarëve

Në faqen e dytë të gazetës, prezantohet një shkrim "Jo ngushëllime, po urim", në të cilin nuk figuron kurrfarë emri autorësh. Si shkas të shkrimit, autori i panjohur shtjellon ngjarjet e fundit politike dhe arrestime që organizohen ndaj shqiptarëve. Në fillim të shkrimit, jepen të dhëna se si është dënuar dhe është gjobitur Millovan Gjillasi nga pushtetarët e atëhershëm. Ndërsa në pjesën e dytë të shkrimit, autori na dëften se si është dënuar atdhetari Adem Demaçi. Ai shkruan se "Është një "plebej" shqiptar, i cili po dënohet qe tri herë me burg të rëndë. Një herë pesë, pastaj dy herë nga pesëmbëdhjetë vjet! Tamam aq sa të mos e shohë kurrë diellin me sy! Madje pa nxjerrë kurrfarë gazete si "Çasovnik-un" që e kishte nxjerr Millovan Gjillasi. Anomali, pyet autori i shkrimit, dhe përgjigjej me - Jo[42]. Historia na kishte mësuar se okupuesi në çdo kohë dhe në çdo periudhë mllefin e vet e shprehte sidomos ndaj atyre që iu kishte frikën. Andaj edhe vazhdon në shkrimin se: Dënimet më të rënda një shtet i ka për njerëzit që paraqesin rrezikun më të madh për atë shtet.[43] Për të vazhduar se UDB-eja i ka llogarit e veta, shumë të qarta: dënimet sa më të rënda për patriotët shqiptarë, izolimin total të familjeve të këtyre patriotëve , presionin politik edhe mbi rrethin e ngushtë e të gjerë të tyre... A ka fakte më të mira që të na mbushin mendjen se, për Serbinë hegjemoniste, pika neuralgjike jemi pikërisht ne, shqiptarët. Dhe a duhet të na dëshpëroi e të na trembë kjo gjë, apo të na bëjë çdo ditë më të lumtur e më të fortë, se kështu po i

[41] Lajmëtari i Lirisë, viti I, nr. 2, Tetor-nëntor 1980, (ballinë)
[42] Jo ngushëllime, po urim, Lajmëtari i lirisë, viti I, nr. 2. Tetor-nëntor 1980, f, 2.
[43] Po aty.

afrohemi realizimit të aspiratave tona shekullore[44]. Nga kjo del se njëherë e mirë të gjithë shqiptarët kudo që janë, e kanë të qartë se liria e një populli nuk fitohet pa gjak dhe pa sakrifica.

Autori me pseudonimin Lul Ndreu (Jusuf Gërvalla), na jep të dhëna që janë alarmuese, se UDB-eja jugosllave kishte marr hapa tronditës ndaj shqiptarëve, duke arrestuar dhe dënuar për hiq gjë shumë të rinj shqiptarë. Me 10 qershor të këtij viti (1980, S.K-B), "Rilindja" mori leje të nxirrte emrat e një grupi prej 8 vetash : Shefqet Jashari[45], Ramadan Pllana[46], Avdi Kelmendi[47], Abdyl Lahu[48], Isa Demaj[49], Sylejman Qyqalla[50], Skender Jashari[51] dhe Hysen Gërvalla[52]- që Gjykata e Qarkut në Prishtinë u dha dënime 3-8 vjet burg të rëndë për "vepër penale të propagandës dhe bashkim me qëllim të veprimtarisë armiqësore". Një muaj më vonë po kjo gazetë solli edhe lajmin nga Gjyqi i Qarkut në Shkup, i cili për të njëjtën "vepër" kishte dënuar me 3-6 vjet burg të rëndë Gani Sylajn[53], Muharrem Shalanin[54] dhe Haxhi Maliqin[55]. As te grupi i parë e as te grupi i dytë (dhe as te afro 2000 të burgosurit e tjerë politikë shqiptarë, që i burgosi vjet UDB-eja), nuk janë kapur materiale armiqësore të dënueshme me ligjet ndërkombëtare, të cilat i ka nënshkrua edhe vetë Jugosllavia në Helsinki, para disa vjetësh. Të burgosurit në fjalë janë privuar lirie vetëm për deklarata verbale ose shkresa unike apo të shumëzuara me dorë e makinë shkrimi- dhe kjo gjë është në kundërshtim me ligjet ndërkombëtare.[56]

---

[44] Lajmëtari i Lirisë, Viti I. nr. 2. Tetor-Nëntor 1980, f, 2.
[45] Shefqet Qerim Jashari, përkthyes, (1944), Strofc, 25.05.1980, neni 136/1 LPJ. (8 vjet burg)
[46] Ramadan Islam Pllana, student, (1947), Shtitaricë, 25.05.1980, neni 136/ 1 LPJ. (7 vjet burg)
[47] Avdi Daut Kelmendi, (1951), Ribar, 25.05.1980, neni 133/ 1 LPJ. (5 vjet burg)
[48] Abdyl Elez Lahu, referent, (1944), Gllamnik, 25.05.1980, neni 133/ 1 LPJ. (4 vjet burg)
[49] Isa Musa Demaj, profesor, (1946), Shkrel, 25.05.1980, neni 133/ 1 LPJ. (4 vjet burg)
[50] Sylejman R. Qyqalla, punëtor, (1954), Bellaqevc, 25.05.1980, neni 133/ 1 LPJ. (4 vjet burg)
[51] Skender M. Jashari, punëtor, (1954), Prishtinë, 25.05.1980, neni 133/ 1 LPJ. (3 vjet burg)
[52] Hysen B. Gërvalla, bujk, (1941), Dubovik, 25.05.1980, neni 133/ 1 LPJ. (3 vjet burg)
[53] Gani Sylaj, profesor, (1952), Kizhnarekë, 21.12. 1979, dënohet në Shkup me 6 vjet burg të rëndë. Më 1981, pasi se ishte zbuluar organizata OMLK-së, në të cilën kishte qenë i angazhuar, ai përsëri nxirret para gjyqit në Gjykatën e Qarkut në Prishtinë dhe i shqiptojnë dënimin prej 15 vitesh burg të rëndë.
[54] Muharrem Shaljani, nga Likova e Kumanovës, po ashtu me 21 dhjetor Gjykata e Qarkut në Shkup e dënon me 5 vite burg të rëndë.
[55] Haxhi Maliqi, po ashtu nga fshati Likovë e Kumanovës, po ashtu kjo gjykatë e dënon me 3 vite burg të rëndë.
[56] Punim i cituar, Jo ngushëllim,…, Lajmëtari i Lirisë, viti I, nr, 2. Tetor-Nëntor 1980, f, 2 .

Historikisht dihej se Jugosllavia gjatë gjithë pushtetit dhe shtetit sa ekzistoi burgjet e saja ishin të mbushura me shqiptarë. Andaj, jo rastësisht e dënuan Adem Demaqin, simbolin e rezistencës shqiptare.

Në shkrimin e Lul Ndreut, supozojmë se është Jusuf Gërvalla, jepen të dhëna të bollshme për arrestimin dhe dënimin e Adem Demaçit. Në tekst thuhej se Gjyqi jugosllav e ka dënuar tri herë me burg të rëndë, luftëtarin më të paepur kosovar për idealin kombëtar dhe njerëzor në Kosovën e pasluftës (pas vitit 1945, shënim i S.K-B): më 1958, me pesë vjet burg, nga të cilat i ka mbajtur 3; më 1964 me 15 vjet burg, nga të cilat i ka mbajtur 10 vjet; dhe më 1975 po me 15 vjet burg të rëndë, nga të cilat i kanë ngelur edhe 10 vjet... Të tri herët është dënuar për "vepër armiqësore kundër popullit dhe shtetit". Në gjykimin e fundit, në shtator 1975, patrioti i ynë pat deklaruar haptas, pa hezitim dhe me domethënie të thellë: "Megjithëqë... plotësisht i pafajshëm, unë gjithmonë kam qenë dhe kurdoherë kam për të qenë- deri në vdekje-për idealin kombëtar e njerëzor; dënimi që po më bëhet mua është dënim për bindje dhe mendime, e jo për vepër, dhe kjo gjë është, me sa di unë kundër ligjit dhe në kundërshtim me të gjitha normat ligjore ndërkombëtare e njerëzore[57], autori mbyll të dhënat për Adem Demaçin.

[57] Po aty.


Me penë dhe pushkë...

lajmëtari i lirisë

...për liri dhe bashkim me vendin amë, Shqipërinë socialiste!

Në kundërshtim të hapët me parimin e kombësisë dhe të vullnetit të popullsive vendase, nga trungu i Shqipërisë u shkëputën krahina të tëra si Rrafshi i Dukagjinit, Kosova dhe tokat shqiptare në Maqedoni. Më tepër se gjysma e popullsisë së vendit dënohej të ndëroste zgjedhën e vjetër turke me një zgjedhë të re, atë të Serbisë dhe të Malit të Zi. ARBËN PUTO

VITI I NUMËR 2 TETOR — NËNTOR 1980

Gëzuar festat e Nëntorit

2. 2. Festimi i ditës së flamurit

Në numrin e dytë të gazetës, redaksia nëpër mes faqeve të saj, të gjithë shqiptarëve i'u uron festën e flamurit, duke e dhënë edhe një historikë të saj. Pas 62 - vjetësh, përsëri populli shqiptarë këtë festë e festojnë në dy mënyra të ndryshme. Në Shqipëri (në shtetin politik), festa shënohet në mënyrë transparente, dhe duke evidencuar rezultatet e arritura të vendit, ndërsa, Kosova dhe vendet tjera shqiptare nën ish-Jugosllavi, shënojmë lavdin e të parëve tanë, që tokën mëmë e ulëm me gjakun e tyre të shtrenjtë po të pakursyer, dhe mjerimin e sotëm kush nën robërinë e egër të pushtuesve sllavë e grekë dhe kush në udhën e

madhe të kurbetit në dhera të huaja[58], thuhej në shkrimin "Gëzuar Nëntori", në faqen 3 të saj.

Viti 1980, siç dihej ishte viti i fundit kur bëheshin përgatitjet e mëdha për pranverën shqiptare të '81-shit. Në këtë shkrim edhe bëhet përshkrimi i situatës politike që mbretëronte në këtë kohë. Kështu shkruan gazeta: Ne shqiptarët e Kosovës dhe të viseve tona të tjera brenda Jugosllavisë, këtë nëntor po e shënojmë në një skamje e mjerim të madh, ku jemi katandisur në saje të një politike kolonialiste të pushtuesve jugosllavë, me lot ndër sy qajmë vuajtjet e motrave dhe të vëllezërve tanë, që lëngojnë në burgjet e armikut gjakësor, por dhembja jonë është dhembje krenare, sepse ata nuk e kursyen rinin e tyre, por u hodhën në luftë të guximshme për realizimin e aspiratave tona shekullore për bashkimin e tokave shqiptare dhe për shembjen e rendit antipopullor e anti shqiptar në Jugosllavi[59] përfundon autori, duke shpresuar se në të ardhmen dhe festat tjera kombëtare do i festojmë s'bashku me shtetin amë-Shqipërinë.

2. 3. Fytyrë e kthyer nga Shqipëria

Si në çdo gazet ilegale po ashtu edhe në "Lajmëtarin e lirisë", vend i dukshëm i kushtohet Shqipërisë dhe të arriturave të saja. Duhet përmendur se në faqen e tretë të gazetës është shkrimi "Me sy e zemër nga nëna Shqipëri". Autori shkruan për Shqipërinë dhe për rrugën e mundimshme të saj. Zhvillimet si në fushën e kulturës, arsimit, shëndetësisë e shumë lëmi të tjera e bëjnë autorin e shkrimit që të fascinohej me të arriturat e shtetit amë. Autori duke mos e ditur realitetin e shtetit lavdëron të mirat e komunizmit që lulëzon në çdo cep të Shqipërisë. Në shkrim jepen tradhtitë e shumta që i bëhen popullit shqiptar duke filluar që nga koha e Skënderbeut të madh, të tradhtive të më vonshme që i bëjnë konferencat ndërkombëtare e deri te viti 1945, që i bënë Jugosllavia, Rusia e Kina, por shton se megjithatë, populli shqiptarë ia doli mban pa u përkulur e nënshtruar asnjë dashakeqi. Sido që të jetë, Shqipëria është Shqipëri, nëna dhe babai i ynë, i të gjithë shqiptarëve kudo që ndodhën.

---

[58] Gëzuar Nëntori, Lajmëtari i Lirisë, Viti I, nr. 2. Tetor-Nëntor 1980, f, 3.
[59] Gëzuar Nëntori, Lajmëtari i Lirisë, Viti I, nr. 2. Tetor-Nëntor 1980, f, 3.

Për një moment, autori i shkrimit ndalet dhe prezanton të dhënat për shqiptarët që janë okupuar nga Jugosllavia, ai thotë se:" Deri sa ne na kanë zhdukur pasivisht si "ballistë" dhe deri sa kemi duruar urie; deri sa ne kemi shikuar me sedër të vrarë kombëtare si zbret dhe si na ndalohet flamuri shqiptar me të cilin i kishim çliruar tokat tona; deri sa nga vatrat tona të dashura na kanë dëbuar me tortura e shantazhe; me një fjalë, gjithë kohën që ne kemi shijuar mjetet më të egra të gjenocidit nga ana e social-shovinistëve titistë, i vetmi satisfakcion për ne ka qenë forcimi dhe zhvillimi i mbarë Shqipërisë mëmë dhe denoncimi nga ana e saj i të zezave të zbrazura me rrebesh mbi kokën tonë. Dhe në vend të ndjenjës së braktisjes nga Shqipëria mëmë, qenien tonë e mbushi ndjenja e fuqishme se nuk jemi vetëm dhe ka kush na del zot, ka kush davarit mjegullën, me të cilën titistët menduan ta mbështillnin historinë tonë të vërtetë dhe planet e tyre shtetërore për shfarosjen e shqiptarëve.[60] Dhe vërtet, ishte për të gjithë shqiptarët një satisfakcion i mirë se ne kishim shtetin amë e cila angazhohej dhe luftonte atje ku mundte dhe duke e pasur parasysh ndikimin e saj në botë, çdo herë dhe në çdo kohë bëri atë që mundi duke mos kursyer asgjë nga vetja.

2. 4. Shkrime me karakter optimist

Në faqen 4 e 5 të gazetës janë edhe ca shkrime që në vete ngërthejnë tone optimiste si shkrimi "Kohët ndërrojnë fatlumnisht". Autori shton në shkrim se vetëm i padituri dhe kopuku[61], thënë me një fjalë mendojnë se koha nuk ndryshon, ndërsa e vërteta është krejt tjetër, ngase askush dhe nga asnjë njeri nuk mund të ndalet dielli kur të vijë mëngjesi për të aguar, po aq më tepër është për të ardhur keq, se si disa miop mendojnë se lirinë që e kanë uzurpuar nuk do të mund kurrë t'iu kthehej atyre që e meritojnë atë. Autori më 1980 mendonte e shkruante se një ditë do të vijë liria, dhe vërtet trimat e trimëreshat shqiptare e sollën atë, edhe me sakrifica por ata kishin bërë benë dhe se ishin të vetëdijshëm se liria fitohet me gjak e jo me llafe te kota.

Edhe shkrimi "Njeriu në qendër gjithçkaje" i kushtohet avancimeve të shumta në Shqipëri duke pasur protagonistin kryesor shkrimtarin dhe publicistin e madh francezë, prof. Rober Eskarpin, i cili

[60] Me sy e zemër nga nëna Shqipëri, Lajmëtari i Lirisë, Viti I, nr. 2. Tetor-Nëntor 1980, f, 3.
[61] Kohët ndërrojnë fatlumnisht, Lajmëtari i Lirisë, Viti I, nr. 2. Tetor-Nëntor 1980, f, 4.

më 1980, kishte qëndrua disa ditë për vizitë në Shqipëri. Shkrimtari Robert kishte ngelur i mahnitur me të arriturat e shteti shqiptar dhe ajo që i kishte pëlqyer më së tepërmi ishin fjalët e një malësori, i cili i kishte thënë se shteti shqiptar në qendër të çdo gjëje e ka njeriun. Dhe shton profesori se :"Kur ky fshatar shqiptar thoshte se njeriu është në qendër të gjithçkaje, ai e vinte atë fizikisht, me të gjithë pushtetin, dëshirat, trupin e tij, botën e tij të brendshme, që t'i lejonte atij të hapte aty një vend për kohën e jetës së tij, dhe jo për ti siguruar atij me disa fjalime metaforike përjetësinë e kotë të një shpirti të patjetërsueshëm...[62] Ky shkrim është i huazuar nga gazeta e përditshme shqiptare "Zëri i Popullit".

Në këtë faqe është edhe një poezi nga një poet turk, Tahsin Saraç: "Shqiponjë me zemër të bardhë". Poezia është e shkruar me 2 qershor 1980, në qytetin e Shkodrës. Poeti turk i frymëzuar nga ajo që kishte parë e shijuar, frymëzohej dhe shkruan këtë poezi. Duke shpreh dashurin e madhe për shtetin shqiptarë, në vargje shkruan: Dashurova/ njerëzit të thellë si ujërat e nëndheshme/të ndjeshëm/ të thjeshtë/ krenar/ zemërimi i tyre është si bubullimë e qiellit/ ndërsa dashuria e tyre si turfullimë e një fluture/...Dashurova/vështrimin tënd/në zemërim dy grykë të një pushke/në buzëqeshje një tufë lule"[63], shprehet autori.

Në faqen e pestë shkruhet për librin e Enver Hoxhës "Eurokomunizmi është antikomunizëm", që u botua më 1980, në Tiranë. Po ashtu në faqen e 8-të ndodhej shkrimi i marr nga V.I. Lenini "Situata Revolucionare". Ndërsa "Kronika e lajmëtarit", ndodhet në faqen e gjashtë të gazetës ku në mënyrë të dendur jepen ngjarjet që ndodhin në botë, por që prezantohen në mënyrë informative.

Shkrimi "Dokumenti i gatishmërisë", shkruan për situatën tejet tensionuese që mbretëron në këta muaj në Kosovë. Aty thuhej se pas një ndeshjeje futbolli, gati-gati erdhi edhe te shpërthimi i demonstratave të përgjithshme popullore. Populli shqiptarë asnjëherë nuk do të harrojë vitin 1968 dhe demonstrata studentore, po vallë? pyet autori i shkrimit se vendi dhe preteksti i tyre mund të jetë i pakuptimtë në dukje të parë: reagim për një padrejtësi sportive në fushën e futbollit. Por, duhet të jesh fare jashtë realitetit shoqëror kosovar, nëse çështjen e kufizon në këtë

[62] Njeriu në qendër gjithçkaje, Lajmëtari i Lirisë, Viti, I. nr. 2, Tetor-Nëntor 1980, f, 4.
[63] Tahsin Saraç, Shqiponjë me zemër të bardhë, Lajmëtari i Lirisë, Viti I, nr. 2, Tetor- Nëntor 1980, f, 4.

mënyrë. Edhe fizikisht, demonstratat kaluan jashtë fushës së sportit, u përhapën në rrugët e Prishtinë dhe zgjatën deri natën vonë. Vallë, një padrejtësi e thjeshtë sportive mund t'i shtynte qytetarët tanë që "tërbimin" e tyre ta derdhnin mbi çdo automjet, të madh a të vogël, që nuk kishte targë të Krahinës sonë?! A s'i përkujtojnë autobusët dhe veturat e përmbysura, demonstratat e 1968-ës?!.[64] Me këtë rast kërkon autori i shkrimit që ilegalja shqiptare që e ka marr përsipër që ti shtyjë proceset përpara dhe duhet të bëjë kujdes, dhe të ketë çdo gjë nën kontroll se s'ka revolucion pa popullin dhe s'ka popull jo revolucionar. Gjithçka varet nga kushtet objektive, në të cilat do të shpërthejë ose jo revolucioni[65]. Ndërsa sa i përket situatës në Kosovë ajo është e stër-ngarkuar me elektricizëm të fuqishëm revolucionar. Duke përfunduar shkrimin autori anonim thotë se "Për revolucionarin e vërtet është e qartë se shkarkimi i këtij elektrizimi do të bëhej më me vend e më me efekt po të kishte udhëheqës të denjë revolucionar, që do të viheshin në ballë të masave të revoltuara për t'u prirë atyre kah fronti i shenjët i çlirimit të tokave stërgjyshore dhe i bashkimit me Atdheun tonë të lirë, Shqipërinë Socialiste[66]" përmbyllet teksti.

Petraq Risto, në këtë numër prezantohet me një cikël poezish "Vargje për Revolucionin" të përbërë nga tri poezi: Vargje për revolucionin, Superfuqitë; dhe Kronik polake. Në formë vargjesh poeti polak paraqet realitetin në vendin e tij duke thënë se: Varshava/ Gdansku/Balltiku/marrin ngjyrën e gjakut/Punëtorët e revoltuar/ shtrëngojnë radhët/Jerosheviqi çmendet, bërtet:/Sus, heshtni, sus/ Po çmimet ngrihen me shpejtësi/dhe punëtori ndjen dhembje/ ngre zërin pa frikë/Tërbohet Sejmi polak...[67]" duke shtuar se gjithçka në botë mund eksportosh por për revolucionin është një pikëpyetje e madhe.

2. 5. Vendi meritor i Eqrem Çabejit të madh

Në një faqe e gjysmë tekst, gazeta i kushton vend meritor figurës poliedrike të profesorit të nderuar Eqrem Çabejit të madh. Autori "Drini", shkruan gjerë e gjatë për jetën dhe veprën shkencore të vet

[64] Dokumenti i gatishmërisë, Lajmëtari i Lirisë, Viti I, nr. 2. Tetor-Nëntor 1980, f, 6.
[65] Po aty.
[66] Po aty.
[67] Petraq Risto, Vargje për Revolucionin, Lajmëtari i Lirisë, Viti, I. nr. 2, Tetor-Nëntor 1980, f, 6.

profesorit. Në mes tjerash ai thotë se " Vdekja e këtij biri të shtrenjtë të kombit tonë u prit me pikëllim të madh edhe në Kosovë, si në të gjitha trevat shqiptare. Shumë punonjës të shkencës e të arsimit, studentë e të tjerë, e kanë pasur fatin e bardhë t'ia lexojnë t'ia studiojnë veprën, po edhe të njihen personalisht me profesorin e nderuar, i cili vinte në mesin tonë që të përgatiste studentët për punë shkencore në fushën e studimeve albanologjike.[68] Autori vazhdon të shkruaj për dhembjen dhe humbjen e madhe që përjetoi bota akademike dhe të gjithë shqiptarët kudo që ndodheshin.

Të dhënat biografike për profesorin fillojnë me lindjen e profesorit në Gjirokastër, në gusht të vitit 1908. Mësimet e para i mori në vendlindje, kurse shkollimin e mesëm dhe studimet e larta i vazhdoi në Austri. Në Gracë e në Vjenë i dëgjoi ligjëratat e Paul Kreçmerit dhe të Norber Joklit, dy nga gjuhëtarët më të shquar të asaj kohe. Pas kësaj i pajisur me dije kthehej në vendlindje dhe filloi me zell të madh punën shkencore për një gjysmë shekulli rresht[69]. Në vijim të shkrimit autori jep të dhëna të bollshme për veprimtarin shkencore dhe për librat e shkrimet që patën jehonë në vend dhe jashtë tij. Shkruan për kontributin e pa krahasueshëm që e dha në ngritjen dhe shkollimin e kuadrove arsimore të Shqipërisë. Për punën e madhe që bëni në fushën e gjuhësisë, me hapjen e Akademisë së Shkencave, profesor Qabeji zgjidhet anëtar i rregullt i saj. Ndërkaq, instituti më i lartë shkencor i vendit e zgjodhi anëtar të Presidiumit. Për rezultatet e jashtëzakonshme në fushën e shkencave albanologjike dhe për kontributin e çmueshëm në fushën e arsimit kombëtar para e pas çlirimit, Presidiumi i Kuvendit Popullor i RPS të Shqipërisë i dha prof. Qabejit titullin e lartë Mësues i Popullit.

Autori "Drini", vazhdon më tej duke shtuar se rezultatet shkencore nga rrafshet e gjuhësisë, profesor Qabeji i kumtoi, përveç se në Universitetin Shtetëror të Tiranës, në atë të Prishtinës a në ndonjë universitet tjetër të Evropës-edhe në shumë kongrese të shkallës ndërkombëtare . Punimet e tij janë botuar në një varg publikimesh shkencore të vendit dhe të botës së jashtme dhe ato janë përkthyer e

[68] Vdiq vigani i dijes shqiptare, Lajmëtari i Lirisë, Viti I, nr. 2. Tetor-Nëntor 1980, f, 7.
[69] Po aty.

janë aprovuar nga gjuhëtarët më eminent të mjediseve të ndryshme të Evropës"[70] Dhe si gjithkund në tokat shqiptare, vdekja e profesor Eqrem Qabejit u prit me dhembje, për të cilën në vazhdim autori "Drini", konstaton se vdekja e profesor Qabejit na la pa njërin nga kokat më të ndritura dhe figurat më të mëdha të shkencës sonë kombëtare. Dhe ne mbesim të pikëlluar për mungesën e tij. Por, për jetë do të përulemi me nderime e dashuri para trashëgimisë kolosale kulturore që na la ky vigan i dijes dhe para kujtimit të personalitetit të tij të ndritur[71] përmbyll shkrimin autori.

2. 6. Krahasimet mitologjike me realitetin

Në shkrimin "Mashtrimi i madh i ramzesianëve të vegjël", autori L.Ndreu, shkruan për mashtrimet e shumta që iu bëhen popullit shqiptar si nga pushtetarët e shtetit sllav po ashtu edhe nga pushtetarët shqiptar të asaj kohe. Të gjitha këto farsa politike të shtetit të quajtur Jugosllavi, krahasohen me politikën e vitit 1296 para e.s. kur kremtoi faraoni egjiptian Ramzesi i II fitoren mbi hititë, i urdhëroi që beteja, e cila gjëja se i paskësh sjell nam atij të përjetësohej me epe dhe monumente madhështore. Dhe autori i këtij shkrimi shkruan se po mbaj vesh pak më me kujdes, në Beograd, Kralevë, Titograd, Shkup... do të dëgjosh fragmente gjëmash për Kosovën, e cila po i përballon serbizimit dhe po kërcënohet me shkëputje dhe bashkim me vendin e vet amë, Shqipërinë[72]. Në vijim autori përmend Desanka Maksimoviqin një marionetë e konsumuar e cila me dhembje çirret duke pyetur se pse nënat serbe nuk lindin më 9 jugoviq që ata ta serbizonin Kosovën. Por, mendojë se për popullin shqiptar nuk është e panjohur kjo klithje ngase edhe më herët kishin trumbetuar e kélthitur edhe shumë shkencëtar të sojit alla çubrilloviqiane si Jovan Cvijiqi, Ivo Andriqi, J.Duqiqi, I. Laliqi, D. Çosiqi e shumë e shumë të tjerë, që u angazhuan me mish e me shpirt për të bërë serbizimin e Kosovës e të shqiptarëve në përgjithësi. Të gjithë ata u angazhuan që të gjejnë mënyra , metoda dhe mjete për të bërë ç'kombëtarizimin e shqiptarëve dhe në mënyrë

[70] Po aty, f. 8.
[71] Po aty.
[72] Mashtrimi i madh i ramzesëve të vegjël, Lajmëtari i Lirisë, Viti I, nr. 2. Tetor-Nëntor 1980, f, 9

permanente përdorën metoda gjenocidale për mbi ta, vetëm e vetëm që ti detyronin ata që të shkonin sa më larg nga trojet e tyre stërgjyshore.

Në vitet e tetëdhjeta, të shekullit 20, propaganda jugosllave e sidomos ajo serbe ishte shumë më e organizuar dhe në formë të orkestruar punohej në të, që situata politike, ekonomike e arsimore në Kosovë të paraqitej sa më stabile dhe më e qetë. Detyroheshin politikanët shqiptar që të dilnin në popull dhe të flisnin se në Kosovë populli është i kënaqur, dhe se çdo gjë ecën sipas rrjedhës së dëshiruar. Autori i shkrimit thotë se në një fjalim M. Bakalli numrin e të burgosurve politik shqiptar prej 2.000 vetave e prezanton në vetëm 50 veta, kurse anëtarët e lëvizjes ilegale patriotike shqiptare të gjithë i quan informbyroist[73] e çka jo tjetër. Politika jugosllave gjatë kësaj periudhe ishte e tillë se për çdo gjë e sidomos informimi shkonin aq larg sa çdo gjë shqiptare dezinformohej. Dhe, nuk ishte aspak çudi, kur nga numri i 2000 i të burgosurve shkohej në 50 veta, e tërë kjo kishte edhe prapavijën e saj. Nga qarqet politike jugosllave nuk ishte i rastësishëm edhe urdhri siç e quan autori: urdhri i parë: Burgos! I dyti: Shkruaj! I treti: Shlyej dhe prapë shkruaj. Mbi të gjitha - krasit, më të majtë e më të djathtë. Autori pyet vet dhe përsëri përgjigjej vet, se nuk e dijë a e kanë të qartë zotërinjtë udbashë se me krasitje vetëm sa shpejtohej rrita, madje rrita e mbar. Me një mënyrë kështu ndodhë edhe me ne shqiptarët, sa më shumë krasitkemi e futemi nëpër burgje, ne jemi edhe më të fuqishëm dhe sa vije numri i aktivistëve e veprimtarëve shtohej në organizatat atdhetare.

2. 7. Politika dezinformuese e Beogradit

Po ashtu edhe në shkrimin "PASHIQI-HOTI (paralele), jepen paralele në mes Nikolla Pashiqit dhe Beqir Hotit. Më 1979, në Kosovë policia jugosllave kishte arrestuar e burgosur shumë të rinj shqiptarë. Mirëpo, atdhetaret shqiptar nuk po rrinin duarkryq. Në vendet ku arrestoheshin të rinjtë tanë fshati ose qyteti të nesërmen zbardhej me trakte. Në këtë mënyrë atdhetarët i tregonin pushtetarëve jugosllav se ata janë të distancuar nga ata dhe një ditë kur do të vij koha ata nuk do të harrojnë për torturat që bëheshin nga ana e tyre. Udbashët, në mënyrë

[73] Po aty.

permanente punonin që në Kosovë të ruanin gjendjen ekzistuese, fundja thoshte një udbash, po qe nevoja do të ecim mbi kufoma të shqiptarëve dhe ndërrim të situatës nuk do të ketë. Më 1980, pushtetarët kishin hetuar se diçka po lëvizte, diçka po përgatitej, andaj dhe morën masat e "duhura", duke shtuar rojet gjithandej ku jetonin shqiptarët. Rojet u vunë në universitet, në shkolla, në fabrike, në institucione shtetërore e shoqërore e ku jo tjetër. Agjentët e UDB-es, sidomos kontrollonin dhe vëzhgonin familjarët e të burgosurve politik, duke u munduar që në këtë mënyrë bënin edhe izolimin total të familjeve të tyre nga rrethi dhe të tjerët. Edhe pse pushtetarët e udbashët kishin marr të gjitha këto masa, rinia shqiptare ishte e gatshme për sakrifica. Dhe ç'ndodhte me ta, mu aty ky ishte shtua përgjimi e përcjellja e agjentëve, mu aty rinia liridashëse mori shumë aksione duke shpërndarë, trakte dhe duke thirrur popullin se gjendja e robëruar nuk durohej më, duke shkruar parulla në vende frekuentuese. Bie fjala, cek autori i shkrimit, në fshatrat në afërsi të Dubovikut dhe në Dubovik (katund në afërsi të Pejës), ku ishte burgosur patrioti Hysen Gërvalla), traktet e afishet shpërndaheshin pa e pritur njëra tjetrën mu para hundëve të njerëzve të pushtetit[74].

Duke i parë të gjitha këto që kishte ndërmarr rinia përparimtare, udbashët kishin "gjet", një formë të "re" të ndëshkimit. Filluan një aksion të paparë për të arrestuar sa më shumë të rinj. Fillimisht i merrnin natën e ditën, i burgosnin duke iu montuar lloj-lloj gjërash që ata nuk kishin lidhje me to. Pastaj i arrestonin dhe me ditë të tëra i mbanin në hetuesi. Dhe siç dihej, gjatë hetuesisë përdornin torturat më shtazarake ndaj tyre. Bile, disa nga ata të arrestuar nuk dilnin fare nga ato dyer të hekurta, e të tjerëve iu kurdisnin procese të montuara politike dhe i dënonin me vite marramendëse burgu. Veç këtyre që i përmenda më lart, pushteti dhe UDB-ja jugosllave kishte edhe një "dhunti" të jashtëzakonshme të cilën e përdorte më shpesh se çdo gjë. Rrena ishte modeli dhe forma më e preferuar që e përdornin pa pikën e turpit. Kur u binden se nuk mund ta ndalin një rini të tërë për mos të bërë vepra atdhetare, ata shkuan aq larg sa filluan ta mohonin veprën e tyre, duke thënë se disa fëmijë të pakujdesshëm po shpërndajnë trakte e afishe ose

[74] PASHIQI-HOTI (paralele), Lajmëtari i Lirisë, Viti I, nr. 2. Tetor-Nëntor 1980. f, 11

tjetra duke lançuar të pavërtetën tjetër duke thënë se populli shqiptarë është i kënaqur në Jugosllavi, por se serbet e malazezët, me qëllim po shpërndajnë trakte vetëm e vetëm që ti rëndojnë komshit e tyre shqiptar. Dhe vërtet duhet besuar në këto fjalë boshe e pa mbulesë.

Popullata e pakënaqur me gjendjen që mbretëronte, në ditën e dytë të vdekjes së Titos, në fshatin Raushi kishte ndodhur edhe kjo: Në Raushiq u grisën fotografit e Titos dhe flamuri i urryer i okupatorit. Edhe pse policia u turr që ti gjente aktorët, por më kot, ata nuk ishin pak, ishte i tërë populli që i griste ato dhe i tërë populli i mbronte veprimtarët. Pushtetarët, do të vendosin që ta mbulojnë dhe ta fshehin të vërtetën nga populli. Atyre nuk iu mungonin shërbëtoret që t'iu vinin në ndihmë. Dhe në këtë mënyrë autori i shkrimit shkruan se si e angazhojnë B. H. Në bashkësitë lokale dhe në aktivet e LK, të shpallte në popull se si aksionin në fjalë e kishin kryer serbët[75]. Populli shqiptar ishte krenar për punën e të rinjve që bënin, në shikim të parë të urtë por çdo shqiptar në ndërdijen e tij e dinte të vërtetën, se baballarët e tyre iu kishin lënë amanet, se edhe dhurata që vije nga serbet ka një rrezik në vete. Për shqiptarët e urtë një histori e tillë nuk ishte e panjohur, se edhe Jugosllavia e vjetër kurdiste situata të ndërlikuara. Ndërsente bandat çetnike të digjnin lagje qytetesh dhe fshatra shqiptare, e në anën tjetër shpallte se ato djegie i kanë bërë shqiptarët. Pastaj organet e pushtetit gjoja ndërhynin në gjithë këtë marifet, dhe intervenimi i tyre kishte një rezultat: torturimin e shqiptarëve në mënyrën më të egër. Ashtu sot qeveria e Titos në Beograd e sheh të domosdoshme (njëherë për njëherë) jo të flasë për aksione të shqiptarëve, se në atë mënyrë do të popullarizoheshin në popull aksionet dhe lufta e rinisë përparimtare dhe e keqja do të merrte përmasa më të mëdha , po përkundrazi, ta fsheh çdo punë në drejtimin patriotik të shqiptarëve[76], konkludon autori i shkrimit.

2. 8. Gjendja e rëndë ekonomike, në faqet e gazetës

Shkrimi "Gjendja e rëndë në ekonomin e Kosovës" është një shkrim që është huazuar nga shtypi revolucionar kosovar, nga gazeta

[75] Po aty.
[76] Po aty.

ilegale që botohej në Kosovë "Liria". Gazeta "Liria"[77], shkrimet i botonte pa emra dhe pa pseudonime, andaj edhe ky shkrim që po e prezantojmë është pa emër, por në librin e parë të "Shtypit ilegal në Kosovë..." autori është i zbuluar dhe se shkrimin e kishte shkruar Berat Luzha. Duke u bërë analiza e situatës, me një fjalë autori vjen në përfundim se shkaktar i gjendjes së mjerueshme ekonomike në Kosovë është robëria e Kosovës nga Jugosllavia. Shteti okupues me qëllime të caktuara nuk investon në Kosovë, në ekonomin që do kishte domethënie për shqiptarët. Në mënyrën më të vrazhdë pasurit kosovare shfrytëzohen dhe bartën jashtë kufijve të Kosovës, duke e shkretuar dhe duke e sjellë në buzë gremine popullin shqiptar. Kosova gjendet si një zonë tregu për shitjen e mallrave të gatshme industriale nga republikat e Jugosllavisë. Rreth 70% të tregtisë të Kosovës e mbajnë mbi 200 firma tregtare të jugosllave më me shumë se 600 njësi tregtare, 200 prej të cilave vetëm në Prishtinë. Ndërmarrjet e republikave jugosllave nuk kanë kurrfarë pengese për shitjen e mallrave të tyre në Kosovë, ndërsa mallrat e pakta kosovare vështirë gjejnë vend në tregjet jugosllave, bile edhe në tregun kosovar, jo vetëm për shkak të konkurrencës së egër, por edhe nga pengesat administrative. Në këtë mënyrë shumë ndërmarrje kosovare punojnë me kapacitet të përgjysmuar ose i kanë mbushur depot me mallra stoqe, duke i shtuar edhe me humbje.[78] Por shton autori i shkrimit se më 1980, nuk ndodhnin pengesa administrative kur ishte në pyetje lënda e parë minerare që nxirreshin nga "Trepça", "Kosova", Novobërda, Kishnica, Hajvalia, Goleshi, Deva, Volljaka, Karaçeva, Strezovci, Babushi e në vende të ndryshme anë e këndë Kosovës.

Padrejtësitë nuk ndodhnin vetëm në tregtinë e brendshme, por të gjitha këto kishin kaluar dhe ishin bërë dukuri në sistemin jugosllav. Deri sa në Jugosllavi vitin e kaluar (1979, shënimi S.K-B), iu dhanë ndërmarrjeve 1.188 pëlqime për tregti të jashtme, në Kosovë u dhanë vetëm 5 sosh. Tregtia e jashtme e Kosovës, e cila bëhet në të shumtën me ndërmjetësimin e ndërmarrjeve jashtë Kosove, vitin e kaluar kishte

[77] Gazeta "Liria" ishte organ informative i organizatës së OMLK-së, e cila vepronte në Kosovë por kishte degën e vet edhe në diasporë. Si organ filloi të botohej në vitin 1981-1982, dhe u botuan gjithsej në gjashtë numra. Të gjitha shkrimet që botoheshin në të shkruheshin pa emra të autorëve dhe pa pseudonime. Kryeredaktor i saj ka qenë atdhetari i njohur Mehmet Hajrizi.

[78] Gjendja e rendë në ekonominë e Kosovës, Lajmëtari i Lirisë, Viti I, nr. 2. Tetor-Nëntor, 1980, f, 12.

një deficit prej 3 miliardë dinarësh, ose dy fish më shumë se një viti më parë. Importi , që u rrit për 67 %, ishte dy fish më i madh se eksporti , ndërsa vetëm gjatë gjashtëmujorit të par të këtij viti (1980, shënimi S.K-B), , përkundër masave të kufizimit, u rrit për 34%. Vlera e eksportit mbulonte vetëm 50% të vlerës së importit.[79]

Duke u nisur nga të dhënat statistikore, dhe nga vet shkrimet që i publikonte gazeta e përditshme "Rilindja", autori konstatonte se papunësia ishte njëri ndër faktorët kyç që e prekte rëndë dhe ndikonte në mënyrë negative popullatën shqiptare. Papunësia e madhe ndikonte që njerëzit e aftë për punë të merrnin në sy rrugën e kurbetit, që me vite e vite ishte një plagë e hapur e shqiptarëve. Autori thotë se të aftë për punë Kosova kishte mbi 52% të popullatës (rreth 800 mijë veta), por të zërë në punë në të ashtuquajtura në sektorin shoqëror ka vetëm rreth 168 mijë veta. Më tepër se 700 mijë vetë kërkojnë punë nëpër entet e punës, po numri i të papunëve është shumë më i madh, sepse shumica e tyre as që paraqiten fare në këto farë entesh. Shkalla e zënies në punë e popullsisë së Kosovës është më shumë se katër herë më e ultë se sa ajo në Slloveni[80].

Edhe pse trumbetohej se në Jugosllavi respektohej struktura kombëtare, ajo ishte farsë e kulluar. Si çdo kund në vendet e punës dhe në pranimin e punëtorëve, diskriminimi kombëtar ishte shumë i hapur dhe as që mundoheshin pushtetarët që ta fshihnin. As struktura nacionale e punonjësve nuk ishte në proporcion të drejt me strukturën nacionale të popullsisë. Vetëm 62% të punonjësve ishin shqiptarë, kurse serbët dhe malazezët jo më pak se 32,4%. Kjo mospërputhje do të ishte shumë më e madhe po të analizohej struktura e atyre që punojnë nëpër zyra dhe vende udhëheqëse.[81] Populli shqiptarë është i vetëdijshëm dhe ka njohuri të bollshme pse po ndodhin këto, por edhe i mban shpresa se një ditë kupa do të mbushet e pastaj në një mënyrë apo tjetër do të zbrazet, por pasojat e saja do i ndjen mbi të gjitha pushtetarët e Beogradit. Më kot mundohej që të bëhej propagandë e organizuar se pse në Kosovë ekziston një gjendje e tillë kaotike, duke arsyetuar se pse ekziston një

[79] Po aty.
[80] Po aty.
[81] Po aty.

gjendje e tillë. Gënjeshtrave dhe kësaj propagande të pështirë në Kosovë nuk i besoi njeri. Populli i Kosovës po shihte gjithnjë e më qartë se shkaktari i vërtet i kësaj gjendjeje është kriza e thellë politike, ekonomike e shoqërore që po e brenë nga themelet regjimin e Titos dhe shtypja e shfrytëzimi i egër kolonial që po ushtrohej mbi ta. Ai po e kuptonte gjithashtu se e vetmja rrugë për të dal nga kjo gjendje është lufta e pa kompromis kundër regjimit jugosllav dhe tradhtarëve shqiptarë[82], e mbyll analizën autori i gazetës "Liria".

2. 9. Prezantim i denjë i gruas shqiptare në burgjet jugosllave

Gruaja shqiptare edhe një herë është temë trajtimi në faqet e gazetës "Lajmëtari i Lirisë". Kësaj radhe shikuar historikisht, gruan shqiptare e gjejmë të pandashme nga burrat në luftërat për liri dhe pavarësi. Gruan shqiptare në çdo kohë dhe në çdo periudhë e gjejmë aktive krahë për krah me burrat, por vitet dhe dekadat e fundit të shekullit njëzetë, ajo ishte aktive si në frontin e dijes ashtu edhe në frontin e rezistencës. Ishte aktive dhe merrte pjesë në të gjitha organizatat e grupet ilegale që vepronin në Kosovë por edhe jashtë saj. Mori pjesë aktive në demonstrata, por atë e gjejmë edhe pjesëtare të proceseve gjyqësore, por edhe të arrestuar. E gjejmë të torturuar e stoike por edhe të dënuar me vite të shumta burgu.

Për angazhimin dhe burgosjen e gruas shqiptare flet edhe shkrimi i huazuar nga gazeta "Bashkimi"[83], me titull "Ik, o natë, po këndon agimi". Autori i shkrimit trajton jetën e gruas (70 vetave), që ndodhen në burgun e Mitrovicës. Dhe habit fakti se në burgjet jugosllave, aty dhe vetëm aty respektohet barazia gjinore, bile një numër i konsideruar i tyre thyen rekordin ndër shtete ballkanike për përfaqësimin e tyre në radhët e të burgosurve.

Shqiptarja kosovare, thotë autori, e cila deri më dje ishte në terrin e plotë të padijes, kurse sot ka zënë të ecë fare natyrshëm në tribunat më të larta shkencore e kulturore, e kuptoi përfundimisht se duhet të dal kudo krah për krah me të vëllanë, me të shoqin dhe të birin, në të gjitha

---

[82] Po aty, f, 13.

[83] Gazeta "Bashkimi", ishte organ i organizatës ilegale atdhetare "Fronti i Kuqë" që botohej në diasporë. Këtë gazetë e nxirrte atdhetari i njohur Ibrahim Kelmendi. Ai njëherë ishte edhe kryeredaktor i saj. Ajo doli gjatë viteve 1979-1981, në pesë numra.

frontet dhe më qëndrimin e patundshëm: Një komb unik shqiptar- një shtet unik! Ky akt i burgosjes masive edhe të femrës shqiptare në Jugosllavi, tregon qartë se kanë rënë përfundimisht në ujë gjithë kombinacionet e fëlliqura jugosllave (që nga viti 1912 e këtej), të cilat shkollimin e femrës shqiptare e shihnin si një nga mjetet e rëndësishme për ç'kombtarizimin e shqiptarëve. E si të mos dështonin, pasi penat e mprehta, që pushteti i Jugosllavisë së vjetër dhe ky i Titos i kishin angazhuar të bënin hulumtime e projekte shkencore për asimilimin dhe shfarosjen e shqiptarëve, nuk kishin parashikuar dot që do të vinte dita që femra shqiptare e Kosovës, e mbrojtur nga një brumë fisnik, në vend që të përqafoi kuazi emancipimin jugosllav, shkollimin e vet e pa si një detyrë të shenjët, të cilën duhet vënë në shërbim të popullit dhe të çlirimit social e nacional,[84] na dëften autori.

Ajo që e shqetëson më së shumti pushtetin jugosllav, është jo vetëm angazhimi i burrave në jetën ilegale patriotike, por është edhe ndihmesa shumë e madhe që e japin gratë shqiptare në ilegale. Dëshmia më e mirë për shëndetin politik, social e nacional të shqiptares në Kosovë sot është inkuadrimi gjithnjë e më i madh dhe drejtpërdrejt në lëvizjen e gjerë për çlirimin social e nacional të shqiptarëve nga Jugosllavia dhe bashkimin e tyre me vendin amë-Shqipërinë. Dhe ky akt i saj bëhet më madhështor kur e dimë se gjithë përpjekjet nacional-shoviniste të pushtetit jugosllav ishin përqendruar në degjenerimin, përkatësisht në apolitizmin e rinisë kosovare. Veçanërisht qëndrimi ndaj femrës sonë ishte i tillë që asaj i ofronte mundësi të shfrenuara për shfrime instinktesh të ultë pa kurrfarë përgjegjësie shoqërore, mundësi që krijonin një bazë të fortë amoraliteti total, për degjenerimin, që do tu epte dorë projekteve shtetërore jugosllave për asimilimin e shqiptarëve.[85] Për të vazhduar më tej se gruaja shqiptare si dëshmitare e kohës, e kuptoi drejt pse ishim të ndarë me shtetin amë, pse burgoseshin e vriteshin vëllezërit, burri e djemtë e saj vetëm pse kërkonin liri e bashkim që ishim ndarë padrejtësisht. Ajo pa hezituar u fut në radhët e ilegales, duke iu ndihmuar në organizimet e tyre. Bile në shumë raste gratë ishin ato që kryenin shumë punë pa u vërejtur fare nga udbashët.

[84] Ik, o natë, po këndon agimi, Lajmëtari i Lirisë, Viti I, nr. 2, Tetor-Nëntor 1980, f, 13.
[85] Po aty.

Ato bartnin postën për ilegalet, bartnin ushqime, por bartnin edhe armatimin për të cilën ilegalistët kishin aq shumë nevojë.

Ndërsa burgjet për gratë shqiptare ishin histori në vete, por edhe aty u treguan të forta dhe i përballuan çdo torture. Me indinjatë të thellë[86] shkruante autori për torturat që i bëhen sot kosovares në burgjet jugosllave, po me zemër të gufuar për aktin e saj të ndritshëm historik të inkuadrimit direkt në çështjen e madhe të lirisë, i falënderohemi, nënës, motrës, gruas shqiptare që na e forcoi krahun e luftës dhe jemi të bindur se qysh sot mund t'ia themi të gjithë së bashku këngës: Ik, o natë, po këndon agimi...[87], dhe vërtetë vitet në vijim e dëshmuan se gruaja shqiptare ishte njëri ndër faktorët që e mundi armikun shumë shekullor.

2. 10. Nga shtypi i huaj

Në faqet e gazetës, veç shkrimeve që i shkruanin autorët shqiptar, por për hir të situatës së rëndë politike ishin të detyruar që të fshiheshin prapa emrave të imagjinuar ose prapa pseudonimeve që i merrnin vet, dhe që për to dinin një grup i vogël njerëzish, në gazetë ndodhte shpesh që kah fundi i saj mund të hasësh edhe në shkrimet që ishin të marra nga shtypi i huaj, në të cilat bëhej fjalë për situatën në Kosovë.

Në këtë faqe mund të gjesh shkrime nga gazetat e ndryshme botërore siç ishte shkrimi "Për një grusht dollarë", e huazuar nga Buletini Financiar i Londrës. Në mes tjerash në të shkruanin se funksionarët më të lartë të Jugosllavisë momentalisht gjenden në disa kryeqytete të Evropës perëndimore, e do të shkojnë edhe në Tokio, me shpresë se kanë për të mbledhur një ndihmë prej tre miliardësh dollarë. Qeveria jugosllave ka bërë një strategji paushallë për këtë fushat të lypjes së kredive. SHBA, Gjermania Perëndimore, Franca, Japonia, dhe Lindja e Mesme - për të gjitha këto vende veç e veç Beogradi ka përcaktuar shumën e kredisë që pret prej tyre[88] shkruan gazeta.

Ndërsa në shkrimin "Burgosjet masive në Kosovë", marr nga gazeta kroate "Hërvatski List" që botohej nga emigracioni kroat në Suedi, thuhej se: Gazetari gjerman Rullman informon në të përjavshmen e tij "Ost-Dienset" se në Kosovë janë bërë burgosje masive të

[86] Po aty, f, 14.
[87] Po aty.
[88] Për një grusht dollarë, Lajmëtari i Lirisë, Viti I, nr. 2, Tetor-Nëntor 1980, f, 15.

shqiptarëve në të gjitha qendrat e rëndësishme si Prishtinë, Mitrovicë, Vuçitërnë, Prizren, Gjakovë, Gjilan etj. [89] Për të informuar opinionin e gjerë gjerman se Pushteti jugosllav i mbajti sekret këto burgosje, por kur lajmi arriti në shtypin e huaj, "Politika" e Beogradit mori urdhër të shkruante se janë burgosur vetëm 50 shqiptarë, që do të dilnin para gjyqit. Por, ky numër nuk është pesëdhjetë, veçse dy mijë, dhe të burgosurit janë akuzuar për "kominformizëm" dhe irredentizëm (lëvizje çlirimtare). Duke shkruar për kominformizmin, "Politika", pretendonte ta zbusë jehonën e lajmeve sensacionale në perëndim, po e vërteta është se të burgosurit janë të akuzuar për lëvizje çlirimtare. Pjesa e tyre më e madhe janë intelektual, punonjës të fakultetit, të shkollave të mesme etj.

Kjo dëshmon se lëvizja çlirimtare për bashkimin e Kosovës me shtetin shqiptar po zgjerohet me hov të madh. Por, mjafton edhe vetëm kjo aferë politike që qeverisë së re jugosllave t'i dalin kokëçarje të mëdha[90], shkruan gazeta kroate "Hrvatski List" në Suedi.

Në vazhdim komenton gazeta "Lajmëtari i Lirisë" se burgosjet sensacionale të shqiptarëve në Kosovë, gjithashtu edhe në viset të tjera, madje edhe në Serbin e ngushtë, në B e H dhe në Kroaci, tregojnë se qeveria e re po ndihet e pasigurt pas Titos. Në Mitrovicë është burgosur një klasë e tërë nxënësish, bashkë me profesorët. Që të gjithë këta janë shqiptarë të rinj, gjë që ka rëndësi të madhe! Në Kroaci burgosin për një fjalë goje lidhur me gjendjen politike. Të gjitha ndërtesat shtetërore dhe ndërmarrjet industriale janë ruajtur me kujdestari e me ushtri. Të gjitha këto të lënë me përshtypjen e pasigurisë, gjë që e kanë vërejtur edhe të huajt; vetëm një pjesë e madhe korrespodentësh dhe gazetarësh të prishtë nuk e vërejtën[91], komenton gazeta.

Ndërsa gazeta "Amnsty International" në shkrimin "Jugosllavia dhe të drejtat e njeriut", shkruan se mospërfillja e të drejtave të njeriut në Jugosllavi bie mbi kurrizin e disa grupeve të caktuara. Grupe të rëndësishme përbëjnë nacionalistët e Kroacisë dhe ata të Kosovës. Me këtë rast duhet të kemi parasysh se në Jugosllavi ka një dallim të madh

[89] Burgosje masive në Kosovë , Lajmëtari i Lirisë, Viti I, nr. 2. Tetor-Nëntor 1980, f, 15.
[90] Në këtë mënyrë në vitin 1980, komentonte ngjarjet dhe burgosjet e intelektualëve në Kosovë gazeta "Hërvatski List", në Suedi.
[91] Punim i cituar "Burgosje…", f, 15.

mes veriut dhe jugut... Në republikën e Kroacisë, si më parë, ka forca që kërkojnë të drejtën historike për një "Kroaci të pavarur" me gjuhë dhe kulturë të veten, dhe ato forca i kundërvihen centralizmit të Beogradit. Kundër këtyre forcave , që dalin më pak në pah pas spastrimeve të vitit 1971, ndërmerren masa rigoroze dhe ata burgosen me të madhe. Punëtorët kroat në botën e jashtme, të cilët gjoja mbajnë kontakte me emigracionin kroat, kur kthehen në Jugosllavi nxirren para gjyqit...[92].
Ndërsa më vonë po e njëjta gazetë tërheq paralelen se në të njëjtën situatë ndoshta edhe më të rëndë janë shqiptaret në Kosovë. Në vazhdim ajo shkruan se një nacionalizëm i llojit tjetër shfaqet në Kosovë. Nacionalistët shqiptarë kërkojnë bashkim me Shqipërinë, Titon e konsiderojnë diktator, këta janë kryesisht nxënës dhe studentë. Ndaj tyre tani së voni është ndërmarrë një valë e madhe burgimesh, të burgosurit më së shpeshti dërgohen në burgjet jashtë Kosovës...[93]

Sikurse në vitet e më hershme por edhe në vitet e më vonshme se u dëshmua se më tepër se gjithkund në Ballkan ishte e nevojshme një stabilitet politik për hir se ishte në interes edhe të perëndimit, politikanët evropian nuk donin ta qortonin Jugosllavin për këtë mospërfillje të të drejtave të njeriut ose të protestonin kundër praktikës së kidnapimeve nga ana e UDB-es, e për të gjitha këto perëndimi kishte njohuri të mjaftueshme se çfarë po ndodhte me popullin shqiptar dhe me të tjerët në Jugosllavi.

Duke analizuar me radhë shkrimet e shtypit të huaj, hasa edhe në një shkrim që më tërhoqi vëmendje, ndërsa këtë e kishte botuar gazeta e emigracionit kroatë "Hërvatski List", me titull "Kundërthënie shqiptare". Në pika të shkurtra paraqet kundërthëniet shqiptare që mbretërojnë në emigracionin shqiptar. Disa grupe e shoqata që janë formuar në vitet para të pas LDB-së, kanë orientime properëndimore e djathtiste dhe punojnë në dëm të Shqipërisë socialiste. Gazeta na ofron si shembull se Mbreti Lekë në eksil paskësh përgatitur gjatë kësaj vere (1980), një invazion mbi Shqipërinë për ta rrëzuar Enver Hoxhën dhe komunizmin në Shqipëri (me siguri edhe Shqipërinë)....Ai sikur shumë shqiptarë të tjerë, nuk sheh se me një politik të tillë aq të keqe do të bëhej aleat i

[92] Gazeta "Amnesty International", 1980.
[93] Jugosllavia dhe të drejtat e njeriut, Lajmëtari i Lirisë, Viti I, nr. 2. Tetor-Nëntor, 1980, f, 15.

Beogradit dhe do ta shtynte Kosovën shqiptare edhe më shumë në prangat e Beogradit,[94] për të vazhduar më tej se deri sa të jetë në fuqi kjo politikë: të bësh sehir sesi Serbia e terrorizon dhe e ç'faros Kosovën shqiptare, dhe në anën tjetër të përpiqesh të shembësh Shqipërinë... Beogradi do të ketë te emigracioni shqiptarë aleatin më të mirë për pacifizmin e Kosovës[95], përmbyll shkrimin gazeta e emigracionit kroat.

Duhet shtuar se grupi tjetër që përkrahte Shqipërinë Socialiste, dhe luftonte okupimin serb ishte gjenerata më e re, e cila e shtyrë nga dhuna e terrori kishte marr rrugët e kurbetit dhe ishte vendosur diku në shtetet e perëndimit. Të ndikuar nga demokracia dhe të motivuar që Kosovën sa më parë ta shohin të lirë, ata kishin marrë mbi vetëm detyrën e organizmit të shqiptarëve në emigracion dhe me të drejt thoshte atdhetari Jusuf Gërvalla se neve shqiptarëve dhe Kosova nuk ka nevojë për disa zëra të ngritur, por ka nevojë për një zë të fuqishëm, dhe koha e dëshmoi se e tërë kjo ishte një thënie që ndoshta edhe sot kemi nevojë që të gjithë shqiptarët kudo që jemi ti artikulojmë dëshirat tona në një kërkesë të përbashkët.

3.VAZHDON BOTIMI I I GAZETËS "LAJMËTARI I LIRISË", NR. 3

Qysh në numrin e parë të gazetës ishte bërë njoftimi nga ana e redaksisë së gazetës se kjo gazetë do të dal njëherë në dy muaj. Kështu edhe numri i tretë i saj doli në muajt janar-shkurt të vitit 1981. Sikurse edhe dy numrat e mëhershëm, gazeta kishte të njëjtën teknik dhe po ashtu vazhdoi të nxirrej nga vëllezërit Gërvalla. Kishte të njëjtin format dhe trajtonte temat e nxehta politike të shqiptarëve dhe tokat shqiptare. Ishte e botuar në format A-4, dhe kishte po ashtu moto sikurse edhe numrat tjerë të saj "Me penë dhe me pushkë...", që për kohën kur botohej edhe penda e edhe pushka ishin shumë të nevojshme për shqiptarët e okupuar.

3. 1. UDB-eja, "uron " mërgimtarët për vitin e ri

Ishte viti i dytë që botohej gazeta, viti 1981. Kosova ziente nga brenda. Atdhetarët e parandienin dhe punonin me të madhe për këtë. Andaj, jo rastësisht në faqen e parë të saj është vu artikulli "Kështu na

[94] Hërvatski List, Suedi, 1980.
[95] Kundërthënie shqiptare, Lajmëtari i Lirisë, Viti I, nr. 2. Tetor-Nëntor 1980, f, 16.

“uron” UDB-ja vitin e ri”. Autori anonim shkrimin e shkruan pasi se mërgimtarët tonë vijnë në vendlindje për festat e fundvitit. Por, pushtetarët mendonin ndryshe, dhe mu këto festa i shfrytëzuan që sa më shumë shqiptar të torturonin dhe ti merrnin në biseda informative. Një gjë të tillë tmerri e llahtari e përjetoi edhe vet atdhetari Hysen Gega nga Sallagrazhda e Suharekës. Ai ishte një burrë trim dhe i gatshëm për sakrifica. Atje larg në kurbet e kishte djeg malli për prindërit e familjen e tij, edhe pse e dinte se çfarë situate e rëndë po mbretëronte në Kosovë, megjithatë kishte vendosur që të vinte në shtëpi, bile pak të çmallej me të dashurit e vet. Qëllim i mirë ishte nga ana e Hysen Gegës, por edhe udbashët kishin qëllimet e tyre, dhe se një kohë të gjatë ishin përgatitur si ta fusnin Hysenin në rrjetin e tyre.

Pasi se ishte çmallur me familjaret, mërgimtari ynë takon edhe shokët me të cilët kishte evokuar kujtimet për një kohë që kishte mungua. Festa ishte kalua si kurrë më mirë në jetë, por udbashët as atë natë nuk kishin fjetur, por ishin kujdesur që në mëngjesin e hershëm të vitit të ri ta “befasonin” dhe t’ia “uronin” vitin e ri Hysen Gegës. Aty nga ora tre e mëngjesit ishte rrethuar shtëpia e Qazim Gegës. Me një tog të madh policësh të armatosur gjerë në dhëmbë. Nga udhëheqësi i togut u kërkua që të dorëzohej Hysen Gega, duke e quajtur “armikun e popullit”, dhe shtrohet pyetja athua vallë vërtet ishte Hysen Gega armik i popullit të vet? Si mund të ndodhte një gjë e tillë. Armiku i popullit shqiptar ka qenë gjithmonë dikush tjetër. Armik i popullit shqiptar ishte polici që çirrej, dhe kërkonte me çdo kusht për ta burgosur djalin shqiptarë.

Në tmerrin e natës së ftohët, policia hulumtoi çdo skutë të shtëpisë dhe në fund para tytave të pushkëve kishte vënë babin dhe gruan e Hysenit. Iu treguan se janë të rrethuar dhe se kishin ardhur për ta arrestuar Hysenin në emër të popullit. Pas zhurmës e tollovisë së krijuar, Hyseni zgjohet nga gjumi dhe kur shef babën dhe gruan para tytave të pushkëve, tmerrohet. “Në emër të popullit” i bërtiti polici, “Hysen Gega je i arrestuar”[96] Pa u trembur aspak, Hysen Gega përgjigjej: Cilit popull??? Unë jam biri i këtij plaku, biri i këtij populli dhe i kësaj toke.

[96] Kështu na “uron” UDB-ja Vitin e Ri, Lajmëtari i Lirisë, Viti II, nr. 1, Janar-Shkurt 1981, f, 1.

Për ty ka mallkime e ankime populli, jo për mua. Ia lidhin duart dhe e fusin në kampanjollën e mavitë. Me dhunë e futën në veturë, ndërsa nga atje u dëgjua zëri i fuqishëm i Hysen Gegës i cili thërriste ma sa fuqi që kishte: Rroftë Shqipëria, rroftë populli shqiptar, poshtë titizmi, poshtë shërbëtoret e okupatorit, dhe në anën tjetër të shtëpisë britma e vëllait Danushit theu heshtjen e natës duke thirrur sa mundi: Rroftë Shqipëria, rroftë populli i bashkuar shqiptar, dhe policia nuk hezitoi për ta arrestuar edhe vëllanë e Hysenit.

Në këtë shkrim redaksia e saj atje nga mërgimi i çonte urimet më të mira Hysen Gegës duke i thënë se Rroftë populli shqiptar, i lirë e i bashkuar, po të përgjigjemi edhe ne që këtej, o Hysen Gegaj dhe ty Danush, dhe atyre mijëra djemve të këtij populli, që UDB-ja po i dergj pa kursim në burgjet e fëlliqura e mizore. Dhe, që këtej po jua përcjellim edhe sihariqin, se populli po bëhet gati për t'iu marrë ju hakun. Po, po bëhet gati populli për hakmarrjen e vet të madhe,[97] - shkruan redaksia e gazetës.

Po ashtu në këtë faqe, redaksia jep edhe një informacion të rëndësishëm për lëvizjen ilegale shqiptare duke i informuar se: Tani mund të thuhet se është i rrallë ai fshat, ajo lagje qyteti, apo ajo shtëpi shqiptare ku, UDB-a të mos ketë burgosur së paku nga një njeri, ose të mos ketë bastisur egërsisht. Me një tërbim shtazarak, që i kalon edhe kufijtë e terrorit të aksionit famëkeq të armëve të vitit 1956, pushteti jugosllavë po orvatet të zhbijnë çdo filiz të rezistencës shqiptare ndaj shtypjes dhe shfrytëzimit të egër kolonial nga ana e shovinistëve të Beogradit[98]. Për të shprehur më vonë indinjatën e thellë dhe duke e njoftuar opinionin e gjerë se përveç vëllezërve Hysen e Danush Gegaj, kohëve të fundit u arrestuan për veprimtari "armiqësore kundër popullit e shtetit" do të thotë për veprimtari patriotike. Edhe këta persona: Hasan Ukëhaxhaj, magjistër i gjuhës shqipe, profesor në gjimnazin e Deçanit, Musa Berisha, nga Duboviku, student i letërsisë shqipe, momentalisht në shërbimin ushtarak në Ptuj, si dhe një milic, të cilit ende s'ia dimë emrin etj.[99] Informonte shtypi i diasporës.

---

[97] Po aty.
[98] Informatë e redaksisë, Lajmëtari i Lirisë, Viti II, nr. 1. Janar-Shkurt 1981, f, 1.
[99] Po aty.

3. 2. Mërgimtarët tanë festonin ditën e pavarësisë

Në një shkrim të gazetës "Më të fortë se kurdoherë", shkruhej për përgatitjet dhe festimin e shqiptarëve tanë që ndodheshin në mërgim jashtë vendit shqiptar. Edhe pse jetonin të shpërndarë në të katër cepat e botës, për festa dhe kur u paraqitej nevoja, ata ishin të bashkuar falë vetëm organizimit të mirëfilltë të lëvizjeve çlirimtare shqiptare. Në shkrim gati në dy faqe tekst jepet historiku i luftërave shqiptare për liri dhe pavarësi.

Autori fillon me fjalën e diskutuesit të parë, i cili fillonte me këto fjalë: Vëllezër të dashur!

Gjithçka te ky dhe, është e huaj për ne. Kjo sallë, sendet për rreth, njerëzit, rrugët këtu na shikojnë ftohët. Në qoftë se ndonjëherë edhe ndodhë të na hetojnë pran, atëherë, pranin tonë e ndiejnë si pranin e një lecke të hedhur në rrugën e madhe,[100] dhe vërtet a ka ma trishtuese dhe me plot dhembje se sa këto fjalë që i shkruan autori. Sado i mençur dhe i fuqishëm të jesh, mendon autori, vendi i huaj dhe njerëzit e saj mërgimtarin nuk e hetojnë. Jo vetëm që nuk e hetojnë por nuk e llogarisin as si ndonjë gjë të rëndësishme që mund të ndikoj në rrjedhat e atij vendi, kështu mendonte autori i kësaj fjale përshëndetëse në manifestimin e ditës së pavarësisë.

Pastaj, autori iu dëften të pranishmëve se si historia na la me gishta në gojë dhe në bisht popujsh të tjerë, që erdhën shumë më vonë në trojet e stërgjyshërve tanë. E kush i ka shërbyer më mirë se ky popull historisë? Kush ia lau asaj më me rregull tatimin e gjakut e të sakrificës? Dhe kush kërkoi më pak prej saj: vetëm tërësinë e tokave tona deshëm dhe jetën në shtetin e përbashkët kombëtare; atë që gjithë të tjerët në Evropë e kishin prej motesh. Por, në vend që të sendërtohej kjo aspiratë e drejtë, jeta na katandisi në robëri, në skamje e mjerim. Jeta na shpërndau rrugëve të kurbetit[101] Dhe vërtet, me të drejtë thotë autori i shkrimit se ky shekull vetëm një gjë nuk e arriti; të na i prej rrembat e gjakut stërgjyshor, të përtërirë brez pas brezi nga fatosat që për vatan e troje të veta, "e kanë ba dekën si me le"[102]

---

[100] Më të forte se kurdoherë, Lajmëtari i Lirisë, Viti II, nr 1. Janar-Shkurt 1981, f, 2.
[101] Po aty.
[102] Po aty.

Autori flet shtruar për Lidhjen Shqiptare të Prizrenit, për shpalljen e pavarësisë së Shqipërisë, për shqiptarët e Çamërisë, të Kosovës e të viseve shqiptare në Maqedoni, Serbi e Mal të Zi, flet për Luftën e Dytë Botërore dhe padrejtësitë e mëdha që iu bënë popullit shqiptar më 1945, duke përfunduar me angazhimin e madh të ilegales shqiptare si në diasporë po ashtu edhe në Kosovë.

Me penë dhe pushkë...

lajmëtari i lirisë

...për liri dhe bashkim me vendin amë, Shqipërinë socialiste!

Në kundërshtim të hapët me parimin e kombësisë dhe të vullnetit të popullsive vendëse, nga trungu i Shqipërisë u shkëputën krahina të tëra si Rrafshi i Dukagjinit, Kosova dhe tokat shqiptare në Maqedoni. Më tepër se gjysma e popullisë së vendit dënohej të ndërronte zgjedhën e vjetër turke me një zgjedhë të re, atë të Serbisë dhe të Malit të Zi. ARBEN PUTO

VITI II Nr. 1 JANAR - SHKURT 1951

KESHTU NA »URON« UDB-ja VITIN E RI!

Si përvjet, dhe sivjet, shumë korbetorë u kthyen në vendlindje për t'u shlodhur nga ballet e mëdha të korbetit dhe për t' u çmallur ne njerëzit e tyre. Takimi i tyre ne familjet ka për qëllim jo donëherë shumë të madhe, i rëndësishëm dhe u jep forca të reja që, pas disa javë pushimi, të kthehen sërish atje, tek i presë puna e vështirë dhe harmoni e trashë.

Hysen Gegaj nga Sallagradishta e Siharesës, ishte punëtor i zirë e shumë i dashur për shokët e vet, çdithnjë i gatshëm t' i ndihmojë pa kursim të tjerët. Kështu ai ose një çiftin të madh e nis për në vendlindje, ku arriti artën e Vitit të Ri. Në shtëpi e prituin me mallë bashkë i rrethuar, nëna plakë, shoqja, vëllezërit, fëmijët e motrat. I harrol vajtjet e përjonara gjatë qëndrimit të tij në korbet. Jeta po i dukej sërish e bukur. Tjetër dhe i ish ky,tje të zvë bimë këtu atëhëna e dinrit, rrugën e përbaltur dhe gjendjet e ullsa.

Si a përshëndet ne prindërit - e ne fëmijët, sa u qali palën, Hysni dolli në fshat te shokët e vjetër dhe ndenji ne to deri pak para se te vente.

Në shtëpi e prituin ne pallcim. Brumin. te do tq kalonin pa të dhe këtë vit të Ri. E di nin se ai harrohej fare kur ishte ne shokët. I tallë kish qenë gjithmonë, kur i rinnte lo gët e fshatit,për t'ia shtuar një kafshatë tu lë familjes. I tillë kishte qenë edhe në kohën e rinisë në korbet, kur iu desh ta regjistrontin e njerëz ne postat e rinda të korbetit e të ndihmë në punishtet ndërtimore të Beogradit. Për shosë jepte gjithçka edhe tash,ko se tash vinte pak në thatësi e gjithçka në të jerënë. Ihe sahur kishte ca brenga të thella për nesibn e tij.

Megjithatë, pak para meinate, ai u kthye në shtëpi. Shtrëngohur e lë jerënë. Mbase pak e dhe në qe. Nën pi.ja. Por, c'ishte a je brengë e re në rrudhat e hershme, që s'po ia sqi tonin dot prindërit as e shoqja? Të barrëmbët të shpejt,tha ne vete,je pa njëfarë sfarrdjeje të denjtur,i ati,Qerim Gegaj,Mërsa,vëllai i dytë i Hysenit, Daraibi, e shkuarte ne një adairim të fshehtë,ia herë që pagim gotat apo in krisnin bingës të festës.

Rulmërcimi arriti ne shkajesin e i jerarit. Aty nga ora tre,shtëpia e Qerim Gegajt,qe rrethuar nga një tog policësh të armatosur de ri në dhëmbë.Nuk policia kishte zbë mirë e mirë pozitat,adhënjësi i saj trokiti fuqishëm në derën e shtëpisë dhe u qor qëlrsishtë.Aj kërkoi t'ia dërgonin Hysenin.

Me gjëmë,policisë nk i pëlqenin njerëzit e mirë dhe të dashur. Njerëzit e tillë i qa,ja an ne një orë absurde. "armiq të popullit"të mqtë e popullit të "ene vallë ata që s'i bëjnë gjë të keqe popullit,pos që nerdojnë dikë e natë për ballet e tij dhe të vetat.! Armiq kishin qenë dikur gjermanët,italianët,çetnikët...

Hysen Gegaj

it...Shqiptari,që dëmohet e rqetohet për një kafshatë gaje në rrugët e hidhura të gurbetit ky shqiptar të jetë armik i popullit shqiptar? Armiku i popullit shqiptar ka qenë gjithmonë dikush tjetër: armik i popullit shqiptar ishte policia që çirret, sillur i ka pikur nga qiellt e drejta për të nxjerrur njerëzit e pa fajshëm, për hir të qiskpirëvon në Beogradit!

- Jemi të rrethuar! Dëroto,ati Hysenin. - i bërtiti përsëri Ismait,dhe shqesë së Hysenit, kryepolici, duke su vënë grykën e automatikut në gjoks.

Hysni, në kryc të sëkallëve, bërtiti si i shastisur,nga tmerri që e kapi kur i pa bajnetat dhe gryan pura grykën së armës.

- Hiqe atë bekarace,or fatti, c'ke që u bë në gjë? pleqve e grave?!

- Hysen Gegaj! Në ishte të popullit, jemi i arrestuar!

- Cilit popull??? Unë jam biri i këtij plaku,biri i këtij populli dhe i kësaj toke. Për ty ka ardhur e nallkisë popullit, je pis ma.

- Mosje gojën, - çirrvj kryepolici, sur ta fshihë dasht Hysenit. - Tesh ec përpara,e kosarin do ta marrësh vesh në betanci...

- S'ke nevoj të në fshini. Vi vetë.

Po u ndal sërë rreta ne dhë,sallaxradhës e gjeod në kënd. I tgjoi sërë i fqinjëve i largarit,argatit dhe korbetçarit Hysen Gegaj,që ndonëse po la shtatin gjolitjet ne kardi, ne gruehe e shkëlqa,bërtitshe ne gjithë gjakun e tij të bëshëm:

- Poshtë titizmi,armiku i përbetuar i popullit shqiptar! Lavdi marksizëm-leninizmit!Poshtë klika tradhtare kosovare. Rroftë populli shqiptar.I lirë e i bashkuar! Rroftë Partia e Punës e Shqipërisë të kryc ne çdjëlsin e socializmit Bashë!

- Rroftë e qoftë, sa mlet ne dëverë, - iu përgjigj që nga sbori i vëllai, Hasan Gegaj dhe nk pushoi as ky,deri sa ia varë pranat dhe deri sa u nis kompanjolla e nallkisë.

Në pëlqadhën e njerëzit tbalrav, nkë rrugën e përbaltur dhe gjendjet e ullta të Sallagradishës shoti vetën shumë e thekëmë e kampanjollës se nallkisë, që u nis ne turr .trishtimi dhe mërzia e pllakat Qerim Gegaj, i cili s'e kishte kapluar gjunjën e fjalëve që thoshin të bajtë.... Mëtej sonte e ngrirë e nuses dhe vajzi i Tënu jbre...

- Rroftë populli shqiptar, i lirë e i bashkuar! - po të përgjigjesh edhe në që këtej, e Hysen Gegaj, dhe ty Daraib, dhe atyre ni jëra djalave të këtij populli, që UDB-ja po i dergj pa kurrën në burgjet e fillikata e stacre.Dhe që këtej po ju përçjellin edhe sillurigën, se populli po bëhet gati për t'ju marrë ju hakmarrjen!

Po bëhet gati populli për hakmarrjen e vet të madhe!

Tani mund të thuhet se është i rrallë ai fshat,a jo lagje qyteti,apo ajo shtëpi shqiptare ku UDB-a të mos ketë burgosur së paku nga një njeri, ose të mos ketë bastisur ogërsisht. Në një terbim shtatanuk,që i kalon edhe kufijt e terrorit të aksionit fashist të ansëve të vitit 1939, revizionistët japullavë po ervaten të zbëllisë qdo fillinë të resistencës shqiptare ndaj shtypjes dhe shfrytëzimit të egër kapitalist e kolonialist nga ana e shovinistëve të Beogradit.

Ne indinjatë të thellë i ë bjnë ne dije forcat tona revolucionare dhe shurë popullin se, përveç vëllezërve Hysen dhe Ibrahim Gegaj, kohëve të fundit u arrestuan për veprimtari "armiqësore kundër popullit e shtetit",do të tho të për veprimtari patriotike,edhe këta persona: Hasan Uksharaj,mësuestër i gjuhës shqipe profesor në gjimnazin e Gjonit,Mehë Ferisha, nga Bubovidu,student i letërsisë shqipe,amelatishët në shkëmbin ushtarak në Prujsi,si dhe një nlic,të cilit emër s'ia dinë emrin etj.

3. 3. Konferenca e Bujanit, në faqet e "Rilindjes"

Në të njëjtën faqe (3), të gazetës "Lajmëtari i Lirisë", jepet njoftimi se si gazeta "Rilindja" në vigjilje të Vitit të Ri, në rubrikën e saj "Në ditën e sotme", na njoftonte: "Në Bunjaj (më 1943) filloi puna tri ditësh e Konferencës së Parë Krahinore të Këshillave Nacionalçlirimtare të

Kosovës dhe Metohisë. Në prezencën e 51 delegatëve nga të gjitha rrethet e Kosovës e të Metohisë, u zgjodh Këshilli i Parë Nacionalçlirimtar krahinor, u caktuan detyrat e tij dhe iu bë proklamata popujve të K e M, që ta intensifikojnë luftën kundër okupatorit fashist"[103], por, në vazhdim të njoftimit nuk jepet se çfarë kishte në atë proklamatë. Me asnjë fjalë nuk njoftohej populli për përmbajtjen e Rezolutës së Konferencës, ku thuhej se: "Populli shqiptar, i cili me shekuj luftoi për çlirimin dhe krijimin e shtetit të vet kombëtar, si dhe pjesa e trojeve shqiptare dhe pjesa e popullit shqiptar që pat mbetur jashtë kufijve shtetëror shqiptarë, me çlirimin nga pushtuesit (fashistë, do ti realizojnë aspiratat e veta dhe do ti bashkëngjiten shtetit amë - Shqipërisë...[104]

Autori i shkrimit mendon se kjo informatë e lëshuar në faqet e "Rilindjes", ishte një provokim i lig i vullnetit të popullit tonë, i cili u çua në luftë ngadhënjimtare kundër fashizmit, i çliroi tokat e veta dhe u erdhi në ndihmë edhe popujve e të Jugosllavisë. Sepse, fuqitë aleate në Luftën e Dytë Botërore dhe Jugosllavia, të cilat e kishin nënshkruar Rezolutën e përmendur të Konferencës së Bunjajt, madje në cilësinë e garantuesve për realizimin e saj, e shkelën atë si të ishte fjala për një marrëveshje të parëndësishme tregtare, e jo për vullnetin e një populli të tërë, të shumëvuajtur,[105] konstaton autori i shkrimit.

3. 4. Rinia shqiptare, Rini revolucionare

Në shkrimin "Rini shqiptare, Rini revolucionare", më me ëndje do të thosha se është një shkrim i shkruar në formë afishe, që i drejtohet rinisë shqiptare të Kosovës dhe të viseve tjera të banuara me shqiptar në Jugosllavi. Autori me një gjuhë tjetër rinin shqiptare të Kosovës e quan edhe pararoja e popullit shqiptar, dhe kjo pararojë nëpër mes të këtij shkrimi fton në luftë për çlirimin e tokave tona të shtrenjta nga kthetrat e kralëve të rinj jugosllavë. Lufta e popullit tonë për pavarësi nuk ka pushuar kurrë asnjëherë ndër shekuj. Populli ynë dhe rinia e jonë heroike luftojnë dhe do të luftojnë deri në çlirimin e të gjitha territoreve nga shovinistët jugosllavë. Dhe për të ecur drejt kësaj rruge të shenjët, sot

[103] Gazeta "Rilindja", dhjetor 1980.
[104] Rezoluta e Konferencës së Bujanit (31 dhjetor, 1943-1,2 janar 1944).
[105] Një provokim i lig i vullnetit të popullit, Lajmëtari i Lirisë, Viti II, nr. 1. Janar-Shkurt 1981, f, 3.

duhet t'ia caktojmë vetes detyrat që kërkojnë prej nesh zgjidhje[106] dhe vazhdon autori të përgjigjej se si e vetmja rrugë, qëllim dhe detyrë e rinisë sonë liridashëse është edukimi edukativo-politikë dhe përgatitja e të rinjëve shqiptar për luftë nacionalçlirimtare të Kosovës dhe viseve të tjera të robëruara nga klika shoviniste e Titos.

Duke i numëruar të gjitha luftërat dhe të gjitha fitoret, autori i shkrimit na prezanton tradhtinë e madhe që na bënë jugosllavët më 1945, por edhe më vonë se si udbashët na përcillnin hapa pas hapi dhe shkonin aq larg sa na ndalonin që në mënyrë legale të dëgjonim Radio-Tiranën dhe të lexonim shtypin dhe literaturën që botohej atje. Autori merr si shembull se si në kohën e fashizmit nuk lejonte të dëgjoheshin në radio emisionet e aleatëve, që informonin për gjendjen në frontet e ndryshme antifashiste. UDB-ja jugosllave nuk lejon sot (1981), të dëgjohet radioja e të vetmit vend socialist në botë, Radio Tirana... Por, mashtrohen këta zotërinj. Siç janë mashtruar të gjithë armiqtë e vjetër e të rinj përpara qëndresës sonë këmbëngule kundër vlerave dhe frymës së huaj. Rinia jonë nuk trembet kurrë nga dredhitë dhe presionet e tyre. Trimërinë dhe guximin i kemi të trashëguara brez pas brezi, kurse qëllimi i madh që kemi përpara, na bënë edhe më të pathyeshëm[107]

Qëllimi i autorit është që të na dëftej se për ti realizuar aspiratat tona, lypset guxim, trimëri, vigjilencë, vendosmëri dhe sakrificë. E këto virtyte nuk i kanë munguar kurrë popullit dhe rinisë sonë. Lufta kundër armikut shekullor shkon krah për krah me luftën kundër shfaqjeve e dukurive të huaja, që paraqitën në mesin tonë. Indiferentizmi, pasivizmi, heshtja, ngurrimi - nuk kanë vend në luftën tonë[108]. Shkrimi i lartpërmendur, më tepër i ngjanë një afishe të shpërndarë në popull se sa një shkrimi gazetaresk, por që flet dhe analizon dendur historinë e popullit shqiptar në tërësi.

3. 5. Kurthet dhe hendeqet e pushtetit

Për kurthet dhe hendeqet e pushtetit jugosllav, flet shkrimi në vijim "Kurthet dhe hendeqet", por që nuk i dihet autori. Herë-herë më befason e dhëna se duke lexuar dhe analizuar shkrimet e kësaj gazete, në shkrime

---

[106] Rini shqiptare, Rini revolucionare! Lajmëtari i Lirisë, Viti II, nr. 1, Janar-Shkurt 1981, f, 4
[107] Po aty, f, 6.
[108] Po aty.

nuk hasi në emra dhe as në pseudonime të autorëve, dhe pyes veten, pse ky shtyp i botuar jashtë Kosove, dhe dihej se shkrimet i bënin mërgimtarët tanë, që shumica nga ata edhe kishin kërkuar azil politik, pse nuk i kanë shkruar emrat ose, pse nuk kanë shkruar me pseudonime, siç kanë bërë ilegalistët e organizatave të mëhershme ilegale.

Është e ditur se udbashët nuk vepronin vetëm në Kosovë e Jugosllavi, por kishte shumë nga ata që vepronin dhe hetonin shqiptarët që punonin kundër Jugosllavisë edhe jashtë vendi. Ishte krejt e kuptueshme, se hetuesit që gjurmonin veprimtarët, nuk u kënaqnin vetëm me masat e marra ndaj atyre, por siç dihej edhe nga shumë raste, ata për aktivitetin e tyre jashtë merrnin masa ndëshkuese edhe ndaj familjarëve që jetonin në Kosovë, dhe besoj se kjo ishte edhe arsyeja që në faqet e shumta të këtij shtypi mungojnë emrat dhe pseudonimet, vetëm se, për ti identifikuar shkrimet tani, është me shumë vështirësi.

Në shkrimin "Kurthet dhe hendeqet", autori shkruan për veprimet e paramenduara që i bëjnë pushtetarët ndaj popullit të pafajshëm shqiptar, dhe asgjë e re do të thosha, se për kurthe, krime, shantazhe, burgosje, tortura, hendeqe, populli jonë i okupuar dhe nën pushtetin jugosllav të gjitha këto marifetllëqe i pati me bollëk. Veç këtyre kurtheve ata punuan edhe në aspektin ligjor dhe të gjitha ato padrejtësi i legjitimoi dhe i futi në sistem. Si çdo pushtues dhe si çdo klikë antipopullore, edhe regjimi i Beogradit është përpjekur e përpiqet ta përjetësojë pushtetin e vet. Pos të tjerash edhe me dispozitat ligjore. Korrekte në dukje të parë, këto dispozita, në thelb përmbajnë nene e klauzola të atilla, që kanë për qëllim realizimin e aspiratave më të erra antipopullore, antikombëtare dhe antiklasore. Këto dispozita janë ato që përligjin diskriminimin social e nacional të disa popullsive, varfërimin dhe shtypjen gjithnjë më të madhe të një pale dhe pasurimin e privilegjet gjithnjë më të mëdha të një pale tjetër, në kurriz të së parës.[109]

Herët a vonë shkruan autori i shkrimit se pushtuesit dhe klika antipopullore do të gremisen atje ku ua kanë bërë vendin historia dhe popujt e shtypur. Këtij mallkimi nuk do të mund ti bëjë bisht as Jugosllavia titiste. Ajo vërtet ka kurdisur shumë leqe dhe ka hapur

[109] Kurthet dhe hendeqet, Lajmëtari i Lirisë,Viti II, nr. 1. Janar-Shkurt 1981, f, 7.

shumë llagëme për punonjësit dhe popujt e shtypur, që të mbajtur me forcën e dhunës brenda kufijve administrativo-politik të këtij shteti social-shovinist, do të shtrëngohen t'i japin shumë e shumë zor për ta hequr qafën nga laku. Megjithatë për çdo ditë po bëhet më e qartë se këta popuj do të mbesin edhe më tej ata që janë- të përjetshëm, kurse në kurthet e në hendeqet e kurdisura për ta do të bjerë vetë kreatura e regjimit antipopullor jugosllav, në krye me hegjemonizmin serb, e me shovinizmin malazez e maqedonas,[110] thotë autori i shkrimit.

I tërë shkrimi i kushtohej një dispozite kushtetuese e cila u shkaktonte telashe të mëdha krerëve shoviniste të Beogradit. Fjala ishte për dispozitën mbi statusin të ashtuquajtura territor të papërzier në pikëpamje nacionale. Një status të tillë, sipas dispozitës në fjalë, e gëzojnë ato tersi administrativo-politike të federatës (ato republika dhe krahina), në të cilat popullsia e një kombësie përbënë mbi 80% të popullsisë së përgjithshme.

Në kohën që kjo dispozitë u ngjit e bëri vend në Kushtetutë, nuk ekzistonte frika se statusin e territorit kombëtarisht të papërzier mund ta gëzonin një ditë edhe ato regjione ku kjo gjë ishte e padëshirueshme për shovinistët sllavë.[111]

Pushtetarët e Beogradit ishin shumë të bindur se me Kosovën dhe viset e tjera shqiptare i kishin kryer punët. Tokat shqiptare i kishin copëtuar në tri republika dhe Kosovën e kishte aneksuar R. e Serbisë. Në Kosovë nuk ndërtohej ndonjë fabrikë apo industri e rëndë. Situata e rëndë politike dhe kushtet e vështira për jetë kishin ndikuar dukshëm që ata të shpërnguleshin si për Anadoll po ashtu edhe në vendet tjera perëndimore. Derisa shqiptarët shpërnguleshin, në tokat e tyre sillnin kolonë sllavë dhe i ngulitnin aty me kushte shumë të favorshme për jetesë. Atyre iu siguronin tokë e shtëpi, i punësonin e shumë favore tjera. Ndërsa për shqiptarët kishte punë vetëm në ato punishte të domosdoshme, ku nxirreshin lëndët e para dhe pasurit e tjera të mëdha të shqiptarëve, që merrnin rrugën e Beogradit. Popullsia shqiptare shtypej në pikëpamje sociale e nacionale, ekonomike e politike ;mbi të ushtrohej terrori i egër politik dhe presioni i vazhdueshëm, që duhej të

[110] Po aty.
[111] Po aty.

zbrazej fare nga elementi autokton shqiptar dhe, e mbushur me elementin ardhacak sllavë, të ndërronte rrënjësisht fizionominë etnike dhe nga krahina shqiptare, të bëhej një krahinë sllave.[112] Por, llogarit e Beogradit, ishin pa mbulesë. Çka ndodhi me trojet shqiptare. Ishte ajo nëna shqiptare që e mundi Qubrilloviqin por edhe okupatorin. Nataliteti shqiptar në vitet në vijim u shtua dukshëm, ndërsa atdhetarët e shumtë në trojet tona formuan dhe organizuan shumë organizata ilegale, të cilat në mënyrë permanente informonin popullin për qëllimet e armikut dhe synimet e tija ekspansioniste.

3. 6. Gazeta "Rilindja" në thumb të kritikës

Në shumë shkrime të "Lajmëtarit të Lirisë", kam hasur se, dendur kritikohet politika redaktuese e saj. Kritikohen shkrimet, herë-herë edhe gazetarët, por në të shumtën e rasteve kritikohet politika e redaksisë, që shkruan në mënyrë të padrejtë për ngjarjet dhe situatën politike në Kosovë.

Në vazhdën e këtyre shkrimeve, është edhe shkrimi "Një variant leximi", që edhe këtij i mungon emri i autorit. Me një mënyrë, shkrimi i "Lajmëtarit..." e vë në lojë dhe karikon dukshëm me shkrimin që e kishte bërë gazetari i "Rilindjes", (Ç.I). "Gazeta "Rilindja", thotë autori i shkrimit të "Lajmëtarit..." mund të lexohet edhe mbrapsht, ngase asgjë nuk humb. Se në këtë gazetë ("Rilindja"), jepen aq shumë të pavërteta sa për njohësit e mirë të situatës në ekonomin kosovare, i kap tmerri. Në shkrimin e gazetës "Rilindja", gazetari lavdëron me të madhe të arriturat e minatorëve dhe të ardhurat që vijën nga shitja e xehes. Do të kishte qenë vërtet shkëlqyeshëm po të ishte kështu, por gazeta ilegale që botohej në atë kohë në Gjermani, "Lajmëtari..." i kundërvihej kësaj të dhëne. Me argumente shkruan se, "Trepça" është e detyruar t'i shes' prodhimet e veta vetëm në tregun e brendshëm-me çmime deri në 20 herë më të ultë se çmimet në tregun botëror, ndërkohë që çmimet e hekurit, çelikut dhe të bakrit të prodhuar jashtë Kosove, po në tregun e brendshëm jugosllav, janë shumë më të larta se ato në tregun botëror, përkatësisht 124, 72, dhe 27,5%, vetëm për shkak të diskriminimit me anë të çmimeve të ultë, gjatë vitit 1978 kjo minierë gjigante pati mbi

[112] Po aty.

300 miliardë dinarë humbje; gazetari i "Rilindjes" do të mund të lexonte së paku në "Kohë të lirë, deri sa çlodhet nga referatet e LSPP-së edhe revistën "Economia"[113], porosit autori i shkrimit.

3. 7. Parapërgatitjet për regjistrimin e popullsisë

Pasi se ishte pushtuar dhe aneksuar Kosova dhe viset tjera shqiptare nën ish-Jugosllavi, pushtetarët e Beogradit, megjithatë nuk ishin të qetë. Tokave shqiptare ia kishin vënë kufirin dhe merrnin e plaçkitnin çdo të mirë natyrore nga tokat tona, por populli shqiptar kishte bërë benë se nuk do i lëshonin këto toka për pa u farua të tanë, thoshte kënga popullore.

Shikuar në aspektin ekonomik, Jugosllavia kishte interesa të mëdha për tokat e pushtuara shqiptare si në Kosovë, Dukagjin, Maqedoni, Mal të Zi, e në Serbi. Pasurit natyrore në këto vise ishin procentualisht nga më të mëdhatë në gjithë territorin administrativo-politik të Jugosllavisë. Ato sigurojnë një pjesë të madhe lëndësh të para dhe rezerva të begatshme natyrore, që ndikojnë dukshëm në potencialin e përgjithshëm të pasurive të këtij vendi. Ndërkaq në pikëpamje politike, pushtimi i këtyre viseve - bashkë me përpjekjet e vazhdueshme për pushtimin e Shqipërisë Veriore deri te lumi Shkumbin (para lufte), ose për shndërrimin e gjithë Shqipërisë në republikë të shtatë (pas LDB-nga shovinistet serb e malazezë është konsideruar detyrë "kombëtare" dhe hap i domosdoshëm në sendërtimin e ëndrrës pushtuese sllavomadhe, në gjurmët e përtëritjes së shtetit mesjetar serb të Nemanjiqve[114], shkruan autori për synimet gllabëruese të shovinistëve të Beogradit.

Punimi "Armikut-gurin e gjakut", i cili është shkruar në prag të fillimit të përgatitjeve të regjistrimit të popullsisë në Jugosllavi (1981), autori e ndan në pesë nëntituj, duke folur veç e veç për secilën pjesë.

Ta zëmë, në nëntitullin "Popullsia pengesë e pa kapërcyeshme", trajtohet situata politike dhe aspiratat ekspansioniste të shovinistëve të Beogradit të cilët i kurdisnin për tokat shqiptare. Në shkrim konstatohej se për ta shfrytëzuar sa më shumë dhe pa frikë pasurit tona, vazhdimisht ka ekzistuar një frikë e madhe tek pushtetarët dhe një pengesë e pa

[113] Një variant leximi, Lajmëtari i Lirisë, Viti II. Nr. 1. Janar-Shkurt 1981, f, 7.
[114] Armikut-gurin e gjakut! (Në prag të regjistrimit të popullsisë, që fillon në prill), Lajmëtari i Lirisë, Viti II, nr. 1. Janar-Shkurt 1981, f, 8.

kapërcyeshme: popullsia vendëse shqiptare. Etnikisht, kjo popullsi gjithmonë kishte qenë kompakte në viset e veta, kurse historikisht, ajo kishte një traditë të madhe luftarake e rezistuese ndaj pushtuesve të huaj edhe më të mëdhenj e më të fuqishëm... Zgjidhja më e mirë, siç kanë treguar përpjekjet e vazhdueshme jugosllave dhe siç është e natyrshme për shumë pushtues barbarë, do të kishte qenë shfarosja e plotë e shqiptarëve[115], por pasi se kjo formë e zhdukjes së shqiptarëve ishte tregua e pasuksesshme, okupatori kishte ndërmarr masa tjera ndëshkuese, që i manifestonte në forma e metoda të ndryshme. Andaj, duke i ditur të gjitha këto, pushtetarët gjetën njëmijë e një arsye që sa më shumë shqiptarë të malltretojnë, të torturojnë dhe pas kësaj sa më shumë të arrestojnë dhe ti dënojnë me vite të shumta burgu.

Në nëntitullin e dytë "Genocidi mbi shqiptarët", thuhej se pasi se shfarosja e plotë e shqiptarëve me mjete të dhunës u tregua e parealizueshme qysh në fillim, autori sjell disa shkaqe për të cilat nuk u realizua ky planë.

1. Për shkak se shteti amë i shqiptarëve, pas shpalljes së Pavarësisë së Shqipërisë më 1912, - siç detyrohen të pranojnë me keqardhjen më të madhe kreatorët e shovinizmit serb-u konsoliduan më shpejt nga ç'pritej dhe i topiti në një farë dore apetitet serbe për pushtimin e Shqipërisë.[116]

2. Ky konsolidim i Shqipërisë, për aq sa e dekompozoi në zhgjëndërr të hidhur ëndrrën e ëmbël jugosllave, edhe popullsisë shqiptare në viset e pushtuara i jepte impulse për një qëndresë sa më të madhe e më heroike përpara tërbimit shovinist të jugosllavëve.[117]

3. Sikundër që me ndihmën e fuqive të mëdha i kishte shtënë në dorë këto vise, Jugosllavia, po karshi fuqive të mëdha dhe karshi opinionit ndërkombëtar kishte disa obligime[118] (sado formale) lidhur me qëndrimin ndaj popullsisë së pushtuar vendëse.[119] Se sa iu kishte përmbajtur këtij Traktati shteti SKS, më së miri e dëshmon shkrimi i Komisionit Ndërkombëtar i Kontrollit, i formuar në një institut evropian,

---

[115] Popullsia, pengesë e pakapërcyeshme, Lajmëtari i Lirisë, Viti II, nr. 1, Janar-Shkurt 1981, f, 8.
[116] Genocidi mbi shqiptarët, Lajmëtari i Lirisë, Viti II, nr. 1. Janar- Shkurt 1981, f, 8.
[117] Po aty.
[118] Traktati i Pakicave, ishte nënshkruar më 1919, në Saint Germin-en-Laye, nënshkruese e së cilës ishte edhe Jugosllavia e Vjetër., dhe në të thuhej se "Shteti Serbo- Kroato-Slloven merr përsipër t'u sigurojë të gjithë banorëve mbrojtjen më të plotë të jetës e të lirisë, pa dallim klase, kombësie gjuhe, race ose feje"
[119] Punim i cituar "Genocidi…", f, 8.

i cili në atë kohë raportonte: "Djegie shtëpish e fshatrash, vrasje masive e popullsisë së paarmatosur e të pafajshme, dhunë e ashpërsi e pashembullt, plaçkitje dhe akte mizore nga më të ndryshmet, këto ishin mënyrat që kanë përdorur dhe po përdorin ushtritë serbe e malazeze për t'ua ndryshuar kryekëput fizionominë etnike krahinave të banuara qind për qind me shqiptarë"[120] Nuk ishte hera e parë që Jugosllavia dhe pushtetarët e saj që merrnin mbi vete dhe nënshkruanin lloj-lloj traktate e deklarata për respektimin e të drejtave të kombeve që jetonin në Jugosllavi. Në mbarim të vitit 1945, menjëherë pas mbarimit të luftës, të gjitha problemet, që lidheshin me Kosovën dhe të ardhmen e saj, ato u shtruan dhe u tentua të zgjidhen në kuadër të Jugosllavisë së Titos. Gjatë luftës udhëheqësit e PKJ-së kishin premtuar se e ardhmja e Kosovës do të zgjidhej nga vetë popujt që jetonin atje, me mirëkuptim nga partitë e regjimet demokratike popullore që do të vendoseshin në Shqipëri e në Jugosllavi, pas fitores mbi fashizmin[121]. Gjatë luftës vazhdimisht ishte folur e shkruar se pas saj (luftës), do të respektohet Deklarata e Moskës[122], Karta e Atlantikut[123], Deklarata e Teheranit[124], Letra e Titos[125] e botuar në gazetën "Proleter", Rezoluta e Bujanit[126] e, shumë dokumente të tjera me rëndësi historike.

---

[120] Komisioni Ndërkombëtar i Kontrollit, 1919.

[121] Udhëzime të S.V. Tempos për KK të PKJ-së për Kosovë, me 2 tetor 1943, f. 2

[122] Deklarata e Moskës u miratua në tetor 1943 , e cila kërkonte të "zbatohej bashkëpunimi më i ngushtë në udhëheqjen e luftës dhe në të gjitha çështjet, të cilat kanë të bëjnë me kapitullimin dhe çarmatimin e shteteve armike.

[123] Karta e Atlantikut, u nënshkrua ndërmjet V. Çerçilit dhe F. D. Ruzveltit. Në këtë dokument të rëndësishëm në mes tjerash thuhet "kthimi I të drejtave sovrane dhe të vetëadministrimit atyre popujve , të cilëve u janë marrë ato dhe respektimi I të drejtave të të gjithë popujve , që të zgjedhin formën e vet të qeverisjes (14 gusht 1941)

[124] Deklarata e Teheranit, u soll me 1 tetor 1943, u nënshkrua ndërmjet Ruzveltit, Çerçillit dhe Stalinit. Kjo deklaratë garantonte se të gjithë popujve aleatë në Luftën Antifashiste so t'u njihet e drejta për të rregulluar marrëdhëniet e veta "sipas aspiratave të tyre të ndryshme dhe sipas ndërgjegjes së tyre vetanake"

[125] Letra e Titos u botua në dhjetor të vitit 1942, në gazetën "Proleter", me titull "Çështja kombëtare në Jugosllavi në dritën e Luftës Nacionalçlirimtare". Në mes tjerash në lidhje me çështjen e shqiptarëve thuhej se "Çështja e Maqedonisë, çështja e Kosovës e Metohisë, çështja e Malit të Zi, çështja e Kroacisë, çështja e Sllovenisë, çështja e Bosnjës e Hercegovinës do të zgjidhet lehtë ashtu siç dëshirojnë të gjithë, sepse do ta zgjidhë populli, kurse këtë të drejtë e fiton çdo popull, me pushkë në dorë, në këtë luftën e sotme Nacionalçlirimtare"

[126] Rezoluta e Bujanit, u miratua me 31 dhjetor 1943 dhe me 1 e 2 janar 1944, në fshatin Bunjaj të Malësisë së Gjakovës. Në Mbledhjen Themeluese të Komitetit Antifashist Nacionalçlirimtar të Kosovës e Dukagjinit. Në këtë mbledhje merrnin pjesë 49 delegatë (43 shqiptarë, 6 serbë e malazezë). Përveç Rezolutës që është një dokument me një rendësi të madhe historike, u soll edhe Proklamata e Kryesisë së KNÇ-së së Kosovës, në të cilën thuhet se "Liria e juaj, qëndron në luftën tuaj, sepse vetëm lufta e armatosur, e përbashkët kundër okupuesit dhe ndihmësve të tij është rruga me të cilën sigurohet liria dhe e drejta për vetëvendosje dhe shkëputje". Në këtë mbledhje u zgjodh edhe udhëheqësja e re prej 9 vetave (7 shqiptarë, 2 serbë e malazezë).

Në Jugosllavinë e pasluftës u deklaruan se kriteri kombëtar do të vihej në themel të ndarjes territoriale dhe administrative të vendit. Por, pas përfundimit të luftës këto kritere për pushtetin jugosllav, nuk ekzistonin, dhe si të tilla nuk u morën parasysh. Edhe pse viset shqiptare përbënin një tersi territoriale, ishin kompakt nga pikëpamja kombëtare, kishin një vijueshmëri e shtrirje të përcaktuar qartë nga pikëpamja gjeopolitike gjatë kufirit me trungun amtar dhe me republikat e tjera të Jugosllavisë, u ndanë midis njësive federale Maqedonisë, Malit të Zi dhe Serbisë[127]. Të gjitha këto ndikuan që në popullatën shqiptare të rritet pakënaqësia. Këtë më vonë e pranuan edhe vet udhëheqësit jugosllav.

Në nëntitullin e tretë "Pranimi i fajit pas aktit të kryer", shkruhet për ndërmarrjen e presionit e të dhunës ndaj shqiptarëve, por metoda më e preferuar e okupuesit ishte dhe mbeti falsifikimi i të dhënave statistikore mbi numrin e shqiptarëve dhe mbi lëvizjen demografike të popullsisë shqiptare. Në këtë drejtim Jugosllavia kishte investuar shumë, sepse fshehja e numrit të shqiptarëve në truallin e saj administrativo-politik si dhe fshehja e numrit të shqiptarëve të shpërngulur në Turqi e gjetkë, ka një ndikim me shtrirje të gjerë, e presupozon rezultate afatgjata në pretendimet pushtuese ndaj viseve shqiptare.[128]

Për fillimet e falsifikimeve, autor thotë se ato kanë filluar herët, në fillimet e para pushtuese jugosllave, menjëherë pas vitit 1912. Falsifikimin e kishte filluar Jovan Cvijiqi, gjeograf serb, e për të vazhduar nëpër vite e dekada dhe për të kulmuar më 1999, bile me të njëjtën politikë vazhdohet edhe sot.

Pos numrit të popullsisë që vazhdonte të jetonte në tokat e veta apo të marrë rrugën e kurbetit në territoret e pushtuesit, të dhënat statistikore të të gjitha kohërave përpiqen të na e fshehin me këmbëngulje e perfiditet sidomos numrin e shqiptarëve të shpërngulur në Turqi, me plane shtetërore jugosllave për shpopullimin e trojeve shqiptare nga elementi autokton dhe popullzimin e tyre - me elementin kolonësh sllav[129] thotë autori i shkrimit të gazetës.

---

[127] Dr. Lefter Nasi, E vërteta mbi Kosovën dhe shqiptarët në Jugosllavi, Tiranë 1990, f. 409
[128] Pranimi i fajit pas aktit të kryer, Lajmëtari I Lirisë, Viti II, nr. 1. Janar-Shkurt 1981, f, 8.
[129] Punim I cituar "Armikut- gurin e gjakut", f, 8

Një titull mjaft interesant e mban nëntitulli i shkrimit "Si të pacifizohen shqiptarët e kroatët e Bosnjës", në të cilën autori shkruan në vazhdim se në të gjitha regjistrimet jugosllave të popullsisë, më 1921, 1948, 1953, 1961 dhe 1971, numri i shqiptarëve dhe i kroatëve të Bosnjës është falsifikuar në mënyrat më të liga. Për realizimin e këtij qëllimi, shovinistët serbomëdhenj kanë trilluar emërtime të çuditshme për kombësi të shpikura prej tyre dhe "teza" të shumta që s'kanë të bëjnë aspak me shkencën.[130] Për të vazhduar me analiza të mëtejshme se në regjistrimet para lufte, shqiptarët nuk kanë pasur mundësi të deklaronin kombësinë e tyre, se si pyeste kush, po vetëm të deklaroheshin lidhur me besimin e tyre fetar dhe me gjuhën amtare. Në pozitë të ngjashme ishin edhe kroatët e Bosnjës të besimit fetar mysliman. Mbi të dy palët bëhej presion dhe insistohej që këta të deklaroheshin turq. Në mënyrë që pastaj me dhunë e presione t'u epet rruga e Anadollit.[131]

Për të bërë numrin sa më të vogël të popullatës shqiptare në ish-Jugosllavi, pushtetarët kishin shpikur edhe terme që nuk kishin të bënin fare me shqiptarët. Ata kishin trilluar apo thënë më ndryshe kishin falsifikuar edhe emërtimet më të ndryshme për shqiptarët edhe si popull edhe si komb. Pushtetarët trilluan një tezë neveritëse për ne duke na quajtur "arnaut" (serb të shqiptarizuar). Cvijiqi shënonte për ekzistimin e 140 familjeve "arnaute" në Kosovë. Ndërsa, Dimitrije Tucoviqi e kundërshtonte një të dhënë të tillë duke thënë se "kurrë historikisht nuk kanë ekzistuar rrethana që të kushtëzonin shqiptarizimin e serbëve"[132].

Autori i shkrimit, na rrëfen për falsifikimet në vitet e kaluar se çfarë ka ndodhur me popullatën shqiptare, por për të nxjerr mësim nga pësimet, ai merakosët për regjistrimin e vitit 1981, për të cilën bëheshin përgatitje të mëdha, dhe pale se çfarë marifetllëqesh do të shpikin për ne. Dhe vërtet frika e autorit u dëshmua më vonë se ishte e arsyeshme. Në krizën më të madhe në historinë e jugosllavëve, në kohën e lëvizjeve më të mëdha të disidentëve politik, të përçarjeve edhe në vetë radhët më të larta të qeverisë jugosllave; në kohën e burgosjeve të papashme politike të shqiptarëve e të kroatëve dhe të lëvizjeve të mëdha të këtyre dy

[130] Si të pacifizohen shqiptarët e kroatët e Bosnjës, Lajmëtari i Lirisë, Viti II, nr. 1, Janar-Shkurt 1981, f, 9.
[131] Po aty.
[132] Po aty.

kombësive për çlirim definitiv nga Jugosllavia[133].Po atë vit, më 1981, NIN-i kishte shkruar që është mirë që gjatë regjistrimit të popullsisë, të parashihej edhe kolona, që kush të donë mund të regjistrohet edhe "Jugosllavë", dhe ashtu kishte ndodhur, se termi në fjalë sa ishte tendencioz po ashtu ishte edhe i rrezikshëm për popujt jo sllavë siç ishte rasti me shqiptarët.

Në nëntitullin e fundit të shkrimit "Armikut-gurin e gjakut", që titullohej "Dezintegrimi i kompaktësisë etnike të shqiptarëve", bëhej fjalë edhe më tej për shpikjen e termit "jugosllavë", dhe që cak sulmi kishin "myslimanët" dhe shqiptarët. Si gjithmonë pushtetarët asnjëherë nuk kishin marr as mundin më të vogël që të bisedonin dhe të merreshin vesh për të gjitha këto marifetllëqe. Sipas autorit të shkrimit, ai konstaton se edhe në regjistrimet e kaluara, të vitit 1971, shqiptarët e patën kuptuar se ka ardhur koha e fundit që të dalin në dritë të gjitha dredhitë e pabesitë jugosllave dhe patën vendosur që jugosllavëve, në vend që t'ia fal kombësinë e vet, do t' falë më me qejf gurin e gjakut. Ndonëse edhe atëherë u bënë manipulime me numrin e popullsisë, rezultatet e regjistrimeve qenë fatale për jugosllavët (sidomos për maqedonasit, të cilët i kishin vonua për gjashtë muaj rezultatet nga republika e tyre, vetëm e vetëm për të manipuluar disi numrin tejet të madh të shqiptarëve). Këto rezultate i dhanë impulse të reja popullit tonë të robëruar. U pa se, sa i përket shtimit natyror dhe moshës mesatare të popullsisë, shqiptarët janë kombësia më vitale jo vetëm në Jugosllavi; u pa se , me gjithë përpjekjet më ç'njerëzore të armikut për të zhbirë farën e popullit tonë nga viset shqiptare , ajo kurrsesi nuk po rrallohet[134], përkundrazi për vjet po shtohet dhe po rritet.

Për veprimet e tyre të pushtetit jugosllav, ata arsyetonin në vete duke parashtruar para vete shumë qëllime:

1. Në rastin më fatlum për pushtuesin, me zvogëlimin e numrit të shqiptarëve deri në një minimum dhe me shtimin proporcional të numrit të kolonëve sllavë në tokat shqiptare, shovinistët jugosllav pretendojnë të fitojnë "të drejtat historike" mbi tokat tona;

---

[133] Po aty.
[134] Dezintegrimi i kompaktësisë etnike të shqiptarëve, Lajmëtari i Lirisë Vitit II, nr. 1, Janar-Shkurt 1981, f, 9.

2. Në një rast më pak fatlum për ta, kur nuk do të mund të sigurohej dezintegrimi i dukshëm i kompaktësisë etnike shqiptare po një dezintegrim i pjesërishëm, atyre u mbetet në dorë mundësia që popullsisë sonë t'ia reduktojnë edhe ato të drejta formale, që i përgjigjen shkollës së caktuar të kompaktësisë etnike më të madhe etnike të shqiptarëve.[135] Mirëpo, me zhvillimin e ngjarjeve të mëvonshme, tërësisht në Kosovë dhe Jugosllavi ndryshoi situata politike. Me shpërthimin e demonstratave studentore të vitit 1981, intelektualet dhe anëtarët që aderonin në lëvizjen ilegale të Kosovës, ngritën zërin dhe reaguan ashpër se nuk mund të mbahet regjistrimi nën tytat e armëve. Andaj ishte krejt normale që regjistrimi i popullsisë i vitit 1981, u bojkotua në mënyrë masive nga shqiptarët.

Shkrimi "Dallgët e luftës revolucionare dhe antiimperialiste ngrihen gjithnjë e më lart", është u huazuar nga gazeta e përditshme shqiptare "Zëri i Popullit" dhe në vija të përgjithësuara jepen të arriturat e shteti shqiptar brenda planit të gjashtë pesëvjeçar dhe përgatitjet që bëhen për me dal sa më të suksesshëm në planin tjetër gjatë viteve 1981-1985.

Nga ATSH-ja, po ashtu huazohet shkrimi "Shtohen përherë e më shumë shpenzimet për armatimin (Një milion dollarë në minutë për përgatitjet për luftë)". Në këtë shkrim kritikohet ashpër politika e shteteve të perëndimit, se në shtyp e televizionet e huaj, e sidomos të atyre Amerikane e Ruse, flitej me të madhe se angazhohen për paqe dhe stabilitet në botë, në të vërtet në botë ndodhë e kundërta, duke e argumentuar me të dhënën se vetëm brenda një minute bota harxhon një milion dollar për armatim[136], dhe më këtë angazhim për të prodhuar sa më shumë armë të sofistikuara, ata dëshmojnë haptas se sa janë për "paqe".

3. 8. "Trakti" i Lëvizjet Nacional Çlirimtare të Kosovës dhe Viseve të tjera shqiptare nën Jugosllavi" (LNÇVSHJ)

Në fillim të shkrimit njoftohen lexuesit se shkrimi "Një komb shqiptar, një shtet shqiptar", fillimisht është shkruar në formë "Trakti"

[135] Po aty.
[136] Shtohet përherë e më shumë shpenzimet për armatimin, Lajmëtari i Lirisë, Viti II, nr. 1, Janar –Shkurt 1981, f,11.

nga ana e "LNÇVSHJ", i cili kishte qarkulluar një kohë të gjatë në radhët e atdhetarëve në vend dhe diasporë.

Lëvizja... shkrimin e kishte ndarë në nëntë nën pjesë dhe në secilën veç e veç kishte prezantuar zhvillimin e luftërave shqiptare për liri e pavarësi.

Në nën pjesën "Pse historia u bë njerkë për popullin shqiptar", konstatohej se populli shqiptar është një ndër popujt më të vjetër në Ballkan dhe Evropë. Por e keqja ishte se gjatë gjithë historisë, ata nuk patën miq dhe përkrahje nga të tjerët. Edhe ata që i kishin ishin shumë të vegjël dhe nuk mundnin të ndikonin në rrjedhën e ngjarjeve historike. Periudha njerkë për shqiptarët ishte shumë e rëndë dhe e vështir. Edhe pse i sulmuan dhe i copëtuan, megjithatë shqiptarët arritën që t'iu rezistonin armiqve të shumtë, dhe nuk ishte e çuditshme se më 1878, populli shqiptar organizoi dhe formoi lëvizjen e vetë kombëtare, me organet e saja politike në të gjitha viset shqiptare-Lidhjen Shqiptare të themeluar në Prizren. Me anën e saj, populli i ynë i tregoi botës se populli shqiptarë është një dhe i pandarë. [137]Formimi i Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, pati jehon të madhe dhe ndikoi dukshëm që në skenën politike evropiane të mendohej pak më ndryshe. Kryesia e "Lëvizjes..." kështu e komenton se nën presionin e Lëvizjes Kombëtare të Shqiptarëve , të cilët kishin dalë me armë në dorë e të organizuar në nivel të lartë për ta mbrojtur vatanin nga copëtimi që i kërcënohej, edhe fuqitë e mëdha u detyruan disa herë t'i ndërronin vendimet e Kongresit të Berlinit[138]., por më vonë për të gjitha këto ata u hakmorën keq ndaj tyre, duke dërguar flotën e përbashkët evropiane në Ulqin e Tivar, për t'ia dorëzuar Malit të Zi ato vise shqiptare, që ai vet nuk kishte mundur ti marri kurrë.

Pas kongresit të Berlinit, dhe pasi u copëtuan dukshëm tokat shqiptare, Serbia dhe "Shkencëtarët" e saj morën një fushatë të paparë vetëm e vetëm për të bindur opinionin botëror se Kosova është tokë serbe, dhe se e quanin "Stara Serbia". Nuk ngurruan që të thoshin e të shkruanin lloj-lloj trillimesh duke thënë se "shqiptarët paskan ardhur në

[137] Një komb shqiptar, një shtet shqiptar, Lajmëtari i Lirisë, Viti II, nr. 1. Janar-Shkurt 1981, f, 12.
[138] Pse historia u bë njerkë për popullin shqiptar, Lajmëtari i Lirisë, Viti II, nr. 1. Janar-Shkurt 1981, f, 12.

Kosovë aty nga shekulli XVII e XVIII[139]. Por, në ndërkohë kishin "harruar" se me rrena nuk shkruhet historia.

Gjatë historisë dihej se shqiptarët në vitet 1908, 1909, 1910, e sidomos në vitin 1912, kur perandoria osmane dridhej nga themeli nga luftërat çlirimtare, kur i tërë populli shqiptarë dhe posaçërisht ai i Kosovës u ngrit në Luftë Çlirimtare e udhëhequr nga trimat më në zë si: Hasan Prishtina, Bajram Curri, Isa Boletini, Idriz Seferi[140] e shumë të tjerë.

Më 1912, në kohën më të vështirë kur hordhitë e egra sllave ia kishin mësy tokave shqiptare, plaku i urtë Ismail Qemali s'bashku me Isa Boletinin ngritën flamurin e Skënderbeut në Vlorë dhe shpallën Pavarësinë e Shtetit Shqiptar. Edhe pse u shpall Shqipëria, shtet i pavarur, megjithatë tokat shqiptare u copëtuan si më keq, gjysma e trojeve shqiptare iu futën në dorë robëruesve tanë të rinj, shumë më të egër se të përparshmit. Edhe pse populli shqiptar i kishte liruar me gjak tokat e veta, megjithatë edhe më tej vazhdoi si amanet, që të luftohej për realizimin e aspiratave të popullit shqiptar për krijimin e shtetit brenda kufijve kombëtar[141] shkruajnë anëtarët e LNÇVSHJ.

Pas okupimit të tokave shqiptare, nga ana e Serbisë filloi një fushat e paparë dhune e terrori. Pushteti serb ndaj shqiptarëve u sillnin në mënyrën më të vrazhdë. I mohonin të kaluarën e lavdishme dhe luftonin me lloj-lloj shantazhesh për të ardhmen. Njëra ndër metodat më të preferuara të tyre ishte dëbimi i shqiptarëve nga trojet e tyre, zhdukja e tyre fizike, kolonizimi i tokave shqiptare me element sllav[142] e shumë prapësi të tjera. Gjatë luftërave të më vonshme, pushteti serb u kujdes që në mënyrë sistematike të zhduk e të ç'faros sa më shumë shqiptarë. Ajo kohë ishte koha e shovinistëve serbë si e Vasa Qubrilloviqit, Ivo Andriqit, Ivo Vukotiqit dhe shumë të tjerëve, kur me këmbëngulje kërkonin nga pushtetarët që të merrnin masa drastike për zhdukjen e

[139] Me rrena nuk shkruhet historia, "Stara Serbija" pjellë e shovinizmit, Lajmëtari i Lirisë, Viti II, nr. 1. Janar-Shkurt 1981, f, 12.
[140] "Trojet shqiptare u çliruan me gjakun e djemve më të mire të Shqipërisë, po çlirimi qe jetëshkurtër, Lajmëtari i Lirisë, Viti II, nr. 1. Janar-Shkurt 1981, f, 12.
[141] Po aty.
[142] Qëndrimi i kralëve serbë ndaj tokave të robëruara, Lajmëtari i Lirisë, Viti II, nr. 1. Janar-Shkurt 1981,f, 12.

shqiptarëve. Ata shkuan aq larg sa shkruan elaborate të tëra se si dhe kur është më së miri ti zhduknin shqiptarët.

Në etapa të caktuara historike bëhet edhe analiza e situatës nga ana e anëtarëve të LNÇVSHJ-së. Në nën pjesën e titulluar "A bënë dot shqiptari ç'bënë kralët dhe shovinistet e rinj", bëhet fjalë për LDB dhe tokat shqiptare të cilat ishin pushtuar nga nazi-fashistët Dhe duhet përmendur se edhe gjatë Luftës së Dytë Botërore, populli shqiptar mori pjesë aktive në të dhe për herë të dytë i çliroi tokat e veta. Duke u mbështetur në forcat e veta dhe pa ndërhyrjen e aleatëve, populli i ynë ngadhënjeu mbi fashizmin, madje duke iu ardhur në ndihmë edhe popujve të tjerë, siç ishin ata të Jugosllavisë...[143], për të vazhduar më tej se deri në Konferencën që u bë në Bunjaj të Malësisë së Gjakovës, masat e gjera popullore në Kosovë nuk i kuptonin sa duhej qëllimet e LNÇ-së. Por, këto qëllime u kuptuan me themel pasi u shpall Rezoluta e kësaj Konference, ku thuhej se "Populli shqiptar, i cili me shekuj luftoi për çlirimin dhe për krijimin e shtetit të vet kombëtar, dhe pjesa e trojeve shqiptare e pjesa e trojeve shtetërore shqiptare, me çlirimin nga pushtuesit, do t'i realizojë aspiratat e veta dhe do t'i bashkëngjitet shtetit amë, Shqipërisë. Për këtë do të garantojë Ushtria Nacional Çlirimtare Shqiptare, Shtetet e Bashkuara të Amerikës e Anglia, si fuqi aleate në Luftën e Dytë Botërore"[144]. Se populli i Kosovës dhe i Viseve tjera shqiptare, që kishin mbetur jashtë kufijve të shtetit amë deri në fillim të II Botërore, para konferencës së përmendur kishin frikë se do të përsëritej e kaluara. Gjatë LDB, nuk mungonte edhe angazhimi i madh i komunistëve, duke e bindur popullin se poçes arrihet të luftohet nazi-fashizmi, atëherë garantonin ata se edhe çështja shqiptare do të zgjidhej drejtë e mirë ashtu edhe siç aspironin shqiptarët. Mjerisht, edhe kësaj here u dëshmua e kundërta. Kosova dhe shumë vise shqiptare u copëtuan në shumë republika jugosllave dhe Kosova u aneksua nga Serbia dhe Jugosllavia. Shqiptarëve në këtë periudhë nuk iu kishte ngelur rrugë tjetër, veçse të organizoheshin dhe të bënin rezistencë të armatosur. Janë të njohura Lufta e Drenicës, nën udhëheqjen e Shaban Polluzhës, sulmi i

[143] A bënë dot shqiptari ç'bënë kralët dhe shovinistët e rinj, Lajmëtari i Lirisë, Viti II, nr. 1. Janar-Shkurt 1981, f, 13.
[144] Rezoluta e Konferencës së Bujanit, (31 dhjetor 1943-1,2 janar 1944)….

Gjilani nën udhëheqjen e Mulla Idriz Gjilanit, Sulmi i Ferizajt e shumë luftëra të tjera anë e kënd në tokat shqiptare. Kur kryengritjet e shumta u shuan me gjak nga ana e "partizanëve" çetnik, atdhetarët shqiptar u detyruan që në një ilegalitet të thellë të vazhdonin dhe të organizonin shumë grupe e organizata ilegale që në vazhdimësi luftuan për qëllimin më sublim dhe më suprem për bashkimin e tokave shqiptare.

Për realizimin e planeve të vjetra, okupuesi serb filloi të aplikonte metoda të reja, dhe për të gjitha këto flet nëntitulli në vazhdim " Planet e vjetra-metoda të reja" të traktit të ilegales.

Një nga metodat më të përshtatshme që filluan për ti përdorur pushtuesit e rinj, ishte po ajo metodë që e kishin përdorur edhe më herët kralët serb: 1. Shpërngulja permanente e shqiptarëve nga trojet e veta. Meqë përballë popullsisë vendase dhe asaj botërore, ky aksion nuk mundë të ndërmerret me dhunë të hapur, sikurse në kohën e Jugosllavisë së vjetër, ata i hynë një aksioni të tërthorët. Përtërin e ripërtërin marrëveshjen xhentellmene turko-jugosllave, dhe kërkuan që nga Kosova dhe viset tjera shqiptare të shpërngulën sa më shumë shqiptar të besimit mysliman. Gjatë viteve të tmerrshme të dhunës e terrorit shtetëror ndaj shqiptarëve filloi edhe shpërngulja e madhe për në Turqi. Duke e parë rrezikun e madh nga shpërngulja dhe duke lënë mbrapa shumë fshatra të zbrazura shqiptare, atdhetarët shqiptar nuk qëndruan duarkryq dhe ndërmorën masat e nevojshme për të penguar zbrazjen e tokave shqiptare. Në statistikat e gjykatave të qarqeve në Kosovë janë të njohura shumë procese gjyqësore që u organizuan ndaj të gjithë atyre që pengonin në shpërnguljen e shqiptarëve. Si gjithmonë, pushteti nuk delte hapur kundër atyre që pengonin shpërnguljen por gjenin shumë e shumë arsye për ti hedhur në burg, që në një mënyrë amortizonin reagimin kundër shpërnguljes.

2. Si metodë e dytë që u aplikua me mjaft sukses ndaj shqiptarëve që kishin ngelur nën Jugosllavi, ishte edhe metoda e grumbullimit të armëve tek shqiptaret, apo ndryshe në popull njihej si "Aksioni i mbledhjes së armëve" gjatë vitit 1955/56. Aksioni ishte organizua me pretekstin se gjoja u kishin mbetur nga lufta shumë armë shqiptarëve dhe të gjitha ato paraqitnin rrezik për sigurinë e rendit në Jugosllavi. Në fakt, Aksioni i armëve ishte një nga mënyrat për presion mbi popullin

shqiptar, me qëllim kryesor e të fundit- shpërnguljen e shqiptarëve në Turqi e gjetkë. Gjatë aksionit populli shqiptar u torturua aq shumë nga UDB-eja, sa që një numër i madh njerëzish e humbën edhe jetën, kurse pjesa tjetër (e banorëve të moshës madhore), mbeti me pasoja të rënda fizike e psikike.[145]

Për aksionin e mbledhjes së armëve në Kosovë, pas viteve 1966/1968, shkruante edhe shtypi i vendit dhe shtypi botëror. Gazeta "Vus" e Zagrebit, kishte shkruar se gjatë kohës së aksionit të armëve nga viset shqiptare nën Jugosllavi u shpërngulën dhe shkuan për Turqi rreth 300 mijë shqiptar. Kundër këtyre metodave perfide që organizoheshin nga ana e pushtetit u bë rezistencë e madhe si në mënyrë individuale po ashtu edhe në formë të organizuar. Gjatë kësaj kohe u formuan dhe vepruan shumë organizata ilegale që kishin për qëllim rezistencën e shqiptarëve dhe u mundonin që në masat e gjera të bënin informimin e drejtë për shpërnguljet në Turqi dhe metodat e ndryshme të dhunës që përdornin okupuesit. Gjatë kësaj periudhe, numri i të burgosurve politik u shtua dukshëm, në këtë kohë u mbajt procesi gjyqësor i njohur me emrin "Procesi i Adem Demaqit", Procesi gjyqësor i Metush Krasniqit me shokë. Në burg u mbyt me dhunë mësuesi patriot i Letancit të Llapit, Shaban Shala, Fazli Grajqevci e shumë e shumë të tjerëve anë e kënd Kosovës dhe viseve shqiptare nën Jugosllavi.

Më 1968, angazhimi i atdhetarëve tek masat e gjera shqiptare, dha edhe rezultatet e para të lakmueshme. Fillohet me organizimin e demonstratave që mbahen në Prizren (6 tetor, '68), për të kaluar në Therandë (8 tetor '68), për tu organizuar me 19 tetor në qytetin e Pejës, për të mos mbetur anash Gjilani me rrethin, me 27 nëntor, 1968. Po ashtu, jepen të dhëna të bollshme për demonstratat në Besian, për të pasuar më vonë nga ato të Ferizajt me dallim prej një ore, për të vazhduar më vonë zinxhir, në Mitrovicë, dhe për të kulmuar në Prishtinë, ku demonstrimi i masave e studentëve i arrin majat, me fillim në orë 16 pa pesë minuta, e, për të përfunduar diku kah mëngjesi i ditës së nesërme (28 nëntor '68).

[145] Planet e vjetra-metoda të reja, Lajmëtari i Lirisë, Viti II, nr. 1. Janar-Shkurt 1981, f, 14.

Bërja e demonstratave për herë të parë në Kosovën e pas LDB, në opinionin kombëtar dhe ndërkombëtar pati jehon të madhe duke e ndarë një kohë historike në dysh: kohën para demonstratave dhe atë pas demonstratave. Andaj, edhe informimit iu kushtua një rëndësi e veçantë, edhe pse udhëheqja e atëhershme u mundua që të minimizonte rendësin dhe qëllimin e tyre. Proceset gjyqësore që u organizuan dhe u mbajtën ndaj demonstruesve-organizatorë, binin në sy me shqiptimin e pakët të viteve të burgut. Ç'është e vërteta, ato nuk ishin të vogla ngase grupit të organizatorëve dhe të tjerëve që u arrestuan iu shqiptuan mbi 100 vite burg të rëndë, porse krahasuar me dënimet e mëhershme që iu shqiptoheshin shqiptarëve, e që ishin dënime prej shumë viteve, këto ishin më pak të larta.

Ishte edhe një urdhër nga "lart", që i udhëzonte gjykatësit, që mos t'iu kushtohet ndonjë rëndësi e veçantë demonstruesve, por edhe mos të shkruhej drejtë për kërkesat e tyre. Shtypi jugosllav, i vlerësoi si të organizuara nga "armiqtë" e popullit jugosllav e shqiptar.

Edhe pse kanë kaluar vite e vite, konstaton "Lëvizja...", kërkesat e popullit shqiptar edhe më vonë ngelën të njëjta, kërkesa ato që kishte parashtruar populli shqiptar që nga Lidhja Shqiptare e Prizrenit, me Rezolutën e Konferencës së Bujanit, më vitin 1945, më 1968 e më 1978, dhe nëpër të gjitha këto vite përcillej si kushtrim kërkesa e LSHP me Abdyl Frashërin se shqiptarët nuk duan as më shumë e as më pakë se "Një komb shqiptar, një shtet shqiptar" dhe kjo e drejt e ligjshme u nëpërkëmb vit pas viti deri më 1999.

Dhe për këtë të drejtë dhe të vërtet e dinë mirë robëruesit jugosllavë. E di mirë tërë bota se, pa krijimin e shtetit shqiptar brenda kufijve kombëtar shqiptarë- nuk do të ketë paqe në Ballkan[146] thuhej në traktin e LNÇVSHJ-së.

3. 9. Poezia patriotike në faqet e "Lajmëtarit..."

Siç e kam thënë edhe më lartë në këtë shkrim, gazeta "Lajmëtari i Lirisë" karakterizohet me botimin e shkrimeve me karakter politik dhe kombëtar. Por, veç këtyre, në faqet e kësaj gazete hasim aty-këtu edhe në poezi që kanë po të njëjtën frymë atdhetare. Në faqen e 15 të kësaj,

[146] Pa krijimin e shtetit shqiptar Brenda kufijve kombëtar nuk ka paqe në Ballkan, Lajmëtari i Lirisë, Viti II, nr. 1. Janar- Shkurt 1981, f, 15.

lexuesve iu prezantohet shkrimtari i madh shqiptar Ismail Kadare me një poezi "Kali i Trojës" (fragment). Ndoc Gjetja: "Te gryka e Honit ku prehen eshtrat e Azemit" si dhe një poezi e huazuar nga përmbledhja me poezi "Këngët e Lirisë" që ishte botim i Marksistëve-Leninistë të Kosovës, e që titullohej me "Thonë atë ditë..."

Në poezinë "Kali i Trojës", I.Kadare, na paraqet tradhtinë e madhe që iu bëhet trojanëve duke komunikuar me ta se "Ata të hapën portat, s'dinin ç'ishe/ Pastaj (o, pastaj) kur flakët përndrisheshin, gjindja ulurinte/Klithnin "oh, tradhti", por ishte vonë?[147]. Në poezinë e Ndoc Gjetës, jepet dialogu i shkurt që bënë autori i poezisë me Azem Galicën, duke iu drejtuar: A po më ndien o Azem Galica?-/thirra ndoshta një qind herë/Një shqiponjë doli nga gryka/me tërsëllëm u ngrit në qiell/I thash vetes mos thirr më!/Se Azem Galica doli/[148], dhe vërtet gjatë gjithë historisë së popullit shqiptar që ishte e mbushur me ngjarje madhore, nëpër vite vinin edhe gjeneratat e reja që vazhdonin rrugën e të parëve, dhe kur i shihje ata trima dhe ato vasha, fitoje përshtypjen se trimat po ktheheshin e po riktheheshin me tërë madhështinë e tyre heroike.

Në rubrikën "Fjala jonë poetike në ilegalitet", prezantohet poezia "Thonë atë ditë...", por edhe kësaj si shumë shkrimeve nuk i dihet autori. Poeti ilegalist shkruan për ditën kur u vendos që Kosova të aneksohej nga Serbia dhe Jugosllavia. Kam lexuar shumë libra shkencore për këtë padrejtësi të madhe që iu bëhet shqiptarëve, kamë lexuar edhe krijime artistike, porse nuk më ka rënë të lexojë diçka të tillë të dhembshme dhe në të njëjtën kohë të mrekullueshme. Është e dhembshme kur i lexon këta rreshta dhe për një moment hyn hullive të historisë dhe... vërtet autori ka të drejtë kur shkruan *"Thonë atë ditë lëvizën varret/ Eshtrat ndjen therje thike/U dridhen kullat shekullore/ Pushkët vollën gjak për gryke/Thonë atë ditë në ballë rrudhat/ Tym seç nxirrnin nga mërzia/ Thonë atë ditë në bark të nënës/Dhembje ndjeu edhe fëmija/*[149] për të vazhduar më tutje dhe për të treguar se çfarë ishte ajo që e solli këtë apokalips në shpirtin e poetit. Në strofën e fundit të poezitë poeti

[147] Ismail Kadare, Kali I Trojës (fragment), Lajmëtari i Lirisë, Viti II, nr. 1. Janar-Shkurt 1981, f, 15.
[148] Ndoc Gjetja, Te gryka e Honit ku prehen eshtrat e Azemit, Lajmëtari i Lirisë, Viti II, nr. 1. Janar-Shkurt, 1981, f, 15.
[149] Fjala jonë poetike në ilegalitet: Thonë atë ditë, Lajmëtari i Lirisë, Viti II, nr. 1. Janar-Shkurt 1981, f, 16.

shkruan: *Thonë atë ditë qau dhe dheu/ Guri plasi nga mërzia/ Thonë atë ditë, atë ditë të zezë/Dysh na ndau tradhtia"*[150]. Për të mos elaboruar situatën politike dhe pse erdhi deri tek aneksimi i Kosovës dhe i shumë tokave shqiptare nën Jugosllavi, autori thotë se e tërë kjo ndodhi ngase u tradhtuam nga shumë faktor që dominonin në atë kohë (1945).

Në faqen e fundit të gazetës prezantohet edhe artikulli "Populli është i pamposhtur", shkrim i huazuar nga revista shqiptare "Shqipëria e Re", 5/ 1980, Tiranë. Po ashtu në këtë artikull në përgjithësi bëhet fjalë për historikun e Shqipërisë që nga Lufta e Parë Botërore e deri më ditët e sotme, duke i kushtuar veçantë Ivo Andriqit se si kishte reaguar për dëbimin e italianëve nga Shqipëria e duke harruar për elaboratet e tija që i kishte shkruar dhe kishte paraparë që shteti shqiptar të ndahej në mes të Serbisë e Italisë, e herë në mes të Serbisë e Greqisë[151]. Duke harruar se të tëra ato toka ishin shqiptare dhe i takojnë atij.

3. 10. Shtojca e "Lajmëtarit..."

Në shtypin e ilegales që botohej në diasporë, më ka rënë të gjejë në shumë gazeta se botonin edhe shtojca speciale, apo edhe numra të veçantë që kishin tematika e probleme të veçanta. Në numrin e tretë të gazetës "Lajmëtari i Lirisë", të vitit 1981, numri i parë, gjejmë edhe shkrimin "Kush thumbit e kush patkoit" që kryesisht i kushtohet ngjarjeve të dy viteve të fundit që kishin ndodhur në Kosovë dhe në viset shqiptare nën Jugosllavi.

Fillimisht redaksia kërkon falje nga lexuesit për shkak se ndoshta këto të dhëna nuk janë të punuara sikurse shkrimet tjera, por botimi i tyre kishte një rëndësi të veçantë për të njoftuar opinionin e gjerë si në diasporë po ashtu edhe në Kosovë.

Shtojca e "Lajmëtarit..." , ka dy faqe tekst, të ndarë në shtatë nëntituj.

Në pjesën e parë, bëhet fjalë për burgosjet e shumta që ndodhin në Kosovë që nga 21 nëntori 1980, e që vazhdon deri më 1 janar 1981. Me një llogari të thjesht, del se vetëm brenda më pak se një muaj e gjysmë, u arrestuan dhe u dënuan këta persona:

---

[150] Po aty.

[151] Populli është i pamposhtur, Lajmëtari i Lirisë, Viti II, nr. 1. Janar-Shkurt 1981, f, 16.

1. Hasan Ukëhaxhaj, nga Carrabregu, magjistër i gjuhës shqipe,, arsimtar në QAM "Vëllezërit Frashëri", të Deçanit.

2. Ibish Neziri, nga Bardhaniqi, student i gjuhës shqipe, i burgosur më 21 nëntor 1980.

3. Bajram Gashi, nga Llapushniku, milic me shërbim në fshatinë Cërmjan, student i gjuhës shqipe në SLP të Gjakovës.

4. Ali Mehmeti, nga Botusha, mësues në Mushtishtë të Suharekës.

5. Sokol Mehmeti, gjithashtu nga Botusha, student.

6. Ramiz Zeqiri, nga Brovina, student i gjuhës shqipe.

7. Xhafer Sylejmani, nga Nivokazi, student.

8. Musa Berisha, nga Duboviku, student i letërsisë shqipe, i arrestuar gjatë kohës që po bënte shërbimin ushtarak diku në Slloveni.

9. Ismet Iberdemaj, nga Peja, student në Prishtinë.

10. Hysen Gegaj, nga Sallagrazhda, bujk, në kohën e arrestimit punëtor në botën e jashtme.

11. Danush Gegaj, nga Sallagrazhda, student në Prishtinë, që bashkë me të vëllanë, Hysenin u arrestuan mëngjesin e 1 janarit 1981, në shtëpinë e lindjes në Sallagrazhdë.[152]

Sipas këtij shkrimi del se personat e akuzuar ishin arrestuar dhe ndaj tyre ishte ngritur aktakuza për veprimtari "armiqësore" dhe të gjithë ngarkoheshin në bazë të nenit 133[153], të Kodit Penal të Jugosllavisë.

3. 11. Aksionet e anëtarëve të ilegales në teren

Në nëntitullin "Një aksion i vlefshëm në Prizren", mërgata e jonë njoftohet se gjatë festave të nëntorit, në Prizren, rinia e kyçur në ilegale kreu një aksion kundër shtetit, duke shpërndarë në shumë vende shumë afishe të punuara bukur dhe me një përmbajtje të shkurtër dhe koncize, që vinte si përgjigje për burgosjet masive politike që kishin ndodhur në Kosovë. Redaksia e "Lajmëtarit..." vije në përfundim se aksioni i përmendur ishte i vlefshëm dhe i rëndësishëm, jo vetëm për përmbajtjen dhe shpërndarjen e tyre, por ishte e rëndësishme edhe koha kur u bë shpërndarje,: Festa Kombëtare e Pavarësisë, pra edhe gjatë së cilës u

[152] Kush thumbit e kush patkoit, Shtojca e Lajmëtarit të Lirisë, Viti II, nr. 1. Janar-Shkurt 1981, f, 1.

[153] Me neni 133 të Ligjit Penal të Jugosllavisë, me shumicë dënoheshin shqiptarët në Jugosllavin e Titos, duke i akuzuar për propagandë armiqësore ndaj shtetit e popullit. Dhe vërtet ilegalja shqiptare ka vepruar kundër shtetit por kundër popullit të vet kurrë dhe në asnjë mënyrë.

burgosën veprimtarët e ilegales[154], dëshmuan edhe një herë se të gjithë ata të burgosur, nuk ishin të vetëm, por për çlirimin e Kosovës dhe Viseve tjera shqiptare nën ish Jugosllavi luftonte një armatë e tërë.

Rasti i shpërndarjes së afisheve në Prizren nuk ishte i vetëm. Në natën e festës së flamurit kishin reaguar edhe nxënësit e QAMO "Vëllezërit Frashër", të Deçanit. Gjashtë paralele të ish-gjimnazit eksperimental dhe muret e jashtme të sallës së fizkulturës, u stolisën me parulla secila më e fuqishme se shoqja: Rroftë 28 Nëntori, "Rroftë PPSH dhe Enver Hoxha" etj. Fotografit e satrapit Tito, të varura si shëmtim që ndyn emrin e madh të patriotëve e të rilindëseve shqiptar Frashri, emrin e të cilëve e mban kjo qendër shkollore, rinia i mbuloi me një ngjyrë të fortë të yndyrshme[155]. Pasi se u panë e u soditën këndshëm nga nxënësit dhe arsimtarët e shkollës, nuk vonon shumë dhe udbashët me një shpejtësi të ethshme, mbuluan dhe shkarravitën çdo gjë në mur duke lënë mbrapa vetëm gjurmët që të kujtonte se ishte përdorur dhunë për ti shlyer ato shkrime që ishte dëshirë e shprehur në parulla. Udbashët me vete morën shumë nxënës e arsimtar, ku në zyre të sigurimit përdorën lloj-lloj presionesh vetëm e vetëm për të zbuluar aktoret e shkrimeve.

Një vepër tjetër patriotike ishte kryer edhe më 25 nëntor në fshatin Irzniq, në shkollën fillore që mbante një emër jo pak të urryer, Petar Përle, dhe me gjasë ky emër tek nxënësit dhe qytetarët kishte nxitur neveri, dhe nuk ishte fare befasuese, kur mëngjesi i 25 nëntorit bustin e tij e kishte gdhirë pa kokën e tij. Organet e pushtetit e sidomos bashkëpunëtorët e UDB-es, e përjetuan rëndë, edhe në këtë rast nuk mungoi arrestimi i nxënësve e fshatarëve. Për të qenë absurdi edhe më i madh, shkruan shtojca e "Lajmëtarit...", se nga burime të sigurta jemi informuar se UDB-eja e ka qitur fjalën në rrethin e besimtarëve të vet se ai që e zë aktorin e heqjes së kokës nga busti, do të shpërblehet me-200 milion dinarë!!![156], por në popull ndodhte e kundërta, ishte përhapur lajmi se kushdo që i ka hequr kokën bustit anonim, do të shpërblehet me 200 milion dinarë.

---

[154] Një aksion i vlefshëm në Prizren, Lajmëtari i Lirisë, Viti II, nr, 1. Janar-Shkurt 1981, (Shtojca)
[155] Edhe në Gjimnazin e Deçanit, Lajmëtari i Lirisë, Viti II, nr. 1. Janar- Shkurt 1981. (Shtojcë).
[156] 200 milionë që t'i merret koka atij të gjalli që guxoi t'ia hiqte kokën anonimit të vdekur të bustit, Lajmëtari i Lirisë, Viti II, nr. 1. Janar-Shkurt 1981, (Shtojca)

Për një aksion tjetër nga ilegalja shqiptare flet edhe shkrimi në vijim "Prapë Përla, prapë Kardeli... Deri kur-përrr?", në këtë shkrim të radhës bëhej fjalë për regjionin e Deçanit si pjesa më e prapambetur si në aspektin ekonomik po ashtu edhe në atë arsimor e politik. Duke u nisur nga këto të dhëna pushtetarët llogaritnin se edhe popullsia shumicë shqiptare (94,2% shqiptare, regjistrimi i vitit 1971), llogaritnin se pajtohen me të bëme e udhëheqësve të kësaj komune. Në vjeshtë të vitit 1980, në qytetin e Deçanit[157], u emërtuan rrugët, por kryesisht u vunë emra të heronjve serb e sllavë, në të rrallë apo tek-tuk ndonjë rilindës shqiptar. Populli nga ky gjest i pushtetarëve u dëshpërua keq, dhe në ditën e nesërme që u vunë pllakatet e rrugëve me emra sllavë, mëngjesi i nesërm i gdhiu të demobiluara dhe të thyera e të hedhura në tokë. Udbashët u shqetësuar për guximin e marr nga popullata, por nga ky gjest i popullit morën edhe një mësim të mirë se shqiptarët shumicë në këtë komunë nuk pajtohen me pushtetarët dhe politikën okupuese jugosllave.

Në shkrimin "UDB-eja dyshon në radhët e veta", informohet opinioni se lëvizja ilegale patriotike shqiptare ka arritur që në radhët e UDB-es të ketë edhe atdhetar të devotshëm siç ishte rasti më i freskët i policit të arrestuar nga Cërmjani, Bajram Gashi. Bajram Gashi ishte një atdhetar që padrejtësitë e shumta, përcjelljet e njerëzve të pafajshëm, spiunazhi e shantazhi i kishin ardhur në grykë, dhe kështu në nëntor, udbashët duke e vërejtur rezistencën e tij të heshtur e herë transparente, e arrestojnë duke e mbajtur me muaj të tërë në hetuesi. Dhe, ja edhe një dëshmi, kur udbashët kanë filluar të dyshojnë edhe në "forcat" e veta. "Shtojca" shkruan se është e sigurt se Bajram Gashi, sido që të vënë punët (thonë se ai është edhe i qëndrueshëm e i pamposhtur në qëndrimet), është një person që i ka dal dore përgjithmonë UDB-es. Na mban shpresa se shembullin e tij do ta ndjekin edhe kolegët e tij të tjerë të ndershëm[158] përmbyll shkrimin gazeta.

Në shkrimin "Një akt barbar, i organizuar", flitet për kriminelin e njohur të atyre viteve që jetonte në Lëvoshë të Pejës, por pasi se ishte zbuluar, atë e kishte marr në mbrojtje qendra çetnike e Beogradit. Për të

[157] Prapë Përla, prapë Kardeli... Deri kur-përr?, Lajmëtari i Lirisë, Viti II, nr. 1. Janar-Shkurt 1981, (shtojca).
[158] UDB-eja dyshon në radhët e "veta", Lajmëtari i Lirisë, Viti II, nr. 1. Janar-Shkurt 1981, (Shtojcë).

njohur të bëmet e këtij krimineli, gazeta “Lajmëtari i Lirisë”, në shtojcën e vet na sjell këto të dhëna: Më 19 tetor 1980, në Lëvoshë, përmbi Pejë, një kriminel malazezë shtiu mbi dy djelmosha shqiptarë, nga të cilët njëri mbeti vdekur e tjetri ia doli të ikë dhe ta informojë policinë për krimin e asaj dite. Viktimë e këtij gjahu çetnik në skalpe shqiptare qe 20-vjeçari Masar Hyseni nga fshati Smirë i Vitisë (i lindur më 1960), student i vitit të dytë në Shkollën e Lartë Komerciale në Pejë. Ditën kontestuese, Masari dhe moshatari i tij Osmani nga Sadovina e Vitisë, kishin dalë për një shëtitje të zakonshme në pyll afër Lëvoshës. Këta dy të rinj asnjëherë nuk kishin menduar se në një shëtitje në natyrë do të lind një tragjedi aq e madhe. Dhe në vrapim e sipër, Masar Hyseni, bije i vdekur nga plumbat e çetnikut të Lëvoshës. Por habia ishte edhe më e madhe, kur pas arrestimit të tij nga organet e ndjekjes, krimineli pranon se kishte vrarë shumë persona shqiptare duke treguar se ai kishte kryer vetëm porosinë që e kishte marr nga eprorët e veta nga Beogradi[159]. Pas një kohe,kriminelin e transferojnë në spitalin e Beogradit duke mos e zbuluar kurrë se kush ishin personat që porositshin vrasjet ndaj shqiptarëve.

Nuk janë të panjohura rastet e shumta kur pushteti paguante kriminelet e shumtë për të likuiduar e vrarë sa më shumë shqiptar, vetëm e vetëm që tek popullata të krijohej psikoza e frikës dhe e rrezikut që me të madhe ti lëshojnë trojet e veta. Dhe esesi udhëheqësit shqiptar, që redaksia e “Lajmëtarit...” i quan “kukulla” të sistemit, edhe më tej bëhen të shurdhër duke mos dashur me kuptuar se ky pushtet gjatë gjithë historisë ishte njerkë dhe okupues i popullit shqiptar që jetonte me shekuj në trojet e veta.

~~~~~~

© Pashtriku.org, Prill'2015

~~~~~~

[159] Një akt barbar, i organizuar, Lajmëtari i Lirisë, Viti II, nr. 1. Janar-Shkurt, 1980. (Shtojcë).